



Komisioneri për Mbrojtjen
nga Diskriminimi

Commissioner for Protection
from Discrimination

2024



RAPORTI VJETOR I KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIM

Tabela e përmbajtjes

I.	Mesazhi i Titullarit.....	4
II.	Hyrje	5
III.	Kuadri Ligjor mbi Barazinë dhe Antidiskriminimin	5
1.	Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.	5
	Instrumentet në kuadrin e OKB-së	6
	Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës	9
	Standardet e Bashkimit Evropian	10
2.	Kuadri Ligjor Shqiptar	12
3.	Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksionimin e KMD	25
	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative	25
	Zyra e KMD	26
	Kompetencat e Komisionerit	26
IV.	Veprimtaria në Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Promovimi i Barazisë.....	28
1.	Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit	28
2.	Shqyrtimi i çështjeve nga KMD	28
3.	Procedura e shqyrtimit të ankesave.....	28
	Çështjet e trajtuara nga KMD	31
	Ankuesit.....	32
	Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së).....	33
	Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive	34
	Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara	34
	Çështjet e trajtuara sipas fushave.....	36
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.	37
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.	38
	Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.....	39
	Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.	39
	Gjuha e urrejtjes.....	40
4.	Vendimet e çështjeve sipas fushave.	41
5.	Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve.....	42
	Vendimet e çështjeve me shkak racën	42
	Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar	43
	Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike.....	45
	Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike.....	45

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore	46
Vendimet e çështjeve me shkak moshën.	47
Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.	48
Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.....	49
Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”	50
Vendimet për konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak.....	52
Format e tjera të diskriminimit	52
6. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara	53
Problematikat e evidentuara nga KMD gjatë shqyrtimit të ankesave	54
7. Proçeset Gjyqësore.....	57
Pjesëmarrja e KMD në proçeset gjyqësore	57
Pjesëmarrja në proçeset gjyqësore.	58
Vendimet Gjyqësore	60
Dëmshpërblimi si pasojë e diskriminimit.	65
Arsyet e shfuqizimit të vendimeve të Komisionerit nga Gjykatat.	68
8. Rekomandime dhe opinione ligjore	72
Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore:.....	73
9. Ndërgjegjësimi	84
Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media	84
10. Veprimtaria monitoruese e KMD.....	90
Raportime të KMD	90
Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstytucionale.	94
KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë	97
Trajnime dhe Webinare.....	98
11. Programi i transparencës.....	99
V. Zyrrat Rajonale	100
1. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë	100
2. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier	105
3. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër	114
VI. Aspekte të Shërbimeve	120
1. Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2024	120
2. Menaxhimi i burimeve financiare 2024	121

I. Mesazhi i Titullarit

Në muajin simbolikë të Marsit që korrespondon me Ditën Ndërkombëtare të Diskriminimit Zero, veshur me funksionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, po Ju dërgoj përmbledhjen vjetore të veprimtarisë së Institucionit e cila reflekton edhe gjëndjen e diskriminimit në Republikën e Shqipërisë.

Nisur nga përpjekjet e vazhdueshme të Kuvendit të Shqipërisë dhe vullnetit pozitiv të treguar në përforsimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim garantimin sa më efektiv të Parimit të Barazisë dhe mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi individual dhe i strukturuar, uroj një vazhdimësi të përhershme dhe të përditshme të këtij impenjimi të Kuvendit me të gjitha institucionet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Sfidat janë të gjithanshme dhe kërkojnë një aktivizëm të të gjithë aktorëve publikë dhe shoqërorë në promovimin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave sociale, si instrumente vitale në gëzimin me dinjitet të të gjitha të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventave Ndërkombëtare.

Shpreh besimin e plotë në bashkëpunimin dhe bashkërendimin e të gjithë subjekteve në ndreqjen e pabarazive dhe luftën kundër diskriminimit, duke garantuar përfshirjen pa rezerva të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në këtë sfidë dhe detyrë publike dhe qytetare.

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA

II. Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) është autoriteti përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Referuar nenit 26, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri paraqet raport të paktën një herë në vit përpara Komisioneve të Kuvendit, si dhe përgatit raporte mbi aktivitetet e 6 mujorit të parë të vitit të veprimtarisë institucionale.

Raporti përfshin analizë të veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përgjithësi, si dhe puna e Komisionerit dhe Zyrës janë reflektuar me qëllim njohjen dhe informimin me veprimtarin konkrete të ushtruar, sipas fushës së kompetencës që mbulon.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.

Vlerësimet dhe Rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë përmes “Rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për vitin 2023”, janë një udhëzues në veprimtarinë e institucionit për garantimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

III. Kuadri Ligjor mbi Barazinë dhe Antidiskriminimin

1. Aktet Ndërkombëtare në Fushën e të Drejtave të Njeriut dhe Antidiskriminimit.

Ka standarde të shumta në këtë fushë të krijuara dhe zbatuara në nivelin e Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës, dhe Bashkimit Evropian, të cilat mund të shërbejnë si bazë e dobishme për çdo vlerësim të pjesëve të kuadrit ligjor të barazisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Pas nënshkrimit dhe ratifikimit të instrumenteve të legjislacionit ndërkombëtar që merren me të drejtat e njeriut dhe pas ndalimit të instrumenteve të diskriminimit, Shqipëria i ka bërë ato pjesë të rendit të brendshëm ligjor.

Instrumentet në kuadrin e OKB-së

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) e vitit 1948, ndonëse ka karakter thjesht deklarativ, pra konsiderohet si një dokument “*soft law*”, ka një vlerë kolosale për formulimin dhe zbatimin e konventave ndërkombëtare, formulimin e ligjeve të çdo shteti, të politikave, veprimeve të autoriteteve dhe individëve si edhe vendimeve të gjykatave. DUDNJ, në nenin 1, nënvizon se: *“Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta ...”*. Neni 2/1 parashikon se secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Në nenin 7 kemi *“të drejtën për barazi përpara ligjit”*, ku parashikohet shprehimisht se: *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë”*.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Ky pakt, i ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1991¹, parashikon parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën për mbrojtje të barabartë nga ligji, pa asnjë diskriminim. Ky pakt ka sanksionuar në përmbajtjen e tij se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe kanë të drejtë mbrojtjeje të barabartë të ligjit pa kurrfarë dallimi. Lidhur me këtë, ligji duhet të ndalojë çdo diskriminim dhe të garantojë për të gjithë, mbrojtje të barabartë dhe efektive, kundër çdo diskriminimi e sidomos për shkak të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik dhe çdo opinionit tjetër, origjinës kombëtare apo shoqërore, pasurisë, lindjes ose çdo shtate tjetër”*.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore është nënshkruar në vitin 1966 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1976. Shqipëria e ka ratifikuar Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në vitin 1991². Ky pakt ka sanksionuar detyrimin e shteteve palë për të garantuar ushtrimin e të drejtave të shprehura në të, pa asnjë diskriminim për shkak të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik apo tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindjes, ose ndonjë statusi tjetër.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara³ (KDPAK) është miratuar në 13 Dhjetor 2006 dhe ka hyrë në fuqi me 3 Maj 2008. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në vitin 2012⁴. Bashkimi Evropian e ka ratifikuar këtë Konventë në Dhjetor të vitit 2010. KDPAK ndalon diskriminimin ndaj kujtdo për shkak të aftësisë së kufizuar, duke marrë në konsideratë faktin që diskriminimi pengon njerëzit të gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë të barabartë me të tjerët. Konventa parashikon edhe hapat që duhen ndërmarrë për të siguruar përshtatjen e arsyeshme, ndaluar diskriminimin de facto dhe forma diskriminuese që mund të shfaqen në të ardhmen, si dhe për të promovuar të drejtën e personave me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta me të tjerët. Ndalimi i diskriminimit, përveç se një e drejtë e veçantë, është edhe një nga parimet bazë të Konventës që udhëheq interpretimin dhe zbatimin e të drejtave të tjera të mbrojtura në të.

¹ Ligji Nr. 7510 date 08.08.1991.

² Ligji Nr. 7511 date 08.08.1991.

³ Convention on the Rights of Persons with Disabilities.

⁴ Ligji Nr. 108 datë 15.11.2012.

Dispozitat e tjera shpjegojnë çfarë përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar në fushat e përkatëse, si dhe masat, përfshirë edhe ato pozitive, për të arritur barazinë në praktikë. Konventa sqaron se këto masa pozitive nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese. Po kështu, kuadri kundër diskriminimit plotësohet edhe nga Nenet 6 dhe 7, që kanë të bëjnë me masat anti diskriminuese për fëmijët dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave⁵ (CEDAW), u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 18 Dhjetor 1979 dhe hyrë në fuqi më 1981. Shqipëria ka ratifikuar CEDAW-n në vitin 1993⁶. Ndërsa Protokolli Fakultativ i Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, i vitit 1999 i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2000, është ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh., në vitin 2003⁷. Në preambulën e saj, Konventa ka përcaktuar se diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe të respektimit të dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njëjtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mirëqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbim të vendeve të tyre dhe njerëzimit, Konventa ka përcaktuar në nenin 1 të saj kuptimin e termit “*diskriminim ndaj grave*” si çdo dallim, përjashtim ose kufizim që bëhet mbi bazën e gjinisë, e që ka për pasojë ose për qëllim të dëmtojë, ose të shfuqizojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin nga gratë, pavarësisht nga statusi i tyre martesor, mbi bazën e barazisë së burrave dhe të grave, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile ose në çdo fushë tjetër.

Në këtë Konventë sanksionohet mbrojtja nga diskriminimi ndaj grave nëpërmjet masave të përkohshme të veçanta që synojnë përshejtimin de facto të barazisë midis burrave dhe grave; si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave me qëllim që t’i sigurohen atyre të drejta të barabarta me burrat në fusha të ndryshme si: në jetën politike dhe publike të vendit; në fushën e arsimit; në fushën e punësimit; për të parandaluar diskriminimin ndaj grave për shkaqe martesore apo amësie, dhe për të siguruar të drejtën e tyre efektive për punë; në fushën e kujdesit shëndetësor për t’u siguruar, mundësitë për të përfutur shërbime mjekësore, duke përfshirë edhe ato të planifikimit familjar; në fushat e tjera të jetës ekonomike dhe shoqërore, si dhe masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me marrëdhëniet familjare.

Konventa për dhunën dhe ngacmimin, 190, është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, me Ligjin Nr. 13/2022. Qëllimi i kësaj Konvente është të mbrojë punëtorët dhe personat e tjerë në botën e punës, duke përfshirë punonjësit, siç përcaktohen në legjislacionin dhe praktikën kombëtare, si dhe personat që punojnë pavarësisht nga statusi i tyre kontraktues, personat në trajnim, duke përfshirë praktikantët dhe fillestarët, punëtorët, punësimi i të cilëve ka përfunduar, vullnetarë, punëkërkues dhe aplikantë për punë dhe individë që ushtrojnë autoritetin, detyrat ose përgjegjësitë e një punëdhënësi. Kjo Konventë zbatohet për të gjithë sektorët, qoftë privatë apo publikë, si në ekonominë formale, edhe në atë joformale, dhe qoftë në zonat urbane apo rurale.

Me ratifikimin e saj shteti shqiptar, merr përsipër detyrimin për të miratuar ligje, rregullore dhe politika që garantojnë të drejtën për barazi dhe mosdiskriminim në punësim dhe profesion, duke

⁵ Convention on the Elimination of all forms of Discrimination Against Women.

⁶ Ligji Nr. 1769, date 09.11.1993.

⁷ Ligji Nr. 9052, date 17.04.2003.

përfshirë për punëtorët femra, si dhe për punëtorët dhe personat e tjerë që i përkasin një ose më shumë grupeve të prekshme ose grupeve në situata të prekshmërisë që preken në mënyrë disproporcionale nga dhuna dhe ngacmimi në botën e punës. Njëkohësisht duhet të garantojë që dispozitat mbi dhunën dhe ngacmimin në ligjet, rregulloret dhe politikat kombëtare, marrin parasysh instrumentet e barazisë dhe mosdiskriminimit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, duke përfshirë Konventën për Shpërblimin e Barabartë (Nr. 100) dhe Rekomandimin (Nr. 90), 1951 dhe Konventën për Diskriminimin (Punësimi dhe Profesionet) (Nr. 111) dhe Rekomandimin (Nr. 111), 1958, si edhe instrumente të tjera përkatëse.

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, e miratuar në vitin 1966 dhe hyrë në fuqi në vitin 1969, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1993⁸, ka përcaktuar në Preambulën e saj se: *“Të gjithë njerëzit janë të barabartë përpara ligjit dhe se kanë të drejtë të mbrohen në mënyrë të barabartë nga ligji kundër çdo diskriminimi si dhe kundër çdo nxitjeje për diskriminim”*.

Sipas kësaj Konvente, *“diskriminimi racial”* nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferencë që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, që ka për qëllim apo për efekt të shkatërrojë ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore ose në çdo fushë tjetër të jetës publike. (neni 1).

Konventa përcakton detyrimin e shteteve palë të ndalojë dhe të eliminojnë diskriminimin racial në të gjitha format e tij dhe të garantojë të drejtën e secilit për barazi përpara ligjit pa dallim race, ngjyre ose origjine etnike ose kombëtare, sidomos lidhur me gëzimin e këtyre të drejtave: Të drejtat politike ku përfshihen kryesisht: e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje, e drejta e votimit apo e drejta për të qenë kandidat, dhe për të pasur hyrje të barabartë në shërbimet publike. Të drejtat e tjera civile ku përfshihen kryesisht: e drejta e lëvizjes së lirë dhe e zgjedhjes së vendbanimit në territorin e një shteti; e drejta shtetësisë; e drejta e martesës dhe e zgjedhjes së bashkëshortit/bashkëshortes; e drejta e pronës; e drejta e trashëgimisë; e drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar; e drejta e lirisë së mbledhjes dhe krijimit të organizatave paqësore.

Të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore ku përfshihen kryesisht: e drejta e punës; e drejta e krijimit të sindikatave dhe e anëtarësimit në to; e drejta e strehimit; e drejta e trajtimit shëndetësor, sigurimit shoqëror dhe shërbimeve sociale; e drejta e arsimit dhe përgatitjes profesionale etj. (neni 5).

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës (CRC)⁹, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 Nëntor 1989, ka hyrë në fuqi në vitin 1990. Shqipëria e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1992¹⁰.

Konventa garanton parimin e barazisë dhe përcakton detyrimin e shteteve palë që të ndërmarrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që fëmija të jetë i mbrojtur nga të gjitha format e diskriminimit ose ndëshkimit, për shkak të pozitës, veprimtarive, opinioneve të shprehura ose bindjeve të prindërve të tij, të përfaqësuesve të tij ligjor ose të anëtarëve të familjes së tij.

⁸ Ligji Nr. 7768, datë 09.11.1993.

⁹Convention on the Rights of the Child.

¹⁰Ligji datë 27.02.1992.

Gjithashtu, Konventa përmban edhe 2 Protokolle Opsional, të ratifikuar nga R.Sh. Protokolli Opsional i Konventës së OKB-së “Për Të Drejtat e Fëmijëve”, Për Përfshirjen e Fëmijëve në Konfliktet të Armatosur¹¹ dhe Protokolli Opsional i Konventës Së OKB-së “Për të Drejtat e Fëmijëve”, Për Shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijë¹².

Instrumentet në kuadrin e Këshillit të Evropës

Sipas standardeve të Këshillit të Evropës, legjislacioni për trajtimin e barabartë duhet të ndalojë diskriminimin, ngacmimin dhe viktimizimin për shkaqe të tilla, si gjinia ose seksi, origjina racore ose etnike, aftësitë e kufizuara, orientimi seksual, mosha dhe feja ose besimi, midis të tjerash, të ofrojë të drejta të zbatueshme në këto fusha, dhe të krijojë struktura kombëtare për promovimin e barazisë. Të njëjtat standarde identifikojnë që fusha e legjislacionit të trajtimit të barabartë mbulon më së shumti punësimin, trajnimin dhe formimin profesional, por mund të përfshijë gjithashtu edhe fusha jashtë punës, si akses në mallra dhe shërbime, strehim, arsimit, mbrojtja sociale, kujdesi shëndetësor ose përparësi të tjera sociale.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore¹³ është nënshkruar në Romë me 4 Nëntor 1950 dhe hyri në fuqi me 3 Shtator të vitit 1953. Shqipëria e ka ratifikuar Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore në vitin 1996¹⁴.

Standardet e Këshillit të Evropës bazohen në nenin 14 të KEDNJ, “*ndalimi i diskriminimit*”, në përmbajtjen e të cilit parashikohet se: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*”. Siç mund të konstatohet, në këtë nen mbrojtja nga diskriminimi gjen zbatim në lidhje me ato të drejta dhe liri themelore të parashikuara në Konventë dhe në Protokollin e saj shtesë.

Protokolli 12 (2000) i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore, i cili është ratifikuar nga Shqipëria në Nëntor 2004 dhe ka hyrë në fuqi me 5 Prill 2005i, e zgjeron fushën e ndalimit të diskriminimit duke garantuar trajtim të barabartë lidhur me gëzimin e çdo të drejte të parashikuar me ligj (përfshirë të drejtat sipas legjislacionit kombëtar).

Në nenin 1 “*ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit*”, sanksionohet në mënyrë të shprehur se: “*Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër*” dhe se “*Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1*”.

¹¹Ratifikuar me Ligj Nr. 9833, datë 22.11.2007.

¹²Ratifikuar me Ligj Nr. 9834, datë 22.11.2007.

¹³KEDNJ u nënshkrua në nëntor 1950 dhe hyri në fuqi në shtator 1953 pas ratifikimit të dhjetë të saj nga Dukati i Luksemburgut.

¹⁴Ligji Nr. 8137, datë 31.07.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, i ndryshuar.

Karta Sociale Evropiane e rishikuar¹⁵, e nënshkruar më 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i R.Sh-së në vitin 2002, sanksionon parimin e barazisë dhe parimin e mosdiskriminimit. Karta Sociale Evropiane e vitit 1961/1965 përbën një traktat kryesor evropian dhe plotëson Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale.

Karta Sociale Evropiane e rishikuar, e nënshkruar në vitin 1998 dhe e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 2002, po zëvendëson gradualisht Kartën Sociale Evropiane.

Konventa Kuadër e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare e ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në vitin 1999¹⁶, ka qëllim themelor sigurimin e zbatimit të parimeve të barazisë dhe mos-diskriminimit për personat që i përkasin pakicave kombëtare. Kjo konventë ndalon çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare, duke përcaktuar detyrimin e shteteve nënshkruese të kësaj Konvente për t'u garantuar personave që i përkasin pakicave, të drejtën e barazisë para ligjit dhe mbrojtjen e barabartë nga ligji.

Konventa Për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje¹⁷ është ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2012. Qëllimi i kësaj konvente është të angazhojë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe shtetet e tjera nënshkruese për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga të gjitha format e dhunës dhe parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje; duke kontribuar ndaj eliminimit të të gjitha formave të diskriminimit kundër grave dhe promovimit të barazisë thelbësore midis burrave dhe grave; ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës për organizatat dhe agjencitë e zbatimit të ligjit për të bashkëpunuar në mënyrë efektive, me qëllim miratimin e një përqasjeje të integruar për të eliminuar dhunën kundër grave dhe dhunën në familje.

Konventa garanton të drejtat themelore, barazinë dhe mosdiskriminimin e grave nëpërmjet parashikimit të masave për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, gjuhe, feje, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjine kombëtare ose sociale, përkatësie në një pakicë kombëtare, pasurie, lindjeje, orientimi seksual, identiteti gjinor, moshe, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, statusi civil, statusi emigranti ose refugjati ose statusi tjetër.

Standardet e Bashkimit Evropian

Standardet më gjithëpërfshirëse në lidhje me mosdiskriminimin janë zhvilluar në nivelin e Bashkimit Evropian. Ato përbëhen nga një sërë burimesh të ndryshme ligjore që përcaktojnë format e ndryshme të diskriminimit dhe i detyrojnë shtetet anëtare t'i zbatojnë këto standarde në kornizën e tyre legjislativë, si dhe në praktikën gjyqësore. Këto njohje kanë çuar në zhvillimin e disa standardeve legjislativë për mbrojtjen nga diskriminimi, me vëmendje të veçantë tek ata persona dhe grupe që konsiderohen të jenë më të prekshëm sesa të tjerët.

¹⁵Ligji Nr. 8960, datë 24.10.2002.

¹⁶Ligji Nr. 8496, datë 03.06.1999.

¹⁷Ligji Nr. 104 datë 11.08.2012 "Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje".

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) i dedikon një kre/titull të tërë “barazisë”. Neni 20 parashikon barazinë përpara ligjit dhe Neni 21 i saj kërkon ndalimin e çdo diskriminimi për çdo shkak, të tillë si gjinia, raca, ngjyra, origjina etnike ose shoqërore, karakteristikat gjenetike, gjuha, feja ose besimi, opinionin politik apo ndonjë mendim tjetër, anëtarësia e një pakice kombëtare, pasuria, lindja, moshë ose orientimi seksual.

Të drejtat dhe parimet e sanksionuara në Kartë duhet të zbatohen në praktikën ligjore kombëtare në rastet kur:

- Legjislacioni që zbaton të drejtën e BE-së ka rëndësi (si instrument interpretimi).
- Legjislacioni kombëtar konsiderohet se ndërhyr me të drejtën e BE-së.
- Autoritetet e BE-së kanë vepruar në zbatim të së drejtës së BE-së.

Neni 19 i **Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian** (TFEU) i ka mundësuar Bashkimit Evropian të marrë veprimet e duhura për të luftuar diskriminimin në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës, ose orientimit seksual. Kjo kompetencë ka çuar në miratimin e:

- Direktivës 2000/43/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave, pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”; (Direktiva për racën)
- Direktivës 2000/78/KE “Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës”; (Direktivën për barazinë në punësim)
- Direktivave 2004/113/KE “Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime”; 2006/54/KE “Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës” 2010/41/BE (Direktivat për barazinë gjinore).
- Direktivës Nr. 2024/1500 datë 29.05.2024 të Këshillit të Bashkimit Evropian “Mbi standardet për organet e barazisë në fushën e trajtimit të barabartë dhe mundësive të barabarta midis grave dhe burrave në çështjet e punës dhe profesionit, si dhe ndryshimi i Direktivave 2006/54/EC dhe 2010/41/EU”. Qëllimi i kësaj Direktive është të përcaktojë kërkesat minimale për funksionimin e organeve për promovimin e trajtimit të barabartë ("organeve të barazisë") për të përmirësuar efektivitetin e tyre dhe për të garantuar pavarësinë e tyre, me qëllim të forcimit të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë, siç rrjedh nga Direktivat 2006/54/KE (3) dhe 2010/41/BE (4) të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.
- Direktivës Nr. 2024/1499 datë 07.05.2024 të Këshillit të Bashkimit Evropian “Mbi standardet e organeve të barazisë në fushën e trajtimit të barabartë të personave, pavarësisht racës ose etnisë, trajtimi i barabartë në çështjet e punësimit dhe profesionit të personave pa dallim feje, aftësie të kufizuar, moshe ose orientimi seksual, trajtimi i barabartë ndërmjet grave dhe burrave në çështjet e sigurimeve shoqërore dhe në aksesin në fushën e të mirave dhe shërbimeve, dhe ndryshimin e Direktivave 2000/43/EC dhe 2004/113/EC”. Qëllimi i kësaj direktive është përcaktimi i kërkesave minimale për funksionimin e organeve të barazisë për promovimin e trajtimit të barabartë, me qëllimin për të përmirësuar efektivitetin e tyre dhe për të garantuar pavarësinë e tyre, në mënyrë që të forcohet zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë sikurse rrjedh nga Direktivat e Këshillit 79/7/EEC, 2000/43/EC, 2000/78/EC dhe 2004/113/EC.

Direktivat për Trajtim të Barabartë e Bashkimit Evropian përcaktojnë standardet minimale në legjislacionin për trajtimin e barabartë. Ato ndalojnë diskriminimin, ngacmimet dhe ngacmimet seksuale, viktimizimin në punësim dhe profesion për shkak të përkatësisë gjinore, origjinës racore ose etnike, orientimit seksual, fesë ose besimit dhe aftësisë së kufizuar; dhe në sigurimin e mallrave dhe shërbimeve për shkak të përkatësisë gjinore dhe origjinës racore ose etnike.

Direktiva për Racën ndalon diskriminimin në bazë të përkatësisë racore ose etnike në fushën e punësimit, arsimit, aksesit dhe furnizimit me mallra dhe shërbimeve që janë në dispozicion të publikut, duke përfshirë strehimin, mbrojtjen sociale, përfshirë sigurimin social dhe kujdesin shëndetësor, avantazhet sociale, etj.

Direktiva për Barazinë në Punësim ndalon diskriminimin në bazë të fesë dhe besimit, orientimit seksual, moshës, aftësisë së kufizuar në fushën e punësimit.

Direktivat për Barazinë Gjinore synojnë eliminimin e diskriminimit në fushën e punës, duke përfshirë vetëpunësimin dhe aksesin në mallra dhe shërbime në bazë të gjinisë. Praktika gjyqësore e GJED-së tregon se këtu përfshihet edhe identiteti gjinor.

2. Kuadri Ligjor Shqiptar

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon, në pjesën e dytë të saj, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si vlera që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik shqiptar. Këto të drejta dhe liri janë të ndara në: liri dhe të drejta vetjake; liri dhe të drejta politike; si dhe liri dhe të drejta ekonomike, sociale dhe kulturore.

Në nenin 18/1 të Kushtetutës është parashikuar parimi i barazisë në të cilin sanksionohet se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”* dhe në nenin 18/2, *“Parimi i mosdiskriminimit”*, në përmbajtjen e të cilit sanksionohet se: *“Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”* dhe se *“Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”*.

Në vitin 2016, Kuvendi ka miratuar me unanimitet amendimet kushtetuese në kuadër të reformës në drejtësi, një nga të cilët paraqet ndryshim në kompetencat e KMD. Konkretisht, është amendimi Kushtetutës i cili sanksionon të drejtën e KMD për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, përmes Ligjit Nr. 76/2016, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”*, duke sanksionuar, në nenin 134, se: *“Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të: ... (e) çdo komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”*.

Ligji Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, i cili pas dekretimit nga Presidenti i Republikës dhe botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010. Ky ligj erdhi me propozim të një grupi deputetësh dhe është një hap konkret në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nën frymën e dokumenteve ndërkombëtare dhe njëkohësisht, një hap konkret i përmbushjes së standardeve të anëtarësimit në BE.

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, është në përputhje të plotë me Direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e barazisë dhe konkretisht është përfaqësues plotësisht me: Direktivën 2000/43/KE për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”, Direktivën 2000/78/KE për “Përcaktimin e një kuadri të 12 përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”, Direktivën 2004/113/KE për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet burrave dhe grave në mundësinë për të pasur dhe për t’u furnizuar me mallra dhe shërbime” dhe Direktivën 2006/54/KE për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”.

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë e individit si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi.

Fushat kryesore në të cilat sigurohet kjo mbrojtje ligjore përfshijnë mbrojtjen nga diskriminimi në punësim si dhe gjatë periudhës së ushtrimit të marrëdhënieve të punës, në fushën e arsimit, si dhe në fushën e ofrimit të të mirave dhe shërbimeve.

Me qëllim zbatimin efektiv të këtij ligji, është themeluar institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Komisioneri shtrin kompetencat jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat. Në nenin 39, ligji ka parashikuar detyrimin e Këshillit të Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 18 të këtij ligji. Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka 9 vite nga miratimi dhe hyrja në fuqi e tij dhe këto akte nënligjore nuk janë nxjerrë ende.

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë¹⁸, ndalon çdo formë diskriminimi, të parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion. Neni 9/2, përkufizon diskriminimin si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët¹⁹.

Përshtatja e arsyeshme e vendit të punës për personat me aftësi të kufizuar ose persona të ndodhur në kushte të tjera, të përmendura në pikën 2, të këtij neni është përcaktuar si detyrim për punëdhënësin. Mohimi i përshtatjes së arsyeshme përbën diskriminim.

Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:

¹⁸Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995, ndryshuar në vitin 2015.

¹⁹Ndryshuar me Ligjin Nr. 136/2015, datë 05.12.2015.

- a) mundësinë për punësim, vetëpunësim dhe profesion, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe kushtet e rekrutimit, të çfarëdo lloj dege të aktivitetit dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, si dhe ngritjen në detyrë;
- b) qasjen në të gjitha llojet dhe në të gjitha nivelet e orientimit profesional, trajnimit profesional, trajnimit dhe ritrajnimit të avancuar profesional, përfshirë edhe përvojën e punës në praktikë;
- c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën;
- a) anëtarësimin dhe aktivizimin në organizata sindikale dhe organizata të punëdhënësve, ose ndonjë organizatë, anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, duke përfshirë përfitimet e siguruar nga këto organizata.

Ndryshimet e rëndësishme të vitit 2015, referojnë në ndjekjen e procedurave të ankimit, të përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi, kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion dhe në të gjitha procedurat e ankimit lidhur me sa më lart, zbatohet parimi i zhvendosjes së barrës së provës.

Në Kodin e Punës, parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit parashikohet edhe në dispozita të tjera si: Ndalimi i përdorimit të punës së detyruar si masë diskriminimi racial, shoqëror, kombëtar ose fetar (neni 8, prg. 2, germa (e); Barazia në shpërblim (neni 115); Zgjidhja e kontratës pa shkaqe të arsyeshme (neni 146) ku konkretisht parashikohet se: *“1. Zgjidhja e kontratës nga punëdhënësi, konsiderohet pa shkaqe të arsyeshme kur: c) shkel ndalimin e diskriminimit, sipas përcaktimeve në këtë Kod dhe në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”*;

Ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesve të sindikatës (neni 181/3) dhe mos dhënia e pëlqimit nga përfaqësuesit e organizatës sindikale për zgjidhjen e kontratës, nëse zgjidhja e kontratës shkel parimin e trajtimit të barabartë (neni 181/4); Ndalimi i diskriminimit për shkak të pjesëmarrjes ose jo në grevë (neni 197/4); Trajtimi i barabartë (neni 149/2) lidhur me përfundimin e kontratave me afat të caktuar, ku përcaktohet shprehimisht se: *“Punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të caktuar nuk mund të trajtohen në mënyrë më pak të favorshme se punëmarrësit e punësuar me kontratë me afat të pacaktuar, lidhur me kushtet e punësimit, trajnimit dhe mundësive të karrierës në punë. Punëmarrësit me kontratë pune me afat të caktuar gëzojnë të njëjtat të drejta, përpjesëtimisht, si punëmarrësit me kontratë me afat të pacaktuar.”* etj.

Kodi Penal²⁰ ka pësuar ndryshime të rëndësishme në vitin 2013 lidhur me mbrojtjen e komunitetit LGBTI. Konkretisht, Parlamenti shqiptar miratoi, si rrethanë rënduese për dënimin e një krimi, përfshirjen e orientimit seksual si shkak të ri, kur vepra penale është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë, ndër të tjera, me këtë shkak, (neni 50/j). Konkretisht, është parashikuar se: *“Rëndojnë dënimin rrethanat që vijnë: j) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive që kanë të bëjnë me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike ose aftësinë e kufizuar.”*

Shkelja e barazisë së shtetasve (neni 253) parashikon dënimin e kryerjes për shkak të detyrës e në ushtrim të saj, nga ana e punonjësit me funksion shtetëror apo në shërbim publik, të dallimeve mbi bazë origjine, seksi, orientimi seksual ose identiteti gjinor, gjendjes shëndetësore, bindjeve fetare, politike, të veprimtarisë sindikale ose për shkak të përkatësisë në një etni, komb, racë apo fe të caktuar, që konsiston në krijimin e privilegjeve të padrejta ose në refuzimin e një të drejte ose

²⁰Ndryshuar nga Ligji Nr. 144/2013; Ndryshuar në vitin 2017.

përfitimi që buron nga ligji. Me amendimet e vitit 2013, u shtua orientimi seksual dhe identiteti gjinor²¹.

Dispozita në lidhje me nxitjen e urrejtjes ose grindjeve (neni 265) u ndryshua gjithashtu në vitin 2013 duke shtuar orientimin seksual si shkak të mbrojtur nga diskriminimi, si dhe duke zgjeruar fushëveprimin e tij me aktin e përhapjes dhe shpërndarjes së çdo përmbajtjeje që nxit urrejtje ose grindje. Sipas kësaj dispozite, *“Nxitja e urrejtjes dhe e grindjeve, për shkak të racës, etnisë, fesë ose orientimit seksual, si dhe përgatitja, përhapja ose ruajtja, me qëllim përhapjen e shkrimeve me përmbajtje të tilla, e kryer me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet”*. Nevoja për ndryshime në Kodin Penal është ende prezente, Komisioneri ndër vite ka rekomanduar heqjen e termit *“marrëdhënie homoseksuale”* që përmendet si në titull ashtu edhe në përmbajtje të neneve 100 deri 107 të Kodit Penal, Seksioni VI, ku parashikohen krimet seksuale. Shprehja *“marrëdhënie homoseksuale”* përfshin si marrëdhëniet seksuale midis individëve të të njëjtës gjini ashtu edhe atyre të gjinive të ndryshme. Për këtë arsye, marrëdhënia juridike apo vlera shoqërore që kërkohet të mbrohet nga legjislacioni penal nëpërmjet këtyre veprave penale, garantohet më së miri pa referuar në përmbajtjen e neneve të mësipërme termin *“marrëdhënie homoseksuale”*.

Kodi i Familjes²². Statusi ligjor i një çifti lidhet me një sërë implikimesh ligjore në fusha të ndryshme të jetës. Në Shqipëri, martesë është ende e kufizuar tek një burrë dhe një grua të moshës 18 vjeç e sipër. Martesat e të njëjtës seks nuk janë ende të pranueshme. Megjithatë, në jetën e përditshme, të drejtat që rrjedhin nga bashkëjetesa janë të rëndësishme për dhënien me qira të një banese, për kontratat e sigurimit, për përfitimet sociale etj. Megjithatë, bashkëjetesa në Kodin e Familjes që është në fuqi në Shqipëri, përkufizohet si një bashkim faktik midis një burri dhe një gruaje që jetojnë si çift, të cilët jetojnë përbashkërisht në një jetë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme.

Kodi i Procedurave Administrative²³ parashikon si një nga parimet e përgjithshme parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit (neni 17), sipas të cilit: *“1. Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë” dhe “3. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër”*.

Lidhur me mjetet e kërimit të provës në kuadër të hetimit administrativ, Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit (neni 82, paragrafi 2). Konkretisht, ky Kod ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit, duke sanksionuar shprehimisht se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

²¹Në këtë dispozitë janë shtuar fjalë, me Ligjin Nr. 144/2013, datë 02.05.2013.

²²Kodi i Familjes i Shqipërisë, Ligji Nr. 9062, miratuar në maj, 2003.

²³Miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, Fletore Zyrtare Nr. 87/2015.

Kodi i Procedurës Civile. Ndryshimet e fundit që i janë bërë Ligjit Nr. 8116, datë 29.03.1996 “*Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, të miratuara përmes Ligjit Nr. 38/2017, datë 30.03.2017 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 98, datë 5 Maj 2017, kanë hyrë në fuqi në Nëntor 2017. KMD konstaton se edhe me këto ndryshime, nuk është ndërmarrë ndonjë nismë për të ndryshuar barrën provës gjatë procesit civil, në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, një kërkesë kjo e direktivave të Bashkimit Evropian në fushën e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit. Në përputhje me to, Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar, në Kreun VI “*Procedurat përpara gjykatës*”, ka parashikuar zhvendosjen/shpërndarjen e barrës së provës në rastet kur gjykata shqyrton një çështje diskriminimi, ndryshe nga parimi i përgjithshëm për barrën e provës, sipas të cilit detyrimi për të vërtetuar faktet e nevojshme për të provuar pretendimin është i palës që e pohon atë. Bazuar në këto standarte, KMD në mënyrë të përsëritur ka dërguar rekomandime për zhvendosjen e barrës së provës në procesin civil, kur një çështje ka të bëjë me pretendim diskriminimi, të cilat nuk janë marrë parasysh. Parimi i barrës së provës parashikohet nga Kodi i Procedurës Civile në nenin 12, ku thuhet: “*Pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj*”. Pra, nëse normalisht detyrimin për të provuar pretendimet duhet t’u kishte paditësi, sipas legjislacionit të BE-së në çështjet e diskriminimit, në momentin që paditësi vërteton rastin prima facie - “*në pamje të parë*”²⁴, atëherë i kërkohet të paditurit, që të paraqesë prova se ai/ajo nuk e ka diskriminuar paditësin, duke rrëzuar prezumimin faktik se ka patur diskriminim.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, e shtrin zbatimin e tij si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Me Ligjin “*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”, Kodin e Procedurave Administrative (Kodi i ri), dhe ndryshimet e fundit në Kodin e Punës, është harmonizuar dhe rregulluar shpërndarja e barrës së provës lidhur me çështjet e diskriminimit në sektorin publik. Me qëllim rregullimin dhe harmonizimin e zhvendosjes së barrës së provës për çështjet e diskriminimit edhe në sektorin privat, është e nevojshme që një parashikim i tillë të shtohet edhe në Kodin e Procedurës Civile.

Kodi i Procedurës Civile është ligji bazë për procedurat që gjykatat duhet të respektojnë gjatë veprimtarisë së tyre, duke e bërë këtë Kod me rëndësi nga këndvështrimi i garantimit të mbrojtjes efektive nga diskriminimi. Kodi i Procedurës Civile, duke qenë në një nivel më të lartë në hierarkinë e normave, se sa ligjet e miratuara me shumicë të thjeshtë, përfshirë këtu Ligjin Nr. 10 221/2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar, e bën problematike zbatimin e këtij standarti. Kështu, gjykatat gjenden midis kërkesave të ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, i ndryshuar, i cili ka parashikuar zhvendosjen e barrës së provës, në përputhje me legjislacionin e BE, dhe Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon rregullin e përgjithshëm, sipas të cilit, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë pretendimin e saj.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, miratuar me Ligjin Nr. 37/2017, datë 30 Mars 2017, ka hyrë në fuqi me 1 Janar 2018. Ky Kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

²⁴ Paditësi sjell fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka ndodhur diskriminimi në mungesë të një shpjegimi të përshtatshme.

Ky Kod përmban rregullime edhe për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç, sipas parashikimeve në nene të veçanta (neni 1).

Në Kreun II të Kodit parashikohen Parime të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku, ndër të tjerë, sanksionohet *“Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi”*, neni 11, i cili parashikon shprehimisht se: *“1. Të drejtat që burojnë nga ky Kod i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit”*, dhe *“2. Të drejtat për të miturin, të parashikuara në këtë Kod, mbrohen nga të gjitha format e diskriminimit për një nga shkaqet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni”*.

Kështu, mbrojtja nga diskriminimi i çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit, garantohet për të gjitha shkaqet e diskriminimit të listuara me ligj por jo shteruese, ç’ka është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 1 të Ligjit Nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar. Gjithashtu, kjo mbrojtje garantohet për të gjitha format e diskriminimit, citohet në Kod, duke referuar në parashikimet e nenit 3 të Ligjit Nr. 10 221/2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, i ndryshuar, ku parashikohen ato, sipas përkufizimeve përkatëse.

Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, është miratuar në Shkurt të vitit 2017 dhe ka hyrë në fuqi tre muaj pas miratimit, pra në Qershor të vitit 2017. Ky ligj përcakton të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës (neni 1). Bazuar në këtë ligj, realizimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijës bëhet duke zbatuar këto parime:

1. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërruar dhe progresive.
2. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën.
3. **Barazia dhe mosdiskriminimi.**
4. Përgjegjësia parësore e prindit dhe kujdestarit për t’i krijuar kushtet e jetesës, për t’i garantuar mirëritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin fëmijës.
5. Ndarja e përgjegjësisë ndërmjet prindit ose kujdestarit të tij, autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë për mbrojtjen e fëmijës.
6. Çdo fëmijë duhet të jetojë e të rritet në një mjedis të përshtatshëm familjar dhe ndarja e fëmijës nga familja duhet parë si zgjidhja e fundit.
7. Decentralizimi i shërbimeve që ofrohen për mbrojtjen e fëmijës, ndërhyrja ndërsektoriale dhe partneriteti ndërmjet institucioneve publike e jopublike, të autorizuar me ligj.
8. Ofrimi i shërbimit të personalizuar e të specializuar për çdo fëmijë.
9. Respektimi i dinjitetit, nderit dhe personalitetit të fëmijës.
10. Pjesëmarrja, dëgjimi dhe respektimi i mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar.
11. Garantimi i stabilitetit e vazhdimësisë në kujdesin, rritjen e edukimin e fëmijës, duke mbajtur parasysh formimin e tij etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor. (neni 5, “parime të përgjithshme”).

Me këtë ligj, një rregullim i veçantë parashikohet për fëmijët me aftësi të kufizuara (neni 32) dhe atyre që i përkasin pakicave kombëtare (neni 33).

Ligji Nr. 129/2021 “Për statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, rregullon kriteret dhe procedurat për përfitimin e statusit “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”, si dhe i të drejtave e përfitimeve që rrjedhin nga ky status.

Qëllimi i këtij ligji është marrja në mbrojtje dhe në përkujdesjen e shtetit të fëmijës, njëri ose të dy prindërit e të cilit apo, në mungesë të tyre, personi i ngarkuar ligjërisht me kujdestarinë e tij kanë humbur jetën në kushtet e përcaktuara nga Ligji “Për statusin ‘Dëshmor i Atdheut’”, në përpjekje për mbrojtjen e pronës publike apo mbrojtjen e jetës së individit, si rezultat i një akti vetëmohimi ose patriotizmi, për shkak të plagëve të marra apo të sëmundjeve të shkaktuara si pasojë e kryerjes me përgjegjshmëri të detyrës dhe ushtrimit të profesionit në kushte të jashtëzakonshme apo të fatkeqësisë natyrore. Ky ligj garanton mirëqenien dhe zhvillimin e jetës së fëmijës nëpërmjet ndihmës dhe përkujdesjes efektive të shtetit, bazuar në interesin më të lartë të fëmijës.

Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore. (neni 1). Qëllimi i këtij ligji është që të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë dhe të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet. (neni 2). Ndër të tjera, ky ligj bazohet edhe në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit.

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë parashikohet në nenin 6 të këtij ligji, sipas të cilit: “1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t’i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet”.

Gjithashtu, ky ligj parashikon në pjesë të veçanta, mbrojtjen dhe trajtimin e barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës; në arsim dhe kualifikim; dhe në media. Organet përgjegjëse për mbarëvajtjen e barazisë gjinore, të parashikuar me këtë ligj bashkë me detyrat përkatëse janë: Këshilli i Ministrave; Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore; Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore (ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore); dhe organet e qeverisjes vendore.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nenin 32, pika dh), monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka për qëllim parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të masave të tjera të nevojshme, si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktima të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara, subjekt i këtij ligji. Ky ligj bazohet në parimet e

sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” dhe në aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Zbatimi i dispozitave të këtij ligji, veçanërisht masat për mbrojtjen e të drejtave të viktimave, sigurohen pa diskriminim, për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, është miratuar me datë 13.10.2017 dhe ka hyrë në fuqi në Nëntor 2017. Sipas objektit të tij, të parashikuar në nenin 1, ky ligj rregullon ushtrimin e të drejtave të personave që u përkasin pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me parimet e parashikuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ratifikuar me Ligjin Nr. 8496, datë 03.06.1999, dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, ku Republika e Shqipërisë është palë.

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë ushtrimin e të drejtave specifike të personave që u përkasin një pakice kombëtare, të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e identitetit dallues të pakicave kombëtare, si një përbërës thelbësor i një shoqërie të integruar dhe që garantojnë mosdiskriminimin dhe barazinë e plotë para ligjit. (neni 2, pika 1).

Në nenin 8, thuhet se:

1. “Ndalohet çdo diskriminim ndaj cilido personi për shkak të përkatësisë së tij/së saj në një pakicë kombëtare.
2. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, miratojnë dhe zbatojnë masat e nevojshme:
 - a) për të garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;
 - b) për të mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;
 - c) për të forcuar dialogun ndërkulturor;
 - d) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional.
3. Masat e miratuara në përputhje me pikën 2, të këtij neni, nuk përbëjnë akte diskriminimi”.

Ky ligj parashikon gjithashtu njohjen e pakicave kombëtare, sipas një procedure të caktuar dhe liston të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare në R.Sh. Bazuar në këtë ligj, është ngritur Komiteti për Pakicat Kombëtare, si një institucion qendror në varësi të Kryeministrit, me qëllim sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe të interesave të pakicave kombëtare, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi. Lidhur me këtë ligj janë miratuar vetëm një pjesë e akteve nënligjore, të parashikuara nga vetë Ligji. Mos miratimi i plotë i akteve nënligjore i bën disa nga segmentet e ligjit jo efektiv, duke lënë të pa zbatuara një numër të drejtash të rëndësishme të pakicave.

Ligji Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” përcakton format, kushtet, procedurën dhe rregullat për organizimin dhe administrimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, me qëllim mbrojtjen e të drejtave themelore të individit dhe të interesave të ligjshëm të tij.

Parimet e ndihmës juridike, sipas nenit 4 të këtij ligji, përcaktojnë se, dhënia e ndihmës juridike bazohet, ndër të tjera, në parime si: akses i barabartë i individëve në ndihmën juridike; barazi dhe mosdiskriminim i individëve që gëzojnë të drejtën për ndihmë juridike si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave vulnerabël.

Ky ligj, ka parashikuar, në nenin 11, kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike, sipas të cilit: Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesit shoqëror;
- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor; ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) personave, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, ka për qëllim të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundur pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundur autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes.

Në këtë ligj jepen përkufizime të termave si “*Diskriminim i personave me aftësi të kufizuara*”, “*Mohim i përshtatjes së arsyeshme*” apo edhe “*Përshtatje e arsyeshme*” të cilat janë në përputhje me përkufizimet e Ligjit Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

Në nenin 4 përcaktohet shprehimisht se, parimet bazë të këtij ligji, janë, ndër të tjera: a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë; b) barazia, përfshirë barazinë gjinore, që siguron se personat me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta.

Në nenin 16, “Monitorimi”, paragrafi 2, parashikon se: “Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi monitoron zbatimin e këtij ligji në përputhje me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, në zbatim të detyrimeve të parashtruara në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Ligji Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”²⁵, sipas objektit të tij në nenin 2, përcakton procedurën dhe kushtet për mbrojtjen e shëndetit mendor, nëpërmjet sigurimit të kujdesit shëndetësor, sigurimit të një mjedisi social të përshtatshëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor dhe nëpërmjet politikave parandaluese për mbrojtjen e shëndetit mendor.

Në nenin 3 jepen përkufizimet, ku termi “diskriminim” përkufizohet në përputhje me Ligjin Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Ndër parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor parashikohet, sipas nenit 5/1, germa (a), trajtimi i barabartë dhe pa diskriminim i personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzor.

Neni 8 parashikon mbrojtjen nga diskriminimi, sipas të cilit “Personave me çrregullime të shëndetit mendor u sigurohet mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin, në bazë të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi, në këtë fushë”.

Ky ligj është në përgjithësi në përputhje me nenin 25 dhe nene të tjera të KPDAK përsa i përket shërbimeve që parashikon për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Përfundimisht në neni 9 që parashikon heqjen ose kufizimin e zotësisë për të vepruar dhe nenet 21-25 mbi trajtimin e pavullnetshëm, të cilat nuk janë në përputhje me KPDAK.

Ligji Nr. 7889/1994 “Për statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, parashikon se Shoqëria dhe shteti marrin ne mbrojtje invalidët, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, t’u sigurohet niveli ekonomik i nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoz, të kenë kushte banimi, të shfrytëzojnë mjedisin e jashtëm, të kenë një punë të përshtatshme, si dhe t’u krijohen mundësi normale për kurim, arsimim dhe veprimtari çlodhëse e argëtuese (neni 2). Ky ligj parashikon disa lehtësi për individët që gëzojnë statusin e invalidit të punës, si: pajisjen me:

- a) mjete lëvizëse përfshi edhe autovetura dhe pajisje të ndryshme ortopedike.
- b) me mjete ndihmëse dëgjimore e pamore speciale;
- c) me mjete ndihmëse kardiake etj;

Për të paralizuarit dhe të gjymtuarit rëndë që nuk lëvizin, organizohet shërbimi mjekësor në banesë falas; Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas ndërsa udhëtimi me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat ndërqytetas bëhet me 50 përqind të vlerës së biletës; Invalidët favorizohen në ndjekjen e kurseve të kualifikimit e të rikualifikimit profesional, si dhe ndjekjen e shkollave të larta.

²⁵ Ndryshuar me Ligjin Nr. 61/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 44/2012, datë 19.4.2012 “Për shëndetin mendor”.

Ligji Nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar. Bazuar në nenin 1 të tij, përfitojnë nga ky ligj të gjithë personat me mungesë të plotë ose të pjesëshëm shikimi, të lindur ose të fituar, të cilët sipas kriterëve mjekësorë janë të paaftë për punë në kushte normale. Shteti mbron të verbërit nga të gjitha llojet e shfrytëzimit, diskriminimit, abuzimit, fyerjes dhe talljes. Kur këto përbëjnë vepër penale, iniciativën për fillimin e çështjes penale, përveç kujdestarit e ka edhe organi i prokurorisë apo organizata, në të cilën ata bëjnë pjesë ose përkujdeset për ta (neni 3).

Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar. Nga ky ligj përfitojnë të gjithë invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, pavarësisht nga mosha, koha, vendndodhja e aksidentit dhe çasti i sigurimit. (neni 1).

Shteti krijon kushte për të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive (neni 3). Shteti mbron të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë nga të gjithë llojet e shfrytëzimit, të diskriminimit, të abuzimit dhe të fyerjes (neni 4). Edhe ky ligj parashikon disa lehtësi dhe përfitime për personat që gëzojnë këtë status.

Ligji Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”²⁶, i cili ka shfuqizuar Ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, përcakton rregullat dhe mekanizmat për përfitimin e asistencës sociale, autoritetet përgjegjëse për garantimin e kësaj të drejte, si dhe marrëdhëniet e financimit të ofrimit dhe përfitimit të asistencës sociale.

Ky ligj ka për qëllim:

- a) të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore;
- b) të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre; c) të garantojë asistencë sociale nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për foshnjat e porsalindura;
- c) mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale.

Ligji parashikon se një ndër parimet bazë, në bazë të të cilit funksionojnë programet e asistencës sociale është edhe parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit të çdo individi, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çdo shkak tjetër.

²⁶ Ndryshuar me Ligjin Nr. 79/2023, datë 12.10.2023.

Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”²⁷. Ky ligj ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror. (neni 1).

Ligji përcakton llojet e përfitimeve dhe lehtësive, individët dhe grupet e individëve që përmbushin kushtet për të përfituar, si dhe procedurat e kërimit të të drejtave të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe rolin dhe përgjegjësitë e organeve publike dhe jopublike të ngarkuara me zbatimin e tij. (neni 2)

Ligji jep një përkufizim të diskriminimit, që është në përputhje dhe harmoni me Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar (neni 3, pika 19). Gjithashtu, ligji parashikon se, shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore, ku ndër të tjera, edhe parimin e mosdiskriminimit. Sipas kësaj të fundit, në nenin 4 pika (ë) përcaktohet se, ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Ligj Nr. 22/2018 “Për strehimin social”²⁸. Ky ligj është miratuar rishtazi në maj 2018 dhe ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2018. Objekti dhe qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Në nenin 10, ligji ka parashikuar parimin e mosdiskriminimit, si një ndër parimet e politikave të strehimit, duke theksuar shprehimisht se: *“1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese. 2. Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për të përfituar strehim në një nga programet sociale të strehimit për shkaqe të përmendura në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur një program social strehimi është i programuar në mënyrë të posaçme dhe të shprehur për t’i ardhur në ndihmë individëve ose grupeve në nevojë.”*

Ligji Nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”²⁹. Qëllimi i këtij ligji është, nga njëra anë, parandalimi dhe goditja e korrupsionit, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat dhe nga ana tjetër, mbrojtja e individëve që sinjalizojnë veprimet ose praktikatat e dyshuara të korrupsionit në vendin e tyre të punës. Edhe pse qëllimi i këtij ligji në vetvete ka të bëjë me parandalimin dhe goditjen e korrupsionit, nga veprimtaria e deritanishme e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka rezultuar se individët të cilët denoncojnë apo sinjalizojnë veprime korruptive të ndodhura në vendin e tyre të punës, janë përballur me situata diskriminuese.

²⁷Ndryshuar me Ligjin Nr. 99/2024, datë 12.9.2024.

²⁸ Ndryshuar me Ligjin Nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

²⁹ Ndryshuar me Ligjin Nr. 150/2020 “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Për këtë arsye, vlerësojmë se rregullimi dhe mbrojtja me ligj e personave që sinjalizojnë veprime apo praktika të dyshuara korruptive, përbën një zhvillim pozitiv edhe në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”³⁰. Ligji “Për arsimin para-universitar në Republikën e Shqipërisë” i miratuar në vitin 2012 ka parashikuar si shkaqe të diskriminimit edhe “*orientimin seksual*”. Neni 5/1 ndonëse nuk i përfshin të gjitha shkaqet e parashikuara në Nenin 1 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ka lënë hapësira të mjaftueshme për zbatimin e këtij të fundit nga sistemi arsimor parauniversitar³¹.

Në nenin 5, ku parashikohet e drejta për arsimim, thuhet shprehimisht se: “*1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.*”

Ligji parashikon edhe parimet e përgjithshme, ku në Nenin 6/3, thuhet se: “*Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t’u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral*”.

Ligji Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”³², ka si qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të tyre dhe parandalimin e sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues. Sipas këtij ligji, të burgosurit duhet të trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat themelore në zbatim të legjislacionit në fuqi, si dhe akteve ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë. Në çdo rast ndaj të burgosurit ndalohet tortura, trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtërues. Të burgosurit duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa njëanshmëri dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Gratë e burgosura trajtohen duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore dhe pa diskriminim për çdo shkak të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore, që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi, që dënohet sipas legjislacionit në fuqi.

Të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor u garantohet trajtim i barabartë, pa diskriminim, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. Trajtimi i tyre kryhet sipas standardeve shëndetësore, që zbatohen për kategoritë e personave me çrregullime të shëndetit mendor, jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Të burgosurve me aftësi të kufizuara u garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, trajtimi pa diskriminim i çdo forme për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre, duke mbajtur parasysh standardet e legjislacionit në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.

³⁰ Ndryshuar me Ligjin Nr. 56/2015, datë 28.5.2015, Nr. 48/2018, datë 23.7.2018, Nr. 44/2023, datë 15.6.2023; Nr. 99/2012, datë 12.9.2024.

³¹ KMD, Raport i Veçantë “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI në Shqipëri”

³² Ndryshuar me Ligj Nr. 129 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

Të burgosurit shtetas të huaj ose persona pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale gjatë transferimit dhe pas lirimit.

Ligji Nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Shqipëri”, në nenin 32 parashikon që shërbimet e mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo formë tjetër diskriminimi. Gjithashtu, neni 42 paragrafi 3/b parashikon se komunikimet audiovizuale tregtare nuk duhet të kenë përmbajtje që përfshijnë ose promovojnë diskriminim për shkak të gjinisë, origjinës racore ose etnike, kombësisë, fesë ose besimit, paaftësisë, moshës ose orientimit seksual.

Gjithashtu, sipas Seksionit 4/10 të Kodit të Udhëzimeve Etike për Transmetimet Audiovizuale të miratuara nga Bordi i Autoritetit të Mediave Audiovizuale (AMA), *informacioni i transmetimit nuk duhet të përmbajë përmbajtje diskriminuese në lidhje me shkaqe të tilla si raca, ngjyra, përkatësia etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, mendimet politike, bindjet fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose sociale, ose për ndonjë shkak tjetër.*

Ligji Nr. 79/2021 “Për të huajt”. Ky ligj rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë. Ligji përcakton funksionet dhe kompetencat e autoriteteve shtetërore dhe të subjekteve të tjera, publike e private, shqiptare ose të huaja, që në përputhje me parimin e interesit më të mirë të fëmijës, parimin e së drejtës për jetë familjare, parimin e moskthimit, parimin e procedurave të drejta dhe transparente dhe parimin e mosdiskriminimit, kryejnë aktivitete në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë të bëjnë me të huajt që kërkojnë të hyjnë, që hyjnë, qëndrojnë dhe dalin nga Republika e Shqipërisë.

3. Kuadri Ligjor për Themelimin dhe Funksionimin e KMD

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe struktura organizative

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Ligjin Nr. 10 221, më datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili hyri në fuqi më datë 13 Mars 2010, pas Dekretimit nga Presidenti i Republikës me Dekretin Nr. 6433, datë 24.2.2010 dhe botimit në Fletoren Zyrtare Nr. 15, datë 25 Shkurt 2010.

Në datë 15.10.2020, me Ligjin Nr. 124/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi””, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020, u miratuan ndryshimet ligjore në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të cilat hynë në fuqi me 18 Nëntor 2020.

Bazuar në këtë ligj, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është i vetmi autoritet përgjegjës, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. KMD ushtron kompetencat në tre sfera kryesore: (I) ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit përmes shqyrtimit të ankesave, kryerjes së hetimeve administrative, vendosjes së sanksioneve administrative dhe pjesëmarrje në gjykatë për çështjet civile; (II) monitorimin e zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe (III) rritjen e ndërgjegjësimit.

Komisioneri e mbështet punën e tij në zbatimin e të gjithë mekanizmave ligjorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë.


Zyra e KMD

Bazuar në nenin 22, pika 2, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zyra ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara me ligj.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin me vendimin Nr. 34, datë 20.05.2010 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, miratoi strukturën organizative të Zyrës së Komisionerit. Me këtë strukturë organizative, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka funksionuar me 4 drejtori dhe 1 sektor, nga viti 2010 kur është themeluar si institucion deri në vitin 2018.

Me Vendimin Nr. 88, datë 23.07.2018, të Kuvendit të Shqipërisë, është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organikës së Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në bazë të këtyre ndryshimeve është rritur numri i stafit të Zyrës, nga 23 punonjës që ishin me strukturën e vjetër në 34 punonjës me strukturën e re. Në kuadër të projektit të përbashkët të BE/KiE “Rritja e efektivitetit të sistemit Shqiptar të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe anti-diskriminimit”, KMD pilotoi 3 zyra rajonale në qytetet Korçë, Gjirokastrë dhe Shkodër. Me strukturën e re, tre zyrat rajonale të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytetet Korçë, Fier, Shkodër, bëhen zyra të përhershme. Në bazë të strukturës së re, me qëllim forcimin e kapaciteteve monitoruese të KMD, janë parashikuar specialist të posaçëm për monitorim dhe raportim.

Struktura organizative e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi



Kompetencat e Komisionerit

Direktiva e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit Evropian, 2006/54/KE, në nenin 20 të saj, lidhur me organet e barazisë, parashikon detyrimin për vendet anëtare të ngritjes së organeve të posaçme në nivel kombëtar për promovimin, analizën, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë të individëve.

Në këtë nen parashikohen, gjithashtu, edhe kompetencat kryesore që duhet të gëzojnë këto organe të barazisë dhe, konkretisht:

- të ofrojnë ndihmë të pavarur për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre në lidhje me diskriminimin;
- të kryejnë sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin;
- të publikojnë raporte dhe të japin rekomandime për çdo çështje që lidhet me diskriminimin.

Kompetencat e KMD-së janë parashikuar në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Sipas parashikimeve të këtij neni, KMD-ja gëzon një sërë kompetencash që shkojnë përtej parashikimeve të Direktivës 2006/54/KE.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin përkatës dhe që kanë për qëllim ofrimin e ndihmës për viktimat e diskriminimit në ndjekjen e ankesave të tyre për diskriminim, përfshijnë:

- shqyrtimin e ankesave nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj;
- shqyrtimin e ankesave nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- kryerjen e hetimeve administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji;
- vendosjen e sanksioneve administrative sipas përcaktimit të këtij ligji;
- të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.

Kompetenca të KMD-së të parashikuara në nenin 32 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar dhe që kanë për qëllim kryerjen e sondazheve të pavarura në lidhje me diskriminimin, përfshijnë:

- kryerjen e sondazheve në lidhje me diskriminimin;
- monitorimin e zbatimit të këtij ligji dhe Ligjit “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”.

Kompetenca të KMD-së që kanë për qëllim publikimin e raporteve dhe dhënien e rekomandimeve për çdo çështje që lidhet me diskriminimin, përfshijnë:

- adresimin e rekomandimeve autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues;
- publikimin e raporteve dhe përgatitjen e rekomandimeve për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- kontribuimin në raportimet dhe, sipas rastit, prezantimin e raporteve para organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë.

Kompetenca të KMD-së, të parashikuara në ligjin e mësipërm dhe që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit, përfshijnë:

- nxitjen e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara, ndër të tjera për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara;
- adresimin drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin;
- informimin për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje;
- zhvillimin e dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare;
- zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

IV. VEPRIMTARIA NË MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI DHE PROMOVIMI I BARAZISË

1. Ofrimi i ndihmës për viktimat e diskriminimit

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), asistencë ndaj viktimave të diskriminimit realizohet përmes:

- Shqyrtimit të çështjeve nga KMD;
- Pjesëmarrje e çështjeve të diskriminimit në gjykatë.

2. Shqyrtimi i çështjeve nga KMD

Bazuar në Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kompetencë:

- Të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në Ligjin Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;
- Të kryejë hetime administrative pas marrjes së informacionit të besueshëm për shkelje të këtij ligji.
- Të bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues.
- Të vendosë sanksione administrative sipas përcaktimit të këtij ligji.

3. Procedura e shqyrtimit të ankesave

Procedura para Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi fillon me plotësimin e një ankese.

Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitimë që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para Komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal (neni 33 i Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” të ndryshuar).

Ankesa duhet të ketë informacion lidhur me viktimën e diskriminimit, informacion mbi identifikimin e subjektit i cili pretendohet të ketë kryer diskriminim, si dhe shpjegime dhe fakte që ankuesi disponon lidhur me diskriminimin e pretenduar, si dhe masat që kërkohen të merren nga Komisioneri.

Ankesa duhet të nënshkruhet nga personi apo përfaqësuesi i tij.

Në qoftë se ankesa plotëson kushtet e ligjit për t'u pranuar ajo i nënshtrohet një shqyrtimi të mëtejshëm bazuar në nenin 33 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Procedura e hetimit përfshin grumbullim informacioni lidhur me çështjen, mund të zhvillohen edhe inspektime apo seanca dëgjimore mes palëve.

Pas analizimit të fakteve të grumbulluara bazuar në procedurën e hetimit, Komisioneri del me vendim brenda 90 ditëve dita e regjistrimit të ankesës. Nëse gjatë procedurës administrative është, zhvilluar seancë dëgjimore, atëherë vendimmarrja e KMD zgjatet me 90 ditë të tjera.

Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre. Nëse Komisioneri urdhëron rregullime ose masa, subjekti kundër të cilit është paraqitur ankesa, raporton brenda 30 ditëve para Komisionerit në lidhje me veprimet e ndërmarra për zbatimin e vendimit. Në rast se subjekti, kundër të cilit është paraqitur ankesa nuk e informon Komisionerin ose nuk e zbaton vendimin, Komisioneri vendos masë për ndëshkimin me gjobë për personin kundër të cilit është paraqitur ankesa. Sanksioni me gjobë shfuqizohet nëse personi kundër të cilit është paraqitur ankesa, e zbaton vendimin brenda shtatë ditëve pasi është vendosur sanksioni.

Si mjet të fundit, kur subjekti fizik ose juridik privat nuk i përmbahet vendimit të Komisionerit ose nuk e paguan gjobën brenda tre muajve pas afatit të caktuar nga Komisioneri dhe sanksioni nuk është kundërshtuar në gjykatë, Komisioneri mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente heqjen apo pezullimin e lejes ose autorizimit të subjektit fizik ose juridik për ta ushtruar veprimtarinë e tij. Subjekti fizik ose juridik, ndaj të cilit merret masa ndëshkimore me gjobë, ka të drejtë të ankohet në gjykatën kompetente, sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Për çështjet me objekt gjuhën e urrejtjes, operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, detyrim ky i bërë me ndryshimet e LMD-së në vitin 2020.

Procedura e regjistrimit të ankesave

Gjatë vitit 2024 pranë Drejtorisë së Pritjes së Ankesave janë regjistruar për t'u shqyrtuar 265 ankesa nga të cilat:

- 26 (njëzet e gjashtë) janë paraqitur dhe asistuar nga specialistët e DPA-së,
- 116 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë) kanë ardhur me postë,
- 44 (dyzet e katër) kanë ardhur nga info@kmd.al,
- 46 (dyzet e gjashtë) Zyra Rajonale Korçë,
- 18 (tetëmbëdhjetë) Zyra Rajonale Fier,
- 15 (pesëmbëdhjetë) Zyra Rajonale Shkodër.

Bazuar në numrin total të ankesave, rezulton se 66.4% e tyre i janë drejtuar Zyrës së KMD në Tiranë dhe janë regjistruar nga Drejtoria e Pritjes së Ankesave, ndërsa 33.6% e tyre kanë ardhur nga Zyrat Rajonale Korçë, Fier dhe Shkodër dhe janë regjistruar po nga kjo drejtori, në varësi të së cilës janë Zyrat Rajonale. Po ashtu nga numri total i ankesave (265), 12% e tyre janë shtetas migrantë brenda vendit, ndërsa 0.8% janë shtetas të huaj.

Gjatë vitit 2024 bashkëpunimi me institucionet, referimi i rasteve dhe zgjidhja e tyre me ndërmjetësim ka pësuar një rritje të ndjeshmë, sidomos në nivel rajonal.

Konkretisht Zyra Rajonale Korçë numëron:

- 20 (njëzetë) raste referuar përfaqësuesit të Avokatit të Popullit në Korçë;
- 6 (gjashtë) raste referuar Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Korçë;
- 35 (tridhjetë e pesë) raste referuar Zyrës së Ndihmës Juridike Falas në Korçë;
- 90 (nëntëdhjetë) ndërmjetësime dhe asistencë ligjore.

Zyra Rajonale Fier numëron:

- 16 (gjashtëmbëdhjetë) ankesa referuar Zyrës së Shërbimit Ligjor Falas në Fier;
- 6 (gjashtë) ankesa referuar ZR të Avokatit të Popullit në Vlorë;
- 3 (tre) ndërmjetësime;
- 80 (tetëdhjetë) konsulenca ligjore, orientime.

Zyra Rajonale Shkodër numëron:

- 8 (tetë) raste të referuara përfaqësuesit të Avokatit të Popullit në qytetin e Shkodrës;
- 4 (katër) raste të referuara Zyrës së Ndihmës Juridike Falas në qytetin e Shkodrës.
- 21 (njëzet e një) raste referuar zyra kompetente për zgjidhjen e problematikave të tyre.

Nga Drejtoria e Pritjes së Ankesave janë përgatitur dhe përcjellë për kompetencë kundrejt institucioneve:

- KMDIDHP, 2 ankesa
- Avokati i Popullit, 1 ankesë
- AMA-s, 1 ankesë
- Komitetit Shqiptar të Helsinkit, 1 ankesë

Pranë KMD-së kanë ardhur për ndjekje dhe kompetencë nga:

- Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, 3 ankesa.
- KMDIDHP, 2 ankesa


Stafi i DPA ka pritur 236 (dyqind e tridhjetë e gjashtë) qytetarë të interesuar për të marrë informacion kryesisht:

- për mënyrën e ngritjes së një ankese pranë KMD;
- për t'u njohur me kriteret ligjore që duhen plotësuar për të paraqitur një ankesë;
- për vijimin e procedurës nga KMD deri në daljen e vendimit;
- për të marrë kontakt me inspektorin e çështjes, nëpunës të Drejtorisë Juridike apo/dhe drejtorive të tjera në KMD;
- për të rezervuar takim me titullarin e institucionit, etj.


Gjatë këtij viti janë pritur 778 (shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë) telefonata të ndryshme, kryesisht nga subjekte ankues, institucione publike ose private, si dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme të interesuar për marrjen e informacionit në kuadër të një ankese, plotësim të dokumentacionit, vijueshmërinë e saj nga Drejtoria e Hetimit Administrativ, apo rreth procedurave të ndjekura për çështjet në Gjykatë.

Çështjet e trajtuara³³ nga KMD

Në periudhën nga 1 Janar 2024 deri në 31 Dhjetor 2024, KMD ka trajtuar gjithsej 380 çështje, (367 ankesa dhe 13 çështje ex-officio). Nga këto, 268 çështje (265 ankesa dhe 3 çështje ex-officio) janë të regjistruara në vitin 2024 dhe 112 çështje (102 ankesa dhe 10 çështje ex-officio) janë të regjistruara nga viti 2023.



Grafiku 1. Çështje të vitit 2024.




Grafiku 2. Të dhëna krahasimore 2023-2024.

³³Çështjet e mbyllura me vendim dhe ato në proces gjatë vitit 2024.

Ankuesit


Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a dhe b, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankuesit janë: individë, grupe individësh dhe organizata me interesa legjitime.

Nga 380 çështje që janë trajtuar gjatë vitit 2024, për **367 çështje** ka filluar shqyrtimi në bazë të ankesës, nga të cilat në **302 raste** ankesat janë paraqitur nga individë (215 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2024 dhe 87 ankesa të regjistruara në vitin 2023), **në 37 raste**, ankesat janë paraqitur nga organizata me interesa legjitime (25 ankesa të regjistruara në vitin 2024 dhe 12 ankesa të trashëguara në vitin 2023), në **28 raste** ankesat janë paraqitur nga grup personash (25 ankesa të regjistruara gjatë vitit 2024 dhe 3 ankesa të regjistruara në vitin 2023).




Grafikët 3 & 4. Ankesat e regjistruara sipas subjekteve ankuese.

Gjatë 2024, konstatohet një rënie e numrit të ankesave të organizatave me interesa legjitime, në krahasim me vitin 2023, por rezulton të ketë një rritje prej 20 ankesash të depozituara nga grupe personash, krahasuar me një vit më parë. Organizatat me interesa legjitime, kryesisht gjatë vitit 2024, kanë paraqitur ankesa, të cilat kanë patur në objekt të tyre mbrojtjen e një kategorie të veçantë, si psh: personat me aftësi të kufizuara apo pakicat e ndryshme kombëtare në Republikën e Shqipërisë.



Grafiku 5. Ankesat e paraqitura nga OJF për vitet 2020-2024.



Grafiku 6. Ndarja sipas subjekteve për çështjet e trajtuara gjatë vitit 2024.

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2024 përveç ankesave individuale, janë shqyrtuar edhe 37 ankesa nga organizata me interes legjitim (12 ankesa të regjistruara në vitin 2023 dhe 25 ankesa të regjistruara në vitin 2024). Këto ankesa përgjithësisht kanë ardhur nga organizata që mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara, pakicave kombëtare Rome/Egjiptian, etj. Në çështjet e regjistruara gjatë vitit 2023, 28 ankues janë mbështetur nga OJF të ndryshme për të depozituar ankesë pranë KMD-së, ndërkohë që në vitin 2024, në 21 raste ankuesit janë asistuar nga organizata të shoqërisë civile, për të depozituar ankesë.


Gjithashtu, në disa raste informacioni i dhënë nga ana e organizatave të shoqërisë civile dhe medias, ka shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për nisjen e shqyrtimit kryesisht të çështjeve.

Ex-officio (Çështje të nisura me iniciativën e KMD-së)

Mbështetur në nenin 32, pika 1/c, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, gjatë vitit 2024, janë trajtuar gjithsej 13 çështje ex-officio, nga të cilat 10 çështje janë të regjistruara në vitin 2023. Gjatë vitit 2024, KMD ka filluar hetimin administrativ për 3 raste, pas marrjes së informacionit të besueshëm. 1 (një) çështje është shqyrtuar kryesisht nga KMD, në bazë të informacionit të marrë nga një organizatë e shoqërisë civile dhe 2 (dy) janë trajtuar mbështetur në informacionin e marrë nga media.

Shpërndarja e ankesave sipas Bashkive

Gjatë vitit 2024, ka pasur një shtrirje të gjerë gjeografike të ankesave me pretendim diskriminimi, të paraqitura pranë KMD-së. Bashkitë, nga të cilat është paraqitur numri më i madh i ankesave janë: Tiranë, Shkodër, Korçë, Durrës, Elbasan, Vlorë, etj. Është për tu theksuar fakti që gjatë vitit 2024, janë paraqitur ankesa edhe nga disa Bashki si p.sh.: Cërriku dhe Rubiku, nga të cilat Komisioneri nuk ka pasur ankesa më parë.



Grafiku 7. Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2024, sipas Bashkive.


Shkaqet e pretenduara në çështjet e shqyrtuara

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 të tij, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.


Mbështetur në LMD, është parashikuar një listë e hapur shkaqesh, duke përfshirë dhe rastet për “çdo shkak tjetër”, duke patur parasysh se, **shkaku i mbrojtur** mund të jetë një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri, i cili nuk parashikohet shprehimisht nga neni 1, të LMD-së.

Gjatë vitit 2024, janë depozituar 89 ankesa, në raport me 101 ankesa të paraqitura gjatë 2023, në të cilat ankuesit kanë pretenduar më shumë se një shkak diskriminimi.

Në grafikët e mëposhtëm pasqyrohen të dhënat mbi shpërndarjen e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2024 dhe atyre të regjistruara në vitin 2023, të ndara sipas shkaqeve:



Grafiku 8. Shkaqet e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2024




Grafiku 9. Shkaqet e ankesave të regjistruara në vitin 2023

Gjatë vitit 2024 vazhdojnë të mbeten mbizotëruese pretendimet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, bindjeve politike, përkatësisë në një grup të veçantë, gjendjes arsimore, gjendjes ekonomike, racës, etnisë, moshës dhe gjendjes shëndetësore.

Çështjet e trajtuara sipas fushave.


Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje në 3 (tre) fusha: fusha e punësimit, fusha e arsimit dhe fusha e të mirave dhe shërbimeve. Gjatë vitit 2024, nga totali prej 380 çështje të trajtuara gjithsej, (367 ankesa dhe 13 çështje ex-officio), nga këto **68 çështje** në fushën e arsimit, **149 çështje** në fushën e punësimit dhe **163 çështje** në fushën e të mirave dhe shërbimeve (268 çështje të regjistruara në 2024 dhe 112 çështje të mbartura nga 2023).



Grafikët 10 & 11. Çështjet e trajtuara dhe të regjistruara gjatë vitit 2024, të ndara sipas fushave.

Gjatë vitit 2024, shihet se ka një rritje të ndjeshme të çështjeve të trajtuara në fushën e arsimit, krahasuar me një vit më parë. Çështjet e trajtuara në fushën e punësimit thuajse kanë mbetur në të njëjtat shifra. Ndërsa, shpërndarja e çështjeve të trajtuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve, ka pasur një rënie me thuajse 10% nga viti 2023.

Për sa evidentohet, nga të dhënat rezulton se, çështjet në fushën e arsimit zënë 17.9 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti, me një rritje prej 14 % krahasuar me vitin paraardhës, çështjet në fushën e punësimit zënë 39.2 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti me një zbritje të lehtë prej 0.8 % krahasuar me 2023, çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve zënë 42.9 % të totalit të çështjeve të trajtuara gjatë këtij viti me një rënie prej 13.2 % krahasuar me 2023.




Grafiku 12. Shpërndarja e çështjeve sipas fushave për vitet 2023-2024.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve.

Numri total i çështjeve të trajtuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve është **163**, nga të cilat 125 çështje janë regjistruar në vitin 2024 dhe 38 çështje të mbartura nga 2023. Në total 98 ankesa drejtohen kundër subjekteve publike dhe 65 ankesa drejtohen kundër subjekteve private. Raporti i ankesave drejtuar subjekteve publike gjatë këtij viti ka një rënie prej 16.5 % nga viti paraardhës, ndërsa raporti i ankesave drejtuar subjekteve private në këtë fushë, ka një rritje me 16.5 %, krahasuar me vitin 2023.

Nga 98 ankesat e trajtuara kundër subjekteve publike, në 35 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 63 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor.



Grafiku 13 & 14. Çështjet në fushën e të mirave dhe shërbimeve, gjatë 2023 dhe 2024.

Gjatë vitit 2024, rezulton që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 35.7 % të totalit të çështjeve në këtë fushë, ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 64.3 % të totalit të çështjeve në këtë fushë. Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2024, krahasuar me vitin 2023 ka një zbritje prej 10.1 % të çështjeve që drejtohen kundër pushtetit qendror.

Problematikat e ankesave të paraqitura në këtë fushë, mbeten thuajse të njëjta edhe për vitin 2024, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me mos ofrimin e shërbimeve të nevojshme nga njësitë e qeverisjes vendore, si: trajtimi me strehim të përshtatshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; aksesueshmëria dhe mungesa e lehtësirave në linjat e transportit publik dhe privat; përdorimi i gjuhës së urrëjtjes ndaj grupeve vulnerabël, mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë etj.


Një pjesë e mirë e ankesave drejtohen edhe kundër institucioneve të administratës qendrore, ku objekti i ankesave konsiston në mosofrimin apo garantimin e një serie shërbimesh si, mungesa e medikamenteve në shërbimin shëndetësor, mos ofrimi i transportit publik qytetas pa pagesë, mos ofrimi i bursave për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë etj. Shkaqet kryesore, për të cilat janë paraqitur ankesat në fushën e shërbimeve kanë qenë: aftësia e kufizuar, raca dhe gjendja ekonomike.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e punësimit.

Çështjet e trajtuara me pretendim diskriminimin në fushën e punësimit janë ankesa të depozituara si kundër institucioneve publike, ashtu edhe kundër subjekteve private. Objekti i çështjeve të trajtuara në këtë fushë konsiston kryesisht në problematika të shfaqura lidhur me aksesin në punësim dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Numri i përgjithshëm i çështjeve, në fushën e punësimit, që janë trajtuar gjatë vitit 2024, është 149, nga të cilat 60 çështje të regjistruara gjatë vitit 2023 dhe 89 çështje të regjistruara në vitin 2024.

Nga të gjithë çështjet e trajtuara në këtë fushë gjatë vitit 2024, 115 çështje drejtohen kundër subjekteve publike dhe 34 të tilla kundër subjekteve private.



Grafiku 15. Çështjet në fushën e punësimit.

Krahasuar me vitin 2023, evidentohet se numri i çështjeve të trajtuara në këtë fushë ka mbetur thuajse i njëjtë edhe për këtë vit. Gjatë vitit 2023, sa i përket numrit të çështjeve në këtë fushë kundër subjekteve publike ka qenë 107 ndërsa kundër subjekteve private 37. Nga krahasimi i të dhënave me vitin paraardhës, gjatë vitit 2024 rezulton një rritje prej 8 % e çështjeve drejtuar subjekteve private dhe një rritje prej 3 % e çështjeve drejtuar subjekteve publike.


Pra, gjatë vitit 2024, krahasuar me vitin 2023 ka pasur një rritje me 8 ankesa të totalit të çështjeve të kësaj fushe që drejtohen kundër subjekteve publike, dhe një zbritje me 3 ankesa të numrit të çështjeve kundër sektorit privat.

Nga **115** çështjet e trajtuara kundër subjekteve publike, në 42 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 73 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor. Çështjet e paraqitura në fushën e punësimit, janë drejtuar përgjithësisht drejt institucioneve të administratës publike, me objekt kundërshtimi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Në krahasim me vitin 2023, shpërndarja e çështjeve në këtë fushë drejtuar pushtetit qendror dhe atij vendor nuk ka pësuar ndryshime domethënëse. Në vitin 2023, janë paraqitur kundër pushtetit qendror 40 raste ose 37.4 % e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike dhe 67 raste kundër subjekteve publike vendore ose 62.6 % e totalit të çështjeve drejtuar subjekteve publike.

Gjatë vitit 2024, rezulton që çështjet kundër subjekteve publike qendrore zënë 28.2 % të totalit të çështjeve në këtë fushë, ndërsa çështjet kundër subjekteve publike vendore zënë 71.8 % të totalit të çështjeve në këtë fushë. Çështjet që janë trajtuar në fushën e punësimit kanë pasur si shkak të pretenduar diskriminimi: bindjet politike, gjendjen shëndetësore, gjendjen arsimore, përkatësinë në një grup të veçantë, aftësinë e kufizuar, qëndrimeve në media kundër punëdhënësve etj.

Mbrojtja nga diskriminimi në fushën e arsimit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka trajtuar 68 çështje, në fushën e arsimit, nga të cilat 14 çështje janë të regjistruara në vitin 2023 dhe 54 çështje janë të regjistruara gjatë vitit 2024.



Grafiku 16. Çështjet në fushën e arsimit.

Në të gjitha çështjet e trajtuara në fushën e arsimit, ankuesit janë drejtuar kundër subjekteve publike, ndër të cilat në 6 raste ato janë drejtuar kundër institucioneve të pushtetit qendror dhe në 62 raste kundër institucioneve të pushtetit vendor.

Objekti i çështjeve të paraqitura në fushën e arsimit ka qenë vendosja e mësuesit ndihmës për fëmijë me aftësi të kufizuara, përjashtimi nga pagesa e regjistrimit të fëmijëve të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane në kopshte dhe çerdhe, përfitimi i bursave nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore për nxënësit që vijnë nga familje në nevojë etj.

Shkaqet kryesore të pretenduara në këto çështje janë aftësia e kufizuar, gjendja arsimore, gjendja ekonomike, raca, etj.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është anëtar për shkak të detyrës, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri ka përfunduar shqyrtimin e 47 çështjeve ku janë trajtuar problematikat e fëmijëve. Për këto 47 çështje, Komisioneri është shprehur si vijon:

- 7 Vendime Pushimi për të cilat është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ai i ishte nënshtruar procedurave të shqyrtimit administrativ;
- 35 Vendime ku Komisioneri ka konstatuar Diskriminim e fëmijëve (33 raste të cilat vijnë nga familje në nevojë, nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. Nr. 511, datë 27.7.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar);
- 1 Vendim Mosdiskriminimi;
- 3 Vendime Mospranimi;
- 1 Vendim Pushimi, pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;

Problematikat kryesore që lidhen me objektin e çështjeve me subjekte fëmijët, kanë qenë kryesisht:

- Regjistrimi pa pagesë në kopshtet ose çerdhet publike, i fëmijëve që i përkasin pakicës rome apo egjiptiane në Shqipëri;
- Trajtimi me bursë i fëmijëve që vijnë nga familje të cilat përfitojnë ndihmë ekonomike, dhe që ndjekin arsimin parauniversitar;
- Plotësimi me mësues ndihmës i fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Përfitimi i teksteve falas për nxënësit e gjimnazeve.

Gjuha e urrejtjes.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri ka shqyrtuar në total 12 çështje me objekt përdorimin e gjuhës së urrejtjes, nga të cilat 11 ankesa dhe 1 çështje ex-officio. Në 2 (dy) raste është pretenduar përdorimi i gjuhës së urrejtjes për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, në 4 (katër) raste për shkak të etnisë, në 2 (dy) raste për shkak të bindjeve fetare, në 1 (një) rast për shkak të racës, në 1 (një) rast për shkak të pamjes së jashtme, në 1 (një) rast për shkak të gjinisë dhe në 1 (një) rast për shkak të aftësisë së kufizuar.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me vendim për 10 çështje.

Komisioneri ka konstatuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes në dy raste. Në një rast ka konstatuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes për shkak të bindjeve fetare nga një person i cili merr pjesë aktive në jetën publike dhe atë televizive, për shkak se mendimet dhe qëndrimet e shprehura prej tij, ishin në tejkalim të lirisë së shprehjes.

Në një rast tjetër, Komisioneri konstatoi përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga drejtuesit e një emisioni televiziv investigativ. Gjatë emisionit, drejtueset e tij kanë përdorur gjuhë urrejtje ndaj pakicës kombëtare egjiptiane në Shqipëri.

4. Vendimet e çështjeve sipas fushave.

Në fushën e të mirave dhe shërbimeve, KMD ka dhënë gjithsej **126 vendime dhe 3 rekomandime**³⁴, nga të cilat, 30 vendime dhe 3 rekomandime për çështjet e regjistruara në vitin 2023 dhe 96 vendime për çështjet e regjistruara gjatë vitit 2024. Nga 129 vendimet e rekomandimet, 77 vendime dhe 3 rekomandime janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 49 vendime janë dhënë kundër subjekteve private.

Në këto vendime është konstatuar:

- në 12 raste diskriminim, ndër të cilat 7 vendime kundër subjekteve publike dhe 5 vendime kundër subjekteve private;
- në 34 raste mosdiskriminim, ku në 5 prej tyre pavarësisht se nuk është konstatuar situata diskriminuese, janë dhënë rekomandime për përmirësimin e situatës;
- në 54 raste mospranim të ankesave;
- në 20 raste për ndërprerje e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore;
- në 6 raste për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri;
- si dhe janë dhënë dhe 3 Rekomandime.

Vlen të theksohet se, sa i përket 12 vendimeve të diskriminimit, Komisioneri ka konstatuar:

- diskriminim në formën e rëndë dhe atij ndërsektorial në 2 raste;
- në formën e gjuhës së urrejtjes në 2 raste;
- në formën e diskriminimit të tërthortë në 3 raste;
- dhe në formën e diskriminimit strukturor në 1 rast.

Gjithashtu, janë vendosur 3 sanksione me gjobë për çështjet e regjistruara gjatë vitit 2024, nga të cilat, në një rast për shkak se subjekti ndaj të cilit është paraqitur ankesa nuk ka zbatuar vendimin e Komisionerit dhe në dy rastet e tjera, nga subjektet nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit informacioni i kërkuar në kuadër të shqyrtimit të çështjeve përkatëse.

Në fushën e punësimit, KMD ka dhënë gjithsej **113 vendime**, nga të cilat, 51 vendime për çështjet e regjistruara në vitin 2023 dhe 62 vendime për çështje të regjistruara gjatë vitit 2024. 91 vendime janë dhënë kundër subjekteve publike dhe 22 vendime kundër subjekteve private. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në **27 raste**, ku në **20 raste** kundër subjekteve publike dhe **7 raste** kundër subjekteve private. Në vendimet ku është konstatuar diskriminim dhe në pjesën më të madhe të tyre Komisioneri ka kërkuar nga subjektet përkatëse, rregullimin e situatave diskriminuese, si dhe rikthimin në punë të individit të diskriminuar.

Komisioneri është shprehur me mosdiskriminim në **36 raste**, ku në 15 prej tyre pavarësisht se nuk është konstatuar situata diskriminuese, janë dhënë rekomandime për përmirësimin e situatës. Në **26 raste** është shprehur për mospranimin e ankesës, në **5 raste** është shprehur për ndërprerje e procedurave të shqyrtimit të çështjes, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore, në **5 raste** është shprehur për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri, në **11 raste** Komisioneri është

³⁴ 3 rekomandime të dhëna në kuadër të shqyrtimit të çështjeve ex-officio.

shprehur me vendim për pushimin e çështjeve, për shkak se subjektet ankuese i janë drejtuar organeve gjyqësore me ankim për diskriminim dhe në 3 raste është shprehur për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të çështjes për shkak të pamundësisë për sigurimin e provave.

Gjithashtu, sa i përket 27 vendimeve të diskriminimit, Komisioneri ka konstatuar:

- 1 në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme;
- 1 rast është konstatuar diskriminim në 3 forma, atë të shoqërimit, udhëzimit për diskriminim dhe atë ndërsektorial;
- 3 në formën e shoqërimit;
- 1 në formën e shqetësimit;
- 1 në formën e udhëzimit për diskriminim;
- dhe 2 në formën e viktimizimit.

Në fushën e arsimit, KMD ka dhënë gjithsej 55 vendime dhe 1 rekomandim³⁵, të cilat, janë të gjitha të drejtuara kundër subjekteve publike. Në këto vendime është konstatuar diskriminim në 34 raste. Komisioneri është shprehur me 5 vendime mosdiskriminimi, 4 vendime për mospranimin e ankesës, 9 vendime për ndërprerjen e procedurave, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore, 2 vendime për ndërprerjen e procedurave për shkak se subjektet ankues janë tërhequr nga ankimi i bërë tek Komisioneri dhe 1 vendim për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të çështjes për shkak të pamundësisë për sigurimin e provave, si dhe është dhënë dhe 1 rekomandim.

5. Vendimet e çështjeve sipas shkaqeve³⁶

Vendimet e çështjeve me shkak racën³⁷

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 24 vendime, mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të racës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:


- 3 vendime diskriminimi;
- 9 vendime mospranimi;
- 5 vendime mosdiskriminimi;
- 6 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës.

³⁵ Të dhënë në kuadër të shqyrtimit të një çështje ex-officio.

³⁶ Komisioneri shprehet me vendim për çështje ku pretendohet diskriminim për një ose më shumë shkaqe të përcaktuara në nenin 1, të LMD. Në këtë kontekst, Komisioneri shprehet në të njëjtin vendim, për 2 ose më shumë shkaqe diskriminimi. Për këtë arsye, numri total i vendimeve të miratuara nga KMD, mund të mos përputhet me numrin e vendimeve të dhëna sipas shkaqeve të raportuara në këtë pjesë të Raportit Vjetor.

³⁷ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 "Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash".

Gjithashtu, janë marrë edhe 2 sanksione me gjobë, 1 për shkak të moszbatimit të vendimit me diskriminim dhe 1 për shkak të mosdhënies së informacionit të kërkuar nga Komisioneri.



Grafiku 17. Vendimet e vitit 2024 me shkak racën

Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat janë drejtuar kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të racës, janë si vijojnë:

- Pamundësia e përdorimit të portalit e-albania, nga anëtarët e pakicave egjiptiane dhe atyre rome, për të marrë shërbime nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- Mospërfitimi i bursave në arsimin parauniversitar publik, për familjet në nevojë dhe atyre që i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri;
- Përdorimi i shprehjeve të papërshtatshme në media ndaj anëtarëve të pakicave kombëtare në Shqipëri;


Vendimet e çështjeve me shkak aftësinë e kufizuar

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 74 vendime, 1 rekomandim dhe 7 vendime me gjobë (6 për moszbatim vendimi dhe 1 për shkak të mosdhënies së informacionit të kërkuar nga Komisioneri), mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 9 vendime diskriminimi (2 në formën e diskriminimit të tërthortë dhe 2 në formën e diskriminimit të rëndë dhe ndërsektorial);
- 23 vendime mosdiskriminimi;
- 19 vendime mospranimi;
- 18 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;

- 5 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
- 1 rekomandim.

Gjithashtu, janë marrë edhe 7 sanksione me gjobë, 6 për shkak të moszbatimit të vendimit me diskriminim dhe 1 për shkak të mosdhënies së informacionit të kërkuar nga Komisioneri.



Grafiku 18. Vendimet e vitit 2024 me shkak aftësinë e kufizuar

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, janë si vijojnë:

- Mungesa e aksesueshmërisë në godina dhe ambiente ku ofrohen të mira dhe shërbime, si p.sh.: Zyrat e Postës Shqiptare, institucione kulturore apo arsimore, institucione private dhe rrugë apo trotuare;
- Aksesueshmëria dhe mungesa e lehtësirave në linjat e transportit publik dhe privat;
- Ankimi kundër vendimeve të KMCAP-së;
- Përfitimi i pagesës së invaliditetit;


Referuar subjekteve ankues në çështjet e shqyrtuara, rezulton se subjekti ankues është grua në 21 raste, në 49 raste subjekti ankues është burrë, në 22 raste subjektet ankues janë organizata me interesa legjitime, në 5 raste grup personash dhe në 1 rast Komisioneri ka marrë informacionin nga çështjet e shqyrtuara për të nisur shqyrtimin e çështjes me iniciativën e tij.

Vlen të theksohet fakti se numri i vendimeve të mospranimit, ka ardhur si rezultat i ankesave, në të cilat pretendimet e subjekteve ankues nuk lidheshin me fushën e veprimit dhe kompetencat e Komisionerit, si p.sh: mos përfitimi i pagesës së invaliditetit për një diagnozë apo sëmundje të caktuar, etj.

Vendimet e çështjeve me shkak bindjen politike.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 30 vendime për ankesat ku është pretenduar diskriminim për shkak të bindjes politike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendura janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 12 vendime diskriminimi (1 prej tyre në formën e shqetësimit dhe 3 në formën e shoqërimit);
- 5 vendime mosdiskriminimi (në 1 rast është dhënë edhe rekomandim bashkëngjitur për përmirësimin e situatës);
- 9 vendime mospranimi;
- 2 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 2 vendime për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi çështjet kanë qenë në proces në gjykatë.



Grafiku 19. Vendimet e vitit 2024 me shkak bindjen politike


Çështjet me pretendim diskriminimin për shkak të bindjes politike kanë konsistuar kryesisht problematika, që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione të administratës shtetërore qendrore ose vendore, për këtë shkak.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen ekonomike

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 54 vendime dhe 1 rekomandim, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 33 vendime diskriminimi (1 prej të cilëve është konstatuar në formën e rëndë dhe atij ndërsektorial);
- 6 vendime mosdiskriminimi (në 2 raste janë dhënë edhe rekomandime bashkëngjitur për përmirësimin e situatës);

- 5 vendime mospranimi;
- 9 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjekti ankues është tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës;
- 1 rekomandim.



Grafiku 20. Vendimet e vitit 2024 me shkak gjendjen ekonomike

Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, janë si vijojnë:


- Mungesa e mbështetjes financiare të familjeve në nevojë, nga ana e institucioneve të pushtetit vendor;
- Vonesat në procesin e legalizimit të banesave të komunitetit rom dhe komunitetit egjiptian, ku gjendja ekonomike ndërthuret me shkakun e racës;
- Mosdhënia e bursës për fëmijët që vijnë nga familje në nevojë;
- Braktisja e shkollës për shkak të gjendjes ekonomike.

Vendimet e çështjeve me shkak gjendjen shëndetësore.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 16 vendime dhe 1 rekomandim për ankesat ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 3 vendime diskriminimi (ndër to: 1 në formën e rëndë, 1 viktimizim dhe 1 në formën e shoqërimit, udhëzimit për diskriminim dhe ndërsektorial);
- 4 vendime mosdiskriminimi (1 rekomandim për përmirësimin e situatës);
- 3 vendime mospranimi;
- 2 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;

- 2 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesave;
- 2 vendime për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi çështjet kanë qenë në proces në gjykatë;
- 1 rekomandim.



Grafiku 21. Vendimet e vitit 2024 me shkak gjendjen shëndetësore


Nga analiza e bërë, referuar çështjeve të shqyrtuara me këtë shkak, ankesat drejtohen kryesisht kundër institucioneve publike qendrore dhe vendore, në fushën e punësimit dhe shërbimeve. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes shëndetësore, janë si vijojnë:

- Ndërprerja e marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes shëndetësore;
- Përfitimi me rimbursim i medikamenteve për pacientë të cilët vuajnë nga sëmundje të rënda;
- Përlllogaritje e masës së pensionit nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

Vendimet e çështjeve me shkak moshën.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 12 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio ku është pretenduar diskriminim për shkak të moshës. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 5 vendime mosdiskriminimi;
- 6 vendime mospranimi;
- 1 vendim për pushimin e shqyrtimit të ankesës, pasi çështja ka qenë në proces në gjykatë;



Grafiku 22. Vendimet e vitit 2024 me shkak moshën


Çështjet me pretendim diskriminim për shkak të moshës kanë konsistuar kryesisht në problematika që lidhen me vendosjen e një moshe limit për të patur akses në punësim dhe profesion, largim nga puna për shkak të moshës, faturimit të lartë të energjisë elektrike dhe mospërfitimin e masës së plotë të pensionit të pleqërisë.

Vendimet e çështjeve me shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

Mbështetur në praktikën e çështjeve të trajtuara, Komisioneri ka konsideruar si shkak në kuadër të përkatësisë në një grup të veçantë, karakteristikat të cilat e bëjnë grupin të dallueshëm, si p.sh.: pjesëmarrja në organizata sindikale etj.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 12 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë. Disa prej vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në ankesat respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 2 vendime diskriminimi (1 në formën e diskriminimit të rëndë dhe ndërsektorial);
- 2 vendime mosdiskriminimi;
- 5 vendime mospranimi;
- 3 vendime ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;



Grafiku 23. Vendimet e vitit 2024 me shkak përkatësinë në një grup të veçantë


Çështjet me pretendim diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë kanë konsistuar kryesisht në problematika, që lidhen me rekrutimin apo zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në institucione private dhe të administratës shtetërore qendrore ose vendore. Problematikat e hasura gjatë shqyrtimit të çështjet ku pretendohet diskriminim për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë, janë si vijojnë:

- Largimet nga puna nga ana e punëdhënësve, pikërisht pasi ata kanë marrë dijeni për veprimtarinë e ankuesve si pjesë e këtyre grupeve të veçanta, psh. qenia në një grupim sindikal në mbrojtje të të drejtave të punonjësve;
- Trajtimi i pafavorshëm i një grupi mjekësh nga ana e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Vendimet e çështjeve me shkak gjininë.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 16 vendime dhe 1 rekomandim (i dhënë për gratë me aftësi të kufizuara), mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim për shkak të gjininë. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 3 vendime diskriminimi;
- 6 vendime mosdiskriminimi (2 rekomandime për përmirësimin e situatës);
- 3 vendime mospranimi;
- 1 vendim ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;
- 1 vendim për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të çështjes për shkak të pamundësisë për sigurimin e provave;
- 2 vendime për pushimin e shqyrtimit të ankesave, pasi çështjet kanë qenë në proces në gjykatë;
- 1 rekomandim.



Grafiku 24. Vendimet e vitit 2024 me shkak gjininë

Pretendimet e hasura gjatë shqyrtimit të çështjeve lidhen kryesisht me diskriminimin në punësim dhe kryesisht:

- Largim nga puna për shkak të gjinisë;
- Trajtimi i pafavorshëm i punonjësve gjatë marrëdhënieve të punësimit;
- Trajtimin me strehim të përshtatshëm nga njësitë e vetëqeverisjes vendore;
- Trajtimin e qytetarëve nga forcat e policisë gjatë marrjes së kallëzimeve penale;
- Përdorimi i gjuhës së urrejtjes nga persona publik.

Vendimet e çështjeve për “çdo shkak tjetër”.


Për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak i mbrojtur, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur.

Neni 1, i ligjit nr.10221, dat[04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar (LMD), liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është një listë e mbyllur, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri është shprehur me 86 vendime mbi ankesat/çështjet ex-officio, ku është pretenduar diskriminim në kuadër të termit “për çdo shkak tjetër”. Shumica e vendimeve të sipërpërmendur janë dhënë edhe për shkaqe të tjera, të pretenduara në çështjet respektive. Në përfundim të shqyrtimit të çështjeve janë dhënë vendimet si më poshtë:

- 4 vendime diskriminimi;
- 31 vendime mosdiskriminimi (6 rekomandime për përmirësimin e situatës);
- 1 vendim për ndërprerje të procedurave hetimore pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur procedura hetimore;

- 39 vendime mospranimi;
- 7 vendime pushimi pasi çështja po trajtohet në gjykatë;
- 1 vendim për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të çështjes për shkak të pamundësisë për sigurimin e provave;
- 3 vendime për ndërprerje të procedurave hetimore pasi subjektet ankues janë tërhequr nga shqyrtimi i mëtejshëm i ankesave.



Grafiku 25. Vendimet e vitit 2024 për “çdo shkak tjetër”

Çështjet me pretendim diskriminimi për “çdo shkak tjetër” konsistojnë kryesisht në fushën e punësimit, në lidhje me trajtimin në vendin e punës dhe zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, si pasojë e ankimeve ose denoncimeve kundër punëdhënësve, prononcimeve publike dhe qëndrimeve kritike të korrupsionit, të cilët në pjesën kryesore i përkasin punëdhënësve të sektorit publik.

Nga analiza e vendimeve të mospranimit të çështjeve me pretendim diskriminimi në kuadër të parashikimit për “çdo shkak tjetër”, rezulton se këto çështje kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD dhe për rrjedhojë Komisioneri nuk i ka marrë ato në shqyrtim. LMD ka pajisur Komisionerin me kompetencën për të shqyrtuar ankesat me pretendim diskriminimi, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Sipas, LMD jo çdo pretendim për trajtim të pafavorshëm dhe të pabarabartë përbën diskriminim, por vetëm ato diferenca në trajtim që bazohen në një shkak që konsiderohet i mbrojtur sipas ligjit. Ankuesit i drejtohen Komisionerit duke pretenduar se sjellja e padrejtë që i janë nënshtruar përbën diskriminim, duke mos identifikuar asnjë shkak. Në mënyrë të vazhdueshme në vendimet e tij Komisioneri thekson se, çdo sjellje diskriminuese është një sjellje e paligjshme, por jo çdo pretendim për paligjshmëri përbën diskriminim, për sa kohë nuk bazohet në një shkak i cili konsiderohet shkak i mbrojtur sipas ligjit.

Megjithatë, Komisioneri vlerëson se rritja e numrit të ankesave, “për çdo shkak tjetër” pavarësisht numrit të vendimeve për mospranimin e tyre pasi kanë qenë të papajtueshme me dispozitat e LMD, për arsye të mësipërme, tregon një rritje të besimit të qytetare tek institucioni i Komisionerit, të cilit i drejtohen për të zgjidhur problematikat e tyre.

Vendimet për konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak.

Diskriminimi për më shumë se një shkak, gjen pasqyrim në disa forma diskriminimi të parashikuara nga LMD dhe konkretisht, diskriminimi ndërsektorial, diskriminimi i shumëfishtë, si dhe diskriminimi në formën e rëndë.

Gjatë vitit 2024, Komisioneri ka konstatuar në 2 raste, konsumimin e formës së rëndë të diskriminimit dhe njëkohësisht dhe diskriminimin ndërsektorial. Çështjet kryesisht kanë patur të bëjnë me konstatimin e diskriminimit për më shumë se një shkak, kryesisht për shkaqet e gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë sindikatë dhe gjendjes shëndetësore, në fushën e punësimit dhe atë të mirave dhe shërbimeve.

2 rastet e diskriminimit të formës së rëndë dhe atij ndërsektorial, janë konstatuar në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Në 1 prej rasteve, problematika lidhej me faktin e mos garantimit të trajtimit të duhur shëndetësor, me medikamentin përkatës, si shkak i mospërfshirjes së tij në listën e barnave për shërbimin spitalor, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ndërsa në rastin tjetër, problematika lidhej me mohimin e shërbimit mjekësor në përputhje me protokollet e miratuara të çrregullimeve të shëndetit mendor dhe mos garantimin në baza të barabarta, të drejtën për kurimin dhe trajtimin e personave me masë mjekësore njëloj si personat e vendosur në spitalet psikiatrike të sektorit publik.

Format e tjera të diskriminimit

Gjatë vitit 2024, veç konstatimit të diskriminimit në formën e rëndë dhe atij ndërsektorial, Komisioneri në çështjet e trajtuara, ka konstatuar diskriminim edhe në disa nga format e tjera të parashikuara nga Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si më poshtë:

1. në 2 raste është konstatuar diskriminimi *në formën e gjuhës së urrejtjes* (1 për shkak të bindjeve fetare dhe 1 për shkak të etnisë); në 3 raste është konstatuar *diskriminimi i tërthortë*, që lidhet me problematikat e krijuara sa i përket aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara;
2. në 3 raste është konstatuar diskriminimi *në formën e shoqërimit*, që lidhet me largimin nga puna të punonjësve për shkak të shoqërimit me persona që i përkasin partive politike;
3. në 1 rast është konstatuar diskriminimi *në formën e mohimit të përshtatjes së arsyeshme*, lidhur me mos sigurimin e kushteve të përshtatshme për një punonjës i cili për shkak të besimit fetar kërkonte të ndiqte ritet fetare gjatë ushtrimit të funksionit;
4. në 1 rast është konstatuar diskriminimi *në formën e shqetësimit*, për shkak të bindjeve politike në fushën e punësimit;
5. në 1 rast është konstatuar *diskriminimi strukturor*, për shkak të racës, si pjesë e pakicës kombëtare egjiptiane, në fushën e të mirave dhe shërbimeve;
6. në 1 rast është konstatuar diskriminim *në formën e shoqërimit, udhëzimit për diskriminim dhe diskriminimit ndërsektorial*, në të drejtën për punësim, për shkak të përgjegjësisë prindërore dhe gjendjes shëndetësore të djalit të mitur, nga ana e punëdhënësit.

6. Rezultatet e vendimeve të çështjeve të shqyrtuara

Duke u bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, me regjistrimin e ankesës, Komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, kur e çmon të nevojshme, Komisioneri merr informacion edhe nga çdo person ose burim tjetër.

Nëse ankesa nuk ka plotësuar kriteret e pranimit, ose ka pasur mungesë të informacionit, që mund të pengojë procedurën e mëtejshme të shqyrtimit të saj, ankuesit i është kërkuar që brenda 10 ditëve pune nga dita që ka marrë njoftimin të plotësojë kriteret e kërkuara nga KMD, për ta bërë atë të vlefshme. Kanë qenë të shumta rastet në të cilat, falë bashkëpunimit me përfaqësuesit e KMD-së, në Zyrat Rajonale të Korçës, Fierit dhe Shkodrës, si dhe organizatave të shoqërisë civile, subjekteve ankues u është ofruar asistencë, për plotësimin e saktë të formularëve të ankesës dhe dokumentacionit të nevojshëm, në përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2024, është shprehur me **294 Vendime dhe 4 Rekomandime**³⁸. Nga këto, 94 vendime dhe 4 rekomandime për ankesa/çështje ex-officio të regjistruara në vitin 2023 dhe 200 vendime, për ankesa të depozituara apo çështje ex-officio të iniciuara gjatë periudhës së vitit 2024.

Vendimet e dhëna nga KMD, klasifikohen si më poshtë:


- 73 vendime konstatim diskriminimi;
- 75 vendime konstatim mosdiskriminimi;
- 84 vendime për mospranim të ankesës;
- 34 vendime për ndërprerje të procedurave të hetimit, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte nisur shqyrtimi i ankesave;
- 13 vendime pushimi për shkak se ankuesit janë tërhequr nga procedura hetimore;
- 11 vendime pushimi për shkak se çështjet po ndiqeshin në gjykatë;
- 4 vendime për ndërprerjen e procedurave të shqyrtimit të çështjeve për shkak të pamundësisë për sigurimin e provave;
- 4 Rekomandime për çështje ex-officio.

Për vitin 2024, Komisioneri është shprehur me 13 (trembëdhjetë) vendime me gjobë, në vlerën 2.650.000 lekë, si vijojnë:

- për 8 vendime me gjobë për moszbatim të vendimit në themel të Komisionerit;
- për 5 vendime me gjobë kundër subjekteve, që nuk kanë dhënë informacion, pas kërkesave zyrtare së KMD-së.

Në total, numri i vendimeve dhe rekomandimeve të Komisionerit për vitin 2024, është 311 vendime (ku përfshihen edhe 13 vendimet me gjobë).

³⁸ Këtu nuk përfshihen vendimet me gjobë për moszbatim vendimi apo mosdhënie informacioni nga subjektet përkatës;



Grafiku 26. Vendimet e dhëna gjatë vitit 2024

Për sa më sipër, vlen të theksohet se për vendimet me diskriminim të dhëna gjatë vitit 2024, subjektet kanë zbatuar masat e vendosura nga KMD për rregullimin e situatës diskriminuese për 10 vendime, 45 vendime janë dërguar në gjykatë, 14 vendime janë në proces zbatimi, ndërsa në 4 vendime Komisioneri ka konstatuar diskriminim por nuk ka urdhëruar masa për subjektin.

Gjatë shqyrtimit të çështjeve, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të shqyrtimit të ankesave ka dërguar 596 kërkesa për informacion ndaj palëve në proces dhe në vijim të shqyrtimit dhe hetimit administrativ të ankesave, ka zhvilluar 12 inspektime dhe 92 seanca dëgjimore publike, ku ka ftuar palët dhe çdo person tjetër të interesuar për të parashtruar pretendimet e tyre.

Nga 73 ankesa/çështje ex-officio, për të cilat, KMD është shprehur me vendime diskriminimi gjatë vitit 2024, për 44 prej tyre janë zhvilluar seanca dëgjimore, fakt që dëshmon mbi rëndësinë e zhvillimit të seancave të tilla, për mbledhjen e informacionit të nevojshëm, përgjatë kryerjes së hetimit administrativ. Referuar subjekteve ankues, rezulton se subjekti ankues ka qenë grua në 35 vendime diskriminimi, në 25 vendime diskriminimi subjekti ankues ka qenë burrë, në 8 vendime diskriminimi subjektet ankues kanë qenë pakica kombëtare apo grup vulnerabël dhe në 5 vendime diskriminimi subjektet ankues kanë qenë organizata.

Problematikat e evidentuara nga KMD gjatë shqyrtimit të ankesave

Gjatë trajtimit të 380 çështjeve gjatë vitit 2024, janë identifikuar gjithashtu disa problematika të lidhura me aktet ligjore, nënligjore dhe rregulloret përkatëse. Ndër to, KMD ka evidentuar se:

- Pas shqyrtimit të 9 ankesave individuale të ardhura pranë Zyrës së KMD-së, pavarësisht faktit se nuk u konstatua një sjellje diskriminuese ndaj subjektit kundër të cilit ishte paraqitur ankesa,

Komisioneri, i Rekomandoi Këshillit të Ministrave, që në respektim të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të marrë masat për rishikimin dhe riformulimin në mënyrë objektive, të justifikuar, të qartë dhe proporcionale, të parashikimeve të VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017 *“Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jo mësimorë, në arsimin parauniversitar”*, së ndryshuar, duke pasur në vëmendje trajtimin e barabartë të kategorive të punonjësve mësimorë/edukatorë të cilët kanë filluar punë përpara datës 1 mars 2017 dhe pas kësaj date.

- Në lidhje me 2 procedura administrative të iniciuara me ankesën e mjekëve mikrobiologë dhe epidemiolog, pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), u arrit të zgjidhej me ndërmjetësim ndryshimi i VKM-së nr. 794, datë 28.12.2023 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 555, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit teknik të shkencave mjekësore, në sistemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë spitalit universitar të traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”*, të ndryshuar.
- Në kuadër të ndjekjes kryesisht, të çështjes së trajtimit jo të duhur mjekësor të personave me sëmundjen e Sklerozës Multiple (SM), nga ana e institucioneve kompetente shtetërore, Komisioneri, në përfundim të shqyrtimit të saj, rekomandoi marrjen e masave nga institucionet përgjegjëse kompetente të: Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm dhe Kujdesit Shëndetësor dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, që në bashkëpunim me njëra-tjetrën, të koordinojnë punën për hartimin dhe miratimin e akteve ligjore apo nënligjore përkatëse, lidhur me përfshirjen në Librin e Barnave të Rimbursueshme, të barnave të reja, (sipas propozimeve të ekspertëve të fushës), të barnave simptomatikë si dhe të ofrimit të terapive (procedurave) riaftësuese fizike për trajtimin e Sklerozës Multiple, në përputhje me të drejtën e këtyre pacientëve për trajtim të duhur shëndetësor dhe me dinjitet.
- Në kuadër të shqyrtimit të një ankese individuale të një pacienti të diagnostikuar me sëmundjen “Myelome Multiple”, në stadin 3/A, për trajtimin e së cilës ai i ishte nënshtruar kimioterapisë, dhe ilaçet nuk ishin as të rimbursueshme dhe as të ofruara në listën e barnave për shërbimin spitalor në QSUNT, Komisioneri në përfundim të shqyrtimit të saj, konstatoi se diskriminimin e subjektit ankues, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), si pasojë e mos garantimit të trajtimit të duhur shëndetësor, me medikamentin Lenalidomide, si shkak i mospërfshirjes së tij në listën e barnave për shërbimin spitalor.
- Në kuadër të ndjekjes së një çështje kryesisht, Komisioneri konstatoi se jo të gjitha familjet me të ardhura më të ulëta se 35.000 lekë në muaj, ishin përfshirë në përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, por vetëm ato me kryefamiljarë, punonjës buxhetorë. Në këtë kuadër, Komisioneri rekomandoi për marrjen e masave nga të gjitha strukturave përgjegjëse (Këshilli i Ministrave, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave), sipas fushës së kompetencës së tyre, për rishikimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8/2015 *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike, deri në 300 Kwh në muaj”*, duke përcaktuar përfitimin e kompensimit të diferencës së çmimit të energjisë elektrike, për të gjitha familjet me të ardhura më të ulëta se 35.000 lekë në muaj dhe jo vetëm të familjeve me kryefamiljarë, punonjës buxhetorë.
- Në kuadër të ndjekjes së një çështje kryesisht, Komisioneri evidentoi se nuk mbaheshin të dhëna lidhur me rastet e dhunës në marrëdhënie familjare dhe dhunës me bazë gjinore të disagreguara

sipas aftësisë së kufizuar. Në këtë kuadër, rekomandoi marrjen e masave për sigurimin e një shërbimi policor gjithëpërfshirës dhe cilësor për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara si dhe për të gjithë personat me aftësi të kufizuar, viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Gjatë shqyrtimit të 18 ankesave individuale, është evidentuar se institucione të pushtetit vendor dhe atij qendror, por edhe subjekte private, pavarësisht miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1503, datë 19.11.2008, *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”*, ende nuk kanë marrë masat e duhura për plotësimin e standardeve teknike të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, sa i përket: përcaktimit të vendeve të parkimit për personat me aftësi të kufizuara, aksesin në godinat e ndërtuara rishtas apo ato të rikonstruktura, mungesës së aksesueshmërisë në infrastrukturën rrugore, trotuare etj.
- Gjithashtu, gjatë trajtimit të 35 ankesave të depozituara nga persona me aftësi të kufizuara, të verbër, Komisioneri ka evidentuar se pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, Ligjit 8098/1996 *“Për Statusin e të Verbërit”* (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban³⁹ falas dhe transport interurban⁴⁰/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompesim për shërbimin e transportit, ku procedurat, masat dhe kriteret e këtij përfitimi do të përcaktoheshin me Vendim të Këshillit të Ministrave. Sakaq, Komisioneri ka konstatuar se për shkak të mosmiratimit të VKM-së përkatëse, që nga momenti i miratimit të ndryshimeve ligjore sipërcituar, kategoria e personave të verbër përballen me situata të ndryshme me shoqëritë e transportit, të cilat nuk i lejojnë të udhëtojnë falas apo me 50 % të biletës.
- Gjatë trajtimit të 45 ankesave individuale, nga prindër të nxënësve që vijnë nga familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, është evidentuar se për shkak të paqartësive të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, institucionet e vetëqeverisjes vendore, nuk kanë përzgjedhur përfitues të bursave këto familje.
- Gjatë trajtimit të një ankese individuale, Komisioneri konstatoi se shtetasit, ndaj të cilëve gjykatat janë shprehur me vendim duke caktuar masa mjekësore *“Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”*, për personat që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, ata vijnë në mbahen në ambiente, si Institucioni Mjekësor i Posaçëm Lezhë, i cili nuk i plotëson kushtet për trajtimin dhe shërbimin mjekësor në përputhje me protokollin e miratuar të çrregullimeve të shëndetit mendor.
- Janë konstatuar, problematika në lidhje me praktika të ndërprerjes së furnizimit me ujë për shkak të mospagesës së detyrimeve nga ana e klientëve që i përkasin kategorive vulnerabël, sikurse janë personat me aftësi të kufizuara, si dhe klientëve të cilët për shkak të gjendjes ekonomike janë në pamundësi financiare për të shlyer detyrimin, sikurse janë personat që janë përfitues të ndihmës ekonomike nga Shteti. Në këtë kontekst, kërkohet që edhe skemat mbështetëse që ofrohen për kategoritë vulnerabël sikurse është marrëveshja për pagesën me këste të detyrimit, duhet të jenë të përshtatshme dhe të përballeshme nga ana e këtyre kategorive.

³⁹ Terminologji e përdorur në këto ligje;

⁴⁰ Terminologji e përdorur në këto ligje;

7. Proçeset Gjyqësore


Pjesëmarrja e KMD në proçeset gjyqësore

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, e vendos Komisionerin në një raport të gjerë me gjykatën, duke parashikuar mjaft kompetenca përse i takon pjesëmarrjes së institucionit në proçeset gjyqësore. Vendimet e dhëna nga Komisioneri, janë të ankimeshme në gjykatë. Gjithashtu, Ligji parashikon detyrimin e gjykatës për ta njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t’i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen (Neni 36, pika 4 dhe neni 32, pika 1/gj). Në varësi të pozitës procedurale, Komisioneri merr pjesë në proçese gjyqësore si:

- **Palë paditëse në gjykim:** Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar se Komisioneri ka kompetencë të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive (neni 32, pika 1, germa (i) dhe 34, pika 4).
- **Palë e paditur në gjykim:** Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë akte administrative të cilat ankimeshen në Gjykatën kompetente sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative (neni 33 pika 18).
- **Person i tretë/palë e interesuar në gjykim:** Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon detyrimin e Gjykatës për të njoftuar Komisionerin për paraqitjen e çdo padie për diskriminim (Neni 36, pika 3) dhe ka të drejtë t’i kërkojë Komisionerit, që në çdo fazë të procedimit, të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen. KMD thirret në gjykim nga Gjykata kompetente si palë e tretë, në çështje ku kërkohet drejtpërdrejtë konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi për diskriminim në gjykatë.
- **Palë kërkuese,** në ato raste kur KMD në pozitën e kreditorit, i drejtohet gjykatës me kërkesë për lëshim Urdhri Ekzekutimi, me qëllim ndjekjen e procedurave përmbarimore për ekzekutimin e vendimeve me gjobë.
- **Amicus Curiae në Gjykatën Kushtetuese:** Gjykata Kushtetuese mund të vihet në lëvizje me kërkesë të KMD. Ndryshimet Kushtetuese të vitit 2016 i kanë dhënë të drejtën KMD-së për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke sanksionuar, në nenin 134, se “Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të (e) çdo Komisioneri të krijuar me ligj për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara nga Kushtetuta”. Edhe Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me ndryshimet e pësura me Ligjin Nr. 124/2020, ka parashikuar si kompetencë të Komisionerit dhe vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve (neni 32, pika 1, germa “i/1”). Gjatë vitit 2024, KMD nuk ka ushtruar të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese.

Pjesëmarrja në proceset gjyqësore.

Gjatë vitit 2024, KMD është thirrur në **135 (njëqind e tridhjetë e pesë)** procese të reja⁴¹ gjyqësore në raport me **58 (pesëdhjetë e tetë)** procese gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2023, të ndara në 17 (shtatëmbëdhjetë) procese të juridiksionit civil dhe 118 (njëqind e tetëmbëdhjetë) procese të juridiksionit administrativ.



Grafik Nr. 1 Pjesëmarrja në proceset gjyqësore sipas viteve

Rritja e numrit të proceseve gjyqësore ndër vite, vjen si pasojë e një numri në rritje të ankesave të depozituara pranë KMD-së, që tregon se tashmë ky institucion luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe konsiderohet tanimë si një mjet efektiv për vënien në vend të të drejtave të shkelura.

Sa i takon seancave gjyqësore të zhvilluara në lidhje me këto procese të reja të komunikuar, por edhe procese të mbartuara nga vitet e mëparshme, KMD ka marrë pjesë fizikisht në **209 (dyqind e nëntë) seanca gjyqësore** gjatë vitit 2024, kryesisht pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Apelit dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Roli i Komisionerit në proceset gjyqësore të ndjekura gjatë vitit 2024, paraqitet si më poshtë:

A. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë si palë e paditur në **89 (tetëdhjetë e nëntë)** procese gjyqësore, ku kërkohet shfuqizimi apo pavlefshmëria e vendimeve të KMD-së, nga subjektet e gjetur në shkelje të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, me vendim të KMD, në raport me 30 procese gjyqësore gjatë vitit 2023:

- Në 25 (njëzet e pesë) procese, Komisioneri është paditur nga individë lidhur me vendimet ku është konstatuar mosdiskriminim (11 raste), vendime ku është konstatuar diskriminim (4 raste), vendime ku është vendosur mospranim (8 raste), vendime ku është vendosur pezullim i hetimit (1 rast) dhe raste kur nuk ka patur vendim-marrje nga KMD (1 rast);

⁴¹ Përfshirë këtu edhe proceset gjyqësore të iniciuara nga KMD me objekt lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, si dhe gjykimet në Gjykatën Kushtetuese.

- Në 64 (gjashtëdhjetë e katër) proçese Komisioneri është paditur **nga persona juridikë** (institucione), lidhur me vendimet ku është konstatuar diskriminim (57 raste), vendimet ku është konstatuar mosdiskriminim (2 raste) vendimet ku është vendosur sanksion me gjobë (4 raste), si dhe vendimet ku është vendosur mospranimi i ankesës (1 rast).
- B. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë pjesë si person i interesuar/palë e tretë në **33 (tridhjetë e tre)** proçese gjyqësore, në çështje ku kërkohet konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi në gjykatë, në raport me 23 proçese të tilla gjatë vitit 2023. Në këto çështje, KMD thirret në gjykim nga Gjykata kompetente si palë e tretë, dhe parashtro mendim me shkrim për gjykatën, sipas përcaktimeve ligjore:
- 17 (shtatëmbëdhjetë) raste janë çështje të pa shqyrtuara më parë nga Komisioneri, ku palët i janë drejtuar direkt gjykatës për konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim;
 - 12 (dymbëdhjetë) raste janë çështje të shqyrtuara nga Komisioneri me vendim konstatim diskriminimi, ku palët i janë drejtuar gjykatës për dëmshpërblim;
 - 2 (dy) raste janë çështje të shqyrtuara nga Komisioneri me vendim mospranimi ankesë, ku palët i janë drejtuar gjykatës për konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim;
 - 1 (një) rast ku KMD ka dalë me vendim pezullimi, ku pala i është drejtuar gjykatës për konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, dhe;
 - 1 (një) rast ku KMD ka dalë me vendim pushimi dhe pala i është drejtuar gjykatës për konstatimin e diskriminimit dhe dëmshpërblimin.
- C. Në përputhje me parashikimet ligjore, KMD i është drejtuar gjykatës me **13 (trembëdhjetë)** kërkesa për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit, për vendimet me gjobë të KMD, krahasuar me **5 (pesë)** kërkesa të depozituara gjatë vitit 2023, nga të cilat:
- Në 12 (dymbëdhjetë) raste⁴² subjekti debitor ka qenë një person juridik (institucione publike ose shoqëri tregtare), dhe totali i vlerës së gjobës për këto kërkesa është 2, 710, 000 Lekë.
 - Në 1 (një) rast⁴³ subjekti debitor ka qenë një person fizik, dhe totali i gjobës për këtë kërkesë është 30 000 lekë.

Në vijim të procedurave të ekzekutimit të vendimeve me gjobë, pas lëshimit nga Gjykata të Urdhërit të Ekzekutimit, KMD ka kërkuar pranë Zyrave përkatëse Përmbartimore, vënien në ekzekutim të:


⁴² Vendim Nr. 181 datë 12.09.2023 i KMD-së, me palë debitore Shoqëria "Posta Shqiptare" sh.a., me vlerë gjobe 400 000 lekë. Vendim Nr. 180 datë 12.09.2023, me palë debitore Bashkia Kavajë, me vlerë gjobe 150 000 lekë. Vendim Nr. 85 datë 28.03.2024, me palë debitore Bashkia Kavajë, me vlerë gjobe 300 000 lekë. Vendim Nr. 63 datë 18.03.2024, me palë debitore Bashkia Tiranë, me vlerë gjobe 300 000 lekë. Vendim Nr. 68 datë 18.03.2024, me palë debitore Bashkia Tiranë, me vlerë gjobe 200 000 lekë. Vendim Nr. 164 datë 31.05.2024, me palë debitore Drejtorinë Vendore Shkodër (ASHK), me vlerë 300 000 lekë. Vendim Nr. 24 datë 22.01.2024, me palë debitore Shoqërinë "Posta Shqiptare" sh.a., me vlerë 200 000 lekë. Vendim Nr. 75 datë 20.03.2024, me palë debitore Bashkia Kavajë, me vlerë 200 000 lekë. Vendim Nr. 221 datë 31.10.2024, me palë debitore Bashkia Kavajë, me vlerë 100 000 lekë. Vendim Nr. 189 datë 26.09.2023, me debitor Bashkia Fier, me vlerë 100 000 lekë. Vendim Nr. 87 datë 28.03.2024, me debitor Bashkia Kavajë, me vlerë 60 000 lekë. Vendim Nr. 166 datë 13.09.2021, me debitor Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me vlerë 400 000 lekë.

⁴³ Vendim Nr. 39 datë 17.03.2024, me palë debitore, z. O.J., me vlerë 30 000 lekë.

- 7 (shtatë) titujve ekzekutivë⁴⁴ (vendime gjobe), ku debitorë kanë qenë persona juridikë dhe vlera e gjobave në total është 200 000 Lekë.
- 1 (një) titulli ekzekutiv⁴⁵ (vendim gjobe), ku debitor ka qenë një person fizik dhe vlera e gjobës konsistoi në 30 000 Lekë.

Gjatë këtij viti, nga Zyrat Përmbartimore përkatëse janë komunikuar pranë KMD-së:

- 7 (shtatë) vendime⁴⁶ për pushimin e urdhërit të ekzekutimit, si pasojë e shlyerjes së detyrimit nga palët debitoare. Në të gjitha rastet, subjekti debitor ka qenë një person juridik (institucione publike apo shoqëri tregtare), dhe vlera totale e gjobave të vjelura nga KMD gjatë vitit 2024 është 780 000 Lekë.



Grafik Nr. 2 Vlerat e gjobave të KMD-së të ekzekutuara tërësisht

Vendimet Gjyqësore⁴⁷

Statistika

Gjatë vitit 2024, Gjykatat kompetente kanë dalë me **98 (nëntëdhjetë e tetë)** vendime⁴⁸ për çështje ku KMD ka qenë palë (72 vendime që rrjedhin nga procese administrative dhe 26 nga procese civile),

⁴⁴ Vendim Nr. 182 datë 12.09.2023, Vendim Nr. 181 datë 12.09.2023, Vendim Nr. 68 datë 18.03.2024, Vendim Nr. 180 datë 12.09.2023, Vendim Nr. 63 datë 18.03.2024, Vendim Nr. 221 datë 31.10.2024 dhe Vendim Nr. 24 datë 22.01.2024 i KMD-së.

⁴⁵ Vendim Nr. 39 datë 17.03.2023 i KMD-së.

⁴⁶ Të dhënat e vendimeve të gjobës të KMD-së të ekzekutuara tërësisht gjatë vitit 2024 janë: Vendim Nr. 130 datë 31.08.2016, me debitor Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, me vlerë 100 000 lekë. Vendim Nr. 148 datë 26.09.2014, me debitor KESH, me vlerë 60 000 lekë. Vendim Nr. 256 datë 20.12.2018, me debitor Bashkia Gjirokastrë, me vlerë 60 000 lekë. Vendim Nr. 154 datë 03.11.2015, me debitor Spitali Rajonal Fier, me vlerë 60 000 lekë. Vendim Nr. 228 datë 22.12.2022, me debitor Posta Shqiptare, me vlerë 200 000 lekë. Vendim Nr. 230 datë 22.12.2022, me debitor Posta Shqiptare, me vlerë 200 000 lekë. Vendim Nr. 112 datë 23.08.2019, me debitor Shoqërinë Maren Bus shpk, me vlerë 100 000 lekë.

⁴⁷ Kjo pjesë nuk detajon të dhënat në lidhje me përfundimin e proceseve gjyqësore, si më sipër. Këtu trajtohen vendimet e komunikuar zyrtarisht nga Gjykata gjatë periudhës janar – dhjetor 2024 (mund të përfshihen këtu edhe vendime të shpallura gjatë vitit 2023, por komunikimi i të cilave është bërë i arsyetuar gjatë vitit 2024).

⁴⁸ 7 (shtatë) nga të cilat janë vendime të Gj.Adm.Sh.I Tiranë, me objekt lëshimin e urdhërave të ekzekutimit, për titujt ekzekutivë, vendimet e gjobës së KMD-së.

në raport me **53 (pesëdhjetë e tre)** vendime të komunikuara gjatë vitit 2023. Nga këto 98 (nëntëdhjetë e tetë) vendime, 47 (dyzet e shtatë) vendime gjyqësore në cilësinë e palës së paditur, 44 (dyzet e katër) vendime gjyqësore në cilësinë e palës së tretë dhe 7 (shtatë) vendime gjyqësore në cilësinë e kërkuarit.

A. Në 47 (dyzet e shtatë) vendime të dhëna nga gjykatat kompetente ku Komisioneri ka qenë palë e paditur dhe palë paditëse ka qenë një individ (14 raste) apo një person juridik/organ publik (33 raste), me objekt shfuqizimin e vendim-marries së KMD-së, është vendosur si më poshtë:

1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka dhënë **36 (tridhjetë e gjashtë) vendime** nga të cilat:
 - Në 23 (njëzet e tre) raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **konstatimin e diskriminimit**. Në këto raste, gjykata ka vendosur:
 - a. Në 7 (shtatë) raste rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - b. Në 4 (katër) raste kthimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - c. Në 1 (një) rast pushimin e gjykimit, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - d. Në 8 (tetë) raste mospranimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit.
 - e. Në 1 (një) rast pranimin e padisë, duke shfuqizuar vendimin e Komisionerit,
 - f. Në 1 (një) rast pranimin e pjesëshëm të padisë, duke shfuqizuar pjesërisht vendimin e Komisionerit,
 - g. Në 1 (një) rast refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë.
 - Në 7 (shtatë) raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **konstatimin e mosdiskriminimit**. Në këto raste, Gjykata ka vendosur:
 - a. Në 1 (një) rast rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - b. Në 2 (dy) raste kthimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - c. Në 1 (një) rast pushimin e gjykimit, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit,
 - d. Në 3 (tre) raste pranimin e padisë, duke shfuqizuar vendimin e Komisionerit.
 - Në 5 (pesë) raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **mospranimin e ankesës**. Në këtë rast, Gjykata ka vendosur:
 - a. Në 1 (një) rast, kthimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit.
 - b. Në 3 (tre) raste, rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit.
 - c. Në 1 (një) rast, pranimin e padisë, duke shfuqizuar vendimin e Komisionerit.
 - Në 1 (një) rast objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **sanksione me gjobë**. Në këto raste, Gjykata ka vendosur:
 - a. Në 1 (një) rast rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e Komisionerit.
2. Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë **10 (dhjetë) vendime**, nga të cilat:
 - Në 7 (shtatë) raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **konstatimin e diskriminimit**. Në këto raste, gjykata ka vendosur:
 - a. Në 1 (një) rast, pranimin e kërkesës së personit të tretë, për përshpejtimin e gjykimit të çështjes;
 - b. Në 2 (dy) raste, ndryshimin e vendimit të Gj.Adm.Sh.i Tiranë, rrëzimin e padisë, lënien në fuqi të vendimit të KMD-së;
 - c. Në 2 (dy) raste, lënien në fuqi të vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tiranë, për rrëzimin e padisë, duke lënë në fuqi vendimin e KMD-së;

- d. Në 1 (një) rast, ndryshimin e vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tiranë, pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimit të KMD-së;
- e. Në 1 (një) rast, lënien në fuqi të vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tiranë, për pranimin e padisë, duke shfuqizuar vendimin e KMD-së.
- Në 3 (tre) raste, objekt gjykimi ka qenë kundërshtimi i vendimit të KMD-së për **konstatimin e mosdiskriminimit**. Në këtë rast, gjykata ka vendosur:
 - a. Lënien në fuqi të vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tiranë (pranimin pjesërisht të padisë, shfuqizimin e vendimit të KMD-së, konstatimin e diskriminimit).
 - b. Lënien në fuqi të vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tiranë (rrëzimin e padisë, lënien në fuqi të vendimit të KMD-së)
 - c. Prishjen e vendimit të Gj.Adm.Sh.I Tiranë (kthimin për rigjykim të çështjes pranë të njëjtës gjykatë, me tjetër trup gjykues).
- 3. Gjkata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka dhënë **1 (një) vendim**, ku Komisioneri është thirrur si palë e paditur, për çështje të patrajtuar më herët nga KMD, e për rrjedhojë gjykata ka vendosur *kthimin e padisë*.

B. Në 44 (dyzet e katër) vendime të dhëna nga gjykatat kompetente ku Komisioneri ka genë palë e tretë me objekt konstatim diskriminimi dhe dëmshpërblim, gjykata ka marrë vendimet si më poshtë:

1. Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka dhënë **6 (gjashtë) vendime** për Komisionerin në cilësinë e palës së tretë duke vendosur:
 - 1 (një) vendim për pranim i pjesë'shëm të padisë (çështje e patrajtuar nga KMD);
 - 1 (një) vendim për mospranim padie (çështje e trajtuar me vendim diskriminimi);
 - 1 (një) vendim për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin nga tarifat gjyqësore (çështje e trajtuar me vendim diskriminimi);
 - 1 (një) vendim për kthimin e padisë (çështje e patrajtuar nga KMD);
 - 1 (një) vendim për rrëzimin e padisë (çështje e trajtuar me vendim mospranimi nga KMD);
 - 1 (një) vendim për pushimin e gjykimit (çështje e patrajtuar nga KMD).
2. Gjkata Administrative e Shkallës së Parë Lushnje ka dhënë **3 (tre) vendime** për Komisionerin në cilësinë e palës së tretë duke vendosur:
 - 1 (një) vendim për pranimin e pjesë'shëm të padisë (çështje e patrajtuar nga KMD);
 - 1 (një) vendim për deklaram moskompetence (çështje e trajtuar me vendim diskriminimi nga KMD);
 - 1 (një) vendim për rrëzimin e padisë (çështje e patrajtuar nga KMD).
3. Gjykatat e Rretheve Gjyqësore⁴⁹ kanë dhënë **23 (njëzet e tre) vendime gjithësej**, duke vendosur:
 - 3 (tre) vendime për pezullimin e gjykimit (çështje të trajtuara nga KMD me vendime diskriminimi);

⁴⁹ Konkretisht nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (8 raste), nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (2 raste), nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (7 raste), nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat (5 raste), nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (1 rast)

- 5 (pesë) vendime për rrëzimin e padisë, (1 rast për çështje të patrajtuar nga KMD më parë, 2 raste për çështje të trajtuar nga KMD me vendim mosdiskriminimi dhe 2 raste për çështje të trajtuara nga KMD me vendim diskriminimi);
 - 2 (dy) vendime për pranimin e padisë (1 çështje të patrajtuar nga KMD më parë dhe 1 çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi);
 - 2 (dy) vendime për zgjidhjen me marrëveshje të padisë (1 çështje të shqyrtuar nga KMD me vendim diskriminimi dhe 1 çështje për të cilën KMD vendosi pushimin e hetimit me kërkesë të ankueses);
 - 3 (tre) vendime për pranimin e pjesës së padisë (1 rast çështje e patrajtuar nga KMD, 2 raste çështje të shqyrtuar nga KMD me vendim diskriminimi);
 - 2 (dy) vendime për shpalljen e moskompetencës lëndore (çështje të trajtuara nga KMD me vendime diskriminimi);
 - 1 (një) vendim për kthimin e akteve të padisë (çështje e patrajtuar nga KMD);
 - 1 (një) vendim për pranimin e kërkesës për korrigjim, (çështje e patrajtuar nga KMD);
 - 1 (një) vendim për refuzimin e kërkesës për sigurim padie (çështje e patrajtuar nga KMD);
 - 3 (tre) vendime për pushimin e gjykimit (1 rast për çështje të patrajtuar nga KMD më parë dhe 2 raste për çështje të trajtuar me vendim diskriminimi nga KMD).
4. Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë **3 (tre) vendime** duke vendosur:
- 1 (një) vendim për ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, pranimin pjesërisht të padisë, konstatimin e diskriminimit, detyrimin e palës së paditur për ndreqjen e shkeljeve, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi;
 - 1 (një) vendim për ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, rrëzimin e padisë, për çështje të patrajtuar nga KMD;
 - 1 (një) vendim për ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, pranimin e kërkesës për përjashtim nga taksat gjyqësore, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi.
5. Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka dhënë **2 (dy) vendime**, për çështje të patrajtuara nga KMD, duke vendosur:
- Në 1 (një) rast ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, duke rrëzuar padinë;
 - Në 1 (një) rast lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, për pranimin e pjesshëm të padisë.
6. Gjykatat e Apelit në rrethe⁵⁰ kanë dhënë **1 (një) vendim**, për 1 çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi, dhe gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor (pranimin e padisë, konstatimin e diskriminimit).
7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dhënë **1 (një) vendim**, për 1 çështje të patrajtuar nga KMD, duke vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim me tjetër trup gjykues.
8. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka dhënë **4 (katër) vendime**, për çështje të patrajtuara nga KMD, duke vendosur:
- Në 1 (një) rast mospranimin e rekursit;


⁵⁰ Konkretisht nga Gjykata e Apelit Vlorë (1 rast).

- Në 1 (një) rast rrëzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit;
 - Në 1 (një) rast prishjen e vendimit të Gj.Adm.Apelit, për kërkimet në lidhje me diskriminimin dhe rikthimin e çështjes për rigjykim në të njëjtën gjykatë;
 - Në 1 (një) rast pranimin e kërkesës për korrigjimin e vendimit.
9. Gjykata Kushtetuese ka dhënë **1 (një) vendim**, për çështje të pashqyrtuar më parë nga KMD, megjithëse KMD ka parashtruar mendimin e tij me shkrim sipas kërkesës së gjykatës, e cila në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e kërkesës për shfuqizimin e vendimit Nr. 00-2022-3578, datë 07.12.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ndër të tjera, në këtë vendim, Gjykata Kushtetuese ka arsyetuar se: “40. Për sa më lart, Gjykata thekson se neni 18 i Kushtetutës, që parashikon ndalimin e diskriminimit, para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas të cilit askush të mos diskriminohet padrejtësisht për shkaqe që lidhen, ndër të tjera, me bindjet politike ose me gjendjen shoqërore. Në këtë pikë, Gjykata evidenton se aty ku ekzistojnë fakte nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, i takon autorit të diskriminimit, në këtë rast punëdhënësit, të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të këtij parimi. Kalimi i barrës së provës nga punëmarrësi (viktima e diskriminimit) te punëdhënësi (autori i diskriminimit) lidhet me vulnerabilitetin e të diskriminuarit, ndaj ai mjafton të paraqesë fakte të besueshme që prezumojnë *prima facie* ekzistencën e një rrethane specifike diskriminuese që ka çuar në një trajtim më pak të favorshëm ose në shkaktimin e dëmit ndaj tij. Nga ana tjetër, gjykata ka detyrën për të verifikuar nëse faktet e pretenduara ekzistojnë dhe të vlerësojë nëse provat e paraqitura nga punëdhënësi janë të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzionin se zgjidhja e marrëdhënieve të punës nuk ka qenë për shkaqe diskriminuese. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë se barra e provës në lidhje me shkaqet për diskriminim në marrëdhëniet e punës i përket fillimisht punëmarrësit, por nëse ky i fundit paraqet disa fakte, të cilat mbështesin në mënyrë të arsyeshme një prezumim për diskriminim, barra e provës kalon te punëdhënësi”.

C. Në çështjet ku KMD ka kërkuar lëshimin e Urdhrave të Ekzekutimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, kjo e fundit gjatë vitit 2024, megjithëse i janë drejtuar disa kërkesa për lëshim urdhëri, ka zbardhur vetëm 7 (shtatë) vendime, për shkak të ngarkesës gjyqësore:

- Në të gjitha rastet gjykata ka vendosur pranimin e kërkesave⁵¹ dhe lëshimin e urdhërave të ekzekutimit, për titujt ekzekutivë (vendime gjore të KMD-së). Në 1 (një) rast subjekti debitor ka qenë një person fizik, ndërsa në 6 (gjashtë) raste, subjekti debitor ka qenë një person juridik.

⁵¹ Vendim Nr. 1553 datë 24.07.2024, Vendim Nr. 1130 datë 25.07.2024, Vendim Nr. 3269 datë 21.06.2024, Vendim Nr. 3700 datë 12.09.2024, Vendim Nr. 3275 datë 28.06.2024, Vendim Nr. 3251 datë 11.10.2024 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.



Grafik Nr. 3 Vendimet gjyqësore të komunikuar ndër vite

Dëmshpërblimi si pasojë e diskriminimit.

Nga praktika e Komisionerit, si palë e tretë në proçese gjyqësore ku kërkohet konstatimi i diskriminimit dhe dëmshpërblimi i dëmit pasuror dhe jopasuror të pësuar si pasojë e diskriminimit të pësuar, rezulton se nga ana e Gjykatave ndiqen këto standarte:

Dëmshpërblimi sipas Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Bazuar në Ligjin Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, neni 34, pika 1, parashikon se: “Çdo person ose grup personash që pretendojnë se ndaj tyre është ushtruar diskriminim për një nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, mund të paraqesin kërkesëpadi përpara gjykatës kompetente sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile për dëmshpërblim sipas ligjit ose, sipas rastit, të kryejnë kallëzimin përpara organeve kompetente për ndjekje penale”.

Gjithashtu, bazuar në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, vendimi i gjykatës cakton dëmshpërblim, nëse gjykata vendos që ka shkelje të këtij ligji, duke përfshirë edhe një afat kohor për kryerjen e zhdëmtimit.⁵²

Në nenin 38 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, përcaktohet dëmshpërblimi. Ky nen nuk ka vendosur tavan për masën e dëmshpërblimit. Konkretisht, në këtë nen përcaktohet se: “Dëmshpërblimi përfshin, ndër të tjera, ndreqjen e shkeljeve ligjore dhe të pasojave të tyre përmes kthimit në gjendjen e mëparshme, kompensimin e duhur për dëmet pasurore si dhe jopasurore, ose përmes masave të tjera të përshtatshme”.

Gjithashtu, sa i takon vendimit të gjykatës, në nenin 37, pika 3, të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se: “Vendosja e masave, sipas këtij ligji, nuk përjashton vendosjen e masave sipas ligjeve të tjera”.

⁵² Neni 37, pika 1, e Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Dëmshpërblimi sipas Kodit Civil dhe Vendimit Unifikues së Gjykatës së Lartë.

Duhet theksuar se praktika gjyqësore shqiptare, lidhur me dëmshpërblimin sipas parashikimeve ligjore për dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror për rastet e diskriminimit është konsoliduar vitet e fundit. Rastet e dëmshpërblimit nga Gjykata, pas vendim-marrjes së Komisionerit, por edhe duke i'u drejtuar drejtpërdrejtë Gjykatës për çështje diskriminimi, kanë ardhur në rritje.

Në fillesat e veta praktika gjyqësore ka përkrahur qëndrimin se, si rrjedhojë e diskriminimit në marrëdhëniet e punësimit, dëmshpërblimi duhet llogaritur bazuar në nenin 608 të Kodit Civil, duke sjellë një analizë të hollësishme të kushteve të kërkuara nga nenet 608 e 609 të Kodit Civil.


Referuar Vendimit Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Nr. 12 datë 14.09.2007, rezulton se katër janë kushtet që të lindi detyrimi nga shkaktimi i dëmit jashtë kontraktor. Konkretisht: të ekzistojë dëmi; ekzistenca e paligjshmërisë së veprimit ose mosveprimit; ekzistenca e fajit; lidhja shkakësore midis veprimit ose mosveprimit dhe pasojës (dëmit) të ardhur. Të katër këto kushte duhet të qëndrojnë bashkarisht (në mënyrë kumulative) që të ekzistojë detyrimi.

Dëmshpërblimi sipas Kodit të Punës.

Dëmshpërblimi sipas nenit 146 të Kodit të Punës është përcaktuar në vlerën e pagave mujore bruto, si pasojë direkte e konstatimit të zgjidhjes së kontratës pa shkaqe të arsyeshme. Por, dhënia e këtij dëmshpërblimi pasuror, nuk përjashton kërkimin për dëmshpërblim jopasuror sipas Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, apo Kodit Civil. Në çdo rast, mbetet në vullnetin e vetë palës paditëse, se referuar kujt baze ligjore do t'i referohet për të zgjidhur pasojat e diskriminimit të pësuar.


Statistika të proçeseve gjyqësore me objekt dëmshpërblimin si pasojë e diskriminimit.

Totali i vlerës së dëmshpërblimit të dhënë për vitin 2024 nga gjykatat kompetente, si pasojë e diskriminimit të konstatuar, është **14, 966, 075 Lekë** (dëm pasuror dhe jopasuror i shkaktuar si pasojë e diskriminimit).



Grafik Nr. 4 Vlerat e dëmshpërblimeve të dhëna nga gjykatat sipas viteve

Nga kjo vlerë (14, 966, 075 lekë), në 2 raste sjellja diskriminuese është shkaktuar nga një person juridik privat (*vlera e dëmshpërblimit nuk identifikohet pasi të dy rastet janë zgjidhur me pajtim*). Në 2 raste sjellja diskriminuese është shkaktuar nga persona juridikë publikë, që i përkasin pushtetit qendror (*vlera totale e dëmshpërblimit në këto dy raste është 5 817 585 lekë*). Në 2 raste, sjellja diskriminuese është shkaktuar nga persona juridikë publikë, që i përkasin pushtetit vendor (*vlera totale e dëmshpërblimit në këto dy raste është 9 148 490 lekë*).



Grafik Nr. 5 Vlerat e dëmshpërblimeve të ndara sipas kategorisë së subjekteve në shkelle

Më specifikisht:

- Në 2 raste çështja e dëmshpërblimit (*në fushën e punësimit*) është zgjidhur me marrëveshje mes palëve në gjykatë dhe nuk identifikohet shuma e akorduar (*vendim Nr. 2540 datë 26.04.2024 dhe vendim Nr. 5055 datë 02.09.2023 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, çështje për të cilat në një rast KMD është shprehur me vendim mosdiskriminimi Nr. 150 datë 18.10.2019 dhe në një rast me vendim pushim procedimi Nr. 15 datë 24.01.2023*).
- Në 1 rast (*vendim Nr. 912 datë 23.11.2023 i Gjykatës Administrative të Apelit*), gjykata vlerësoi dëmshpërblimin jopasuror të dy palëve paditëse në vlerën 3 670 390 lekë dhe 1 835 195 lekë, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi (*Nr. 255 datë 19.12.2018*), në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
- Në 1 rast (*vendim Nr. 789 datë 18.10.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat*), gjykata vlerësoi dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror në vlerën 7 869 902 lekë, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi (*Nr. 129 datë 12.07.2021*), në fushën e punësimit.
- Në 1 rast (*Vendim Nr. 623 datë 18.04.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës*), gjykata vlerësoi dëmshpërblim jopasuror në vlerën 576 588 lekë dhe shëndetësor në vlerën 702 000 lekë, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi (*Nr. 165 datë 13.11.2019*), në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
- Në 1 rast (*vendim Nr. 1081 datë 21.12.2023 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier*) gjykata vlerësoi dëmshpërblim pasuror dhe jopasuror në vlerën 312 000 lekë, për çështje të trajtuar nga KMD me vendim diskriminimi (*Nr. 116 datë 09.09.2019*), në fushën e punësimit.

Arsyet e shfuqizimit të vendimeve të Komisionerit nga Gjykatat.

Referuar të dhënave të vendimeve gjyqësore të parashtruara më herët në këtë kapitull, rezulton se në 43 (dyzet e tre) proçese gjyqësore të zhvilluara pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Apelit, me objekt kundërshtimin e vendimit të KMD-së (gjykime themeli), pra ku KMD ka marrë pjesë si palë e paditur, në **34 (tridhjetë e katër)** prej tyre gjykatat kanë lënë në fuqi vendimin e Komisionerit dhe në **9 (nëntë)** raste kanë shfuqizuar vendimin e Komisionerit. Në një analizë më të thellë, rezulton se:

- Për vendimet e KMD-së, ku është konstatuar diskriminim, janë lënë në fuqi 24 (njëzet e katër) prej tyre dhe janë shfuqizuar 4 (katër) vendime. Arsytimi i gjykatave kompetente në lidhje me shfuqizimin e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes të cilave është konstatuar **diskriminim**, ka qenë si vijon:
 - a. Në vendimin Nr. 2559 datë 06.11.2023, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se: “... Diskriminimi është çështje provueshmërie dhe jo prezumimi ligjor. KMD kur i parashtron pretendimet për diskriminim nga një punëmarrës, ka për detyrë që të verifikojë ekzistencën apo jo të një situate diskriminuese të atij punëmarrësi dhe jo të analizojë procedurën dhe afatet e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për të konkluduar sjelljen diskriminuese ... Ky lloj arsytimi përveçse i pabazuar në prova bie ndesh edhe me një logjikë të drejtë juridike ... Nga një interpretim literal dhe sistematik i këtyre dispozitave është e qartë që bëhet fjalë për dispozita që i referohen gjykatës, në lidhje me konstatimin e diskriminimit, zgjidhjen e pasojave dhe procedurat që ndiqen deri në marrjen e vendimit nga gjykata. Pra, janë parashikime që ligji i posaçëm i ka njohur gjykatës dhe jo Komisionerit. Rrejdhimisht, ky i fundit nuk mund t’i referohet atyre për të përcaktuar masa për ndreqjen e shkeljeve dhe të pasojave të tyre për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur të një punonjësi viktimë e diskriminimit, dhe posaçërisht për rikthimin në evdnin e punës. ... Gjykata çmon se nuk është në kompetencën e KMD-së të marrë masa për rregullimin e pasojave të diskriminimit për shkak të punësimit për rikthimin e punëmarrësit në vendin e mëparshëm të punës ...”.
 - b. Në vendimin Nr. 233 datë 29.02.2024, Gjykata Administrative të Apelit ka arsyetuar se: “... Gjykata vlerëson se nuk ndodhemi para diskriminimit të znj. R.M., nga ana e punëdhënësit, pasi, nuk rezulton që të jetë trajtuar në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, sa kohë që vetë pala e paditur arsyeton se: “Referuar përshkrimit të punës dhe kualifikimit të kërkuar për pozicionin e punës “specialist zyre dhe kontratash”, vlerësohet se përshkrimi i punës së këtij pozicioni është pothuajse i njëjtë me përshkrimin e punës së pozicioneve jurist pranë QFMT Patos dhe QT Patos, si dhe arsimi i lartë, jurist, ekon., ing., etj., pra nga ana teknike dhe kualifikimit nuk kishte asnjë pengesë që znj. R.M., të kishte konkurruar për këtë pozicion pune.” Pra përshkrimi i punës nuk është i njëjtë, por pothuajse i njëjtë sipas palës së paditur. Ndërkohë që “diskriminimi i drejtpërdrejtë” kërkon trajtim në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë.” ... Me vendimin Nr. 162 datë 11.11.2019, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, krahas të tjerave, është vendosur “2. Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a., të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me shtetasen R.M.”. Në lidhje me këtë disponim, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, detyrimi për rikthimin në punë të znj. R.M., është në kundërshtim me të gjithë legjislacionin në Republikën e Shqipërisë, dhe

në mënyrë specifike me Kodin e Punës, i cili ka rregulluar marrëdhënien juridike midis palës paditëse dhe personit të tretë. Gjithashtu ky disponim është në kundërshtim me parimin e lirisë kontraktore, i cili është një ndër parimet themelore të së drejtës kontraktore. Parimi i lirisë së kontraktimit paraqet mundësinë për pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimit që me vullnetin e tyre të lirë t'i rregullojnë marrëdhëniet reciproke juridike të detyrimeve. Parimi i lirisë së kontraktimit do të thotë që cdo subjekt i së drejtës të vendosë lirisht, të lidhë apo të mos lidhë kontratën e caktuar, të zgjedhë lirisht personin me të cilin do lidhë kontratën, si dhe të caktojë lirisht përmbajtjen e kontratës, formën dhe mënyrën e lidhjes së saj. E drejta e rikthimit në punë nuk gjen mbrojtje juridike dhe në vendimin unifikues Nr. 7 datë 01.06.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në të cilin është arsyetuar se: “E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje ligjore”, ndërsa e drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje, thonë në vendimin e tyre me Nr. 31 datë 14.04.2003, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në frymën e Kodit të Punës, si dhe vendimit unifikues Nr. 7 datë 01.06.2011 të KBGJL, Gjykata vlerëson se pika 2 e vendimit Nr. 162 datë 11.11.2019 të KMD-së, nuk gjen mbrojtje juridike dhe si e tillë ajo duhet shfuqizuar.”

- c. Në vendimin Nr. 1011 datë 05.04.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se: “... ASHK nuk rezulton t'i ketë refuzuar dhe mohuar ndonjë të drejtë ankueses, por ka vepruar duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. KMD nuk mund të pretendojë që ASHK-ja ka diskriminuar ankuesen përse kohë që as në ligjin organik apo aktet nënligjore në zbatim të tij nuk është parashikuar detyrimi i ASHK-së për të ofruar një shërbim të tillë”.
- d. Në vendimin Nr. 380 datë 21.03.2024, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se: “Nga shqyrtimi i akteve në dosjen gjyqësore rezulton e provuar se pranë paditësit Avokatura e Shtetit, janë paraqitur dy kërkesa nga z. D.D., respektivisht në datat 15.01.2016 dhe 29.01.2016. Për secilën prej tyre, z. D.D., ka marrë përgjigje. Në kërkesën e datës 29.01.2016 ku z. D.D., kërkon që informacioni i kërkuar të përcillet në gjuhën shqipe është sqaruar se dokumenti i kërkuar nga z. D.D., i është vënë në dispozicion në gjuhën angleze, pasi i tillë është përgatitur dh i tillë disponohet nga vetë Avokatura. Gjithashtu ai sqaron se vënia në dispozicion e dokumentit në gjuhën angleze nuk ka patur për qëllim diskriminimin e z. D.D., e as të personave të tjerë panjohur prej tij. Referuar Ligjit Nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, neni 5 i tij ku janë përcaktuar funksionet e avokatit të shtetit, rezulton se nuk është detyrë funksionale e avokaturës, përkthimi i dokumentacionit në gjuhë të huaj, përkatësisht atë angleze në rastin konkret. Në këto kushte provohet se paditësi nuk është në kushtet e diskriminimit të tërthortë, pasi referuar nenit 3 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nuk provohet që veprimet e paditësit të kenë vënë z. D.D., apo persona të tjerë në kushte jo të favorshme, e diskriminuese për shkak të gjuhës, pasi paditësi ka vënë në dispozicion të z. D.D., dokumentin e kërkuar në kushtet që e dispononte edhe vetë ... ka rezultuar e provuar se institucioni i Avokaturës së Shtetit, nuk ka patur raste të tjera, që të ketë vënë në dispozicion të shtetasve shqiptarë dokumentacionin, në gjuhën shqipe, kur ky dokumentacion është përgatitur në gjuhë të huaj, në respektim të detyrimeve që shteti shqiptar ka si anëtar i organizmave ndërkombëtare. Komiteti i Ministrave, i publikon planet e veprimit/raportimit në faqen e tij zyrtare, e cila është e aksesueshme nga cildo dhe, të cilën pala paditëse, ja ka rekomanduar z. D.D., si një zgjidhje të shpejtë dhe efektive. ... Gjuha e përdorur në komunikimet e shteteve anëtare, aplikantëve, organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare,

apo cdo personi tjetër të interesuar, me institucionet e Këshillit të Evropës, është gjuha angleze dhe franceze. Shqipëria si shtet palë, në kuadër të këtyre parashikimeve ligjore, të gjitha raportimet, përcjelljen e informacionit si dhe komunikimet me këtë institucion, është e detyruar ti kryejë në një nga dy gjuhët zyrtare të njohura nga KEDNJ. Nisur nga sa më sipër, Gjykata cmon se Avokatura e Shtetit, me veprimet e saj nuk ndodhet përpara rasteve të përcaktuara në nenet 1, 3/1, dhe 7 të Ligjit Nr. 10 221/2010. Po kështu, në bazë të pikës 2 të nenit 2 dhe nenit 14, pika 2, shkronja “b” të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, një kopje e plotë e “informacionit publik” të kërkuar që disponohej në arkivat e Avokaturës së Shtetit, i është dërguar kërkuarit D.D. Informacioni shtesë i kërkuar, i njëjti dokumentacion, por në gjuhën shqipe, nuk ka ekzistuar ndonjë herë dhe nuk ka përbërë ndonjëherë “informacion publik”, në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Në gjykim rezultoi se informacioni i disponuar nga paditësi në këtë gjykim, i është dhënë zotit D.D., dhe ky fakt pranohet prej tij dhe, nga Komisioneri. Sipas përcaktimeve të nenit 5 të Ligjit Nr. 10018 datë 13.11.2008 “Për avokaturën e shtetit”, përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, i akteve apo komunikimeve me/për, të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për zotin D.D., apo për cilindo shtetas shqiptar apo të huaj, nuk është parashikuar në ligj, të bëhet nga Avokatura e Shtetit.”


- Për vendimet e KMD-së, ku është konstatuar mosdiskriminim, janë lënë në fuqi 5 (pesë) prej tyre dhe janë shfuqizuar 4 (katër) vendime. Arsyeimi i gjykatave kompetente në lidhje me shfuqizimin e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes të cilave është konstatuar **mosdiskriminim**, ka qenë si vijon:
 - a. Në vendimin Nr. 1590 datë 15.06.2023, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka arsyetuar se: “... Në kuadër të pretendimeve të palës paditëse të paraqitura me anë të kësaj padie, gjykata konstaton se pala e paditur Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kryer një hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes administrative, duke zbatuar dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative sipas parashikimeve të nenit 80 e vijues të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Gjykata çmon se pala e paditur gjatë procedurës hetimore të ankesës së parashtruar duhet të kishte zbatuar parashikimet e nenit 80 të K.Pr.Administrative ... Në këtë kuadër, pala e paditur duhet të kishte marrë në pyetje të gjithë subjektet e përfshira në situatën e pretenduar si diskriminuese e të mos ishte mjaftuar me administrimin e provave shpresore të depozituara dhe më pas të kishte proceduar sipas parashikimeve të nenit 81 të K.Pr.Administrative duke bërë vlerësimin e provave të administruara dhe arritur në përfundimin nëse ka qenë ose jo përpara një situatë diskriminimi në rastin konkret ... Për shkak të analizës së mësipërme të tërësisë së provave të administruara në gjykim, duke arritur në përfundimin se i vetmi organ kompetent i ngarkuar nga ligji për kryerjen e një procedurë të plotë hetimore në lidhje me diskriminimin është Komisioneri përkatës, gjykata vlerëson se duhet të procedojë me pranimin e padisë, duke shfuqizuar vendimin Nr. 110 datë 10.06.2022 të KMD-së dhe konstatimin e faktit të diskriminimit ndaj paditëses ...”.
 - b. Në vendimin Nr. 1430 datë 02.05.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se: “... Për këto arsye, gjykata vlerëson se pala e paditur KMD dhe personi i tretë DAP kanë bërë interpretim dhe zbatim të gabuar të Ligjit Nr. 138/2015 duke e konsideruar gjendjen shoqërore/gjyqësore të paditësit të ndryshme me personat e tjerë

të padënuar dhe të njëjtë me personat e tjerë të dënuar me burgim, për të cilët është vendosur pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë sipas nenit 59 të Kodit Penal. Ndaj, ndryshe nga sa ka vendosur pala e paditur KMD në aktin administrativ, Vendimi Nr. 8 datë 18.01.2023, trajtimi i diferencuar i paditësit D.P., nga DAP, gjatë procedurave të rekrutimit në shërbimin civil, ndryshe nga personat e tjerë të padënuar asnjëherë me vendim penal, është i pabazuar në ligj e prova dhe përbën diskriminim të padrejtë të paditësit për shkak të gjendjes shoqërore/gjyqësore lidhur me të drejtën e paditësit për punësim.”

- c. Në vendimin Nr. 820 datë 02.11.2023, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se: “... Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me këtë nuk ka kryer një hetim të plotë administrativ. Nga ana e Komisionerit, nuk është hetuar lidhur me dijeninë e punëdhënësit për sa i përket gjendjes shëndetësore të paditëses dhe pasojave që ka patur në lidhje me marrëdhënien e saj të punës. Po kështu nuk është hetuar lidhur me metodologjinë, praktika të mëparshme të kësaj banke, procedura pikëzimi të përdorura për plotësimin e pozicionit të Supervizores Operacionale. Pala e paditur duhet të ishte thelluar në verifikimin e pretendimeve të palës paditëse, dhe të hetonte lidhur me këto elementë. Organi administrativ ka jo vetëm të drejtën por edhe detyrimin të kryejë një hetim të plotë administrativ. ... Autoriteti administrativ duhet të veprojë si një mbrojtës i interesave publikë, duke përdorur të gjitha mjetet dhe metodat e të provuarit që ka në dispozicion dhe të verifikojë të gjitha faktet në mënyrë që të arrijë në një vendim sa më të drejtë. Ai nuk mund të kufizohet vetëm në të dhënat e paraqitura nga palët në proces, por nëse do të paraqitet e nevojshme, kërkon edhe vetë ndonjë informacion apo dokumente që i shërbejnë për zgjidhjen e drejtë të çështjes”.
- d. Në vendimin Nr. 1155 datë 15.05.2023, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar: “Paditesi bazuar në një gjendje ankthi, stresi, mendimesh të vazhdueshme, lodhje, këputje dhe pagjumësie të theksuar ka plotësuar edhe deklaratën e paaftësisë së përkohshme, ku ka vetëdeklaruar paaftësinë e përkohshme për të punuar, duke qenë se, për shkak të stresit dhe lodhjes, ishte në pamundësi për të ofruar shërbim të sigurtë. Më pas i është komunikuar se duhet të paraqitej pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të palës së paditur punëdhënëse, për të mësuar rreth qëllimit të kësaj të fundit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, duke nisur që nga data 06.04.2021. Me datë 07.04.2021, shoqëria e paditur "Albcontrol" sh.a., ka kryer kallëzim penal ndaj paditësit, si dhe ndaj KTA F.N., dhe A.F., duke i akuzuar për kryerjen e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi argumentin se plotësimi i deklaratave të paaftësisë së përkohshme për punë ka sjellë si pasojë cenimin e një prej parimeve të rëndësishme, atë të sigurimit të shërbimit në mënyrë të sigurtë dhe të pandërprerë, por që eventualisht mund të çënojë edhe jetën e pasagjerëve, në rast mosfunksionimit të rregullt të këtij shërbimi. Mbi këtë bazë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 2443, datë 07.04.2021, në ngarkim të vetëm tre prej KTA-ve që kishin deklaruar paaftësinë e përkohshme për punë. Gjykata vlerëson se gjatë gjykimit provohet se pala e paditur, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk ka arritur në përputhje me ligjin në përfundim të një hetimi administrativ të zhvilluar në përputhje me procedurat ligjore në konkluzionin se shoqëria Albcontrol sh.a., nuk ka vepruar në shkelje të parashikimeve ligjore që lidhen me diskriminimin e ankuesit për shkak të gjendjes shëndetësore. Në arritjen e përfundimit të tillë KMD, nuk ka kryer një hetim të plotë duke e mbeshtetur vendim-marrjen në

të dhëna e prova shkresore të administruara në proces. Kështu paditesi arriti të provojë shkeljet e pretenduara."

- Për vendimet e KMD-së, ku është konstatuar mospranim ankese, janë lënë në fuqi 4 (katër) prej tyre dhe është shfuqizuar 1 (një) vendim. Arsyetimi i gjykatave kompetente në lidhje me shfuqizimin e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmes të cilave është vendosur **mospranim ankese**, ka qenë si vijon:
 - a. Në vendimin Nr. 4024, datë 06.11.2024, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka arsyetuar se: *"... pala e paditur ka vendosur mospranimin e ankimit pa e marrë fare në shqyrtim atë, me arsyetimin se është depozituar jashtë afateve ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 10221/2010. ... Gjykata vërne se në ankesën fillestare ankuesi Xh.Sh., përvec pretendimit për diskriminim për arsye politike dhe gjendje familjare në lidhje me largimin nga puna në vitin 2015 ... pretendon se diskriminimi përbën një situatë vazhduese, në lidhje me rekrutimin në punë. Pala e paditur, KMD nuk ka marrë për bazë këtë pretendim, duke kufizuar të drejtën e aksesit të subjektit ankues për shqyrtimin në themel të pretendimeve të tij. ... Në rrethanat kur provohet se ankueset kanë parashtruar të dhëna të reja dhe referojnë në elementë të mjaftueshëm për të dyshuar në diskriminim, që duhet të mjaftonin për të nisur një hetim administrativ, Gjykata vlerëson se ankesa plotëson elementët formalë. KMD duhet të kishte vazhduar shqyrtimin në themel të saj për të konkluduar nëse pretendimet e parashtruara janë apo jo të bazuara."*
- Për vendimet e gjobës, është lënë në fuqi 1 prej tyre.



Grafik Nr. 6 Llogaritja në % e vendimeve të lëna në fuqi nga Gj.Adm.Sh.I Tirane dhe Gj.Adm.Apelit

8. Rekomandime dhe opinione ligjore

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarur publik, të attributeve që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 *"Për mbrojtjen nga diskriminimi"*, (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; përmbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin; si dhe zbatimit të nenit 32, pika 1, gërma "ë", të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: *"Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjislacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjislacionit ekzistues"*,

gjatë vitit 2024, me iniciativën e tij apo me kërkesë të institucioneve përkatëse, ka dhënë rekomandimet dhe opinionet ligjore, si më poshtë vijnë:

Rekomandime për akte ligjore dhe nënligjore:

a. Rekomandime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me Projekt-ligjin “Për Barazinë Gjinore”.

Komisioneri gjatë vitit 2024, ka marrë pjesë në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për ndryshimet në Ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Gjatë kësaj periudhe, KMD përmes takimeve konsultative dhe komunikimeve në email, ka propozuar që në qëllimet e këtij draft-ligji të parashikohet edhe mbrojtja efektive nga diskriminimi me bazë gjinore, në jetën publike dhe private, si dhe të bëhet referimi tek legjislacioni në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

KMD ka rekomandur përfshirjen e parimit të zhvendosjes së barrës së provës në draft, duke parashikuar se barra e provës i takon subjektit kundër të cilit ngrihet pretendimi, duke mbajtur në konsideratë të njëjtin parim të parashikuar edhe në Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

KMD ka propozuar gjithashtu që të parashikohet në draft një mbrojtje e barabartë e shtetasve shqiptarë dhe shtetasve të huaj, si dhe ka rekomanduar që KMD të përfshihet si autoritet përgjegjës, në Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore, për të qenë kështu në përqasje të plotë me ndryshimet ligjore që ka pësuar Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i cili parashikon se KMD monitoron zbatimin e Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Në nenin 23 “Përfaqësimi gjithpërfshirës dhe i barabartë gjinor në sistemet e vendim-marrjes”, të draft-ligjit është parashikuar se përfaqësimi gjithpërfshirës në sistemet e vendimmarrjes arrihet nëse sigurohet barazia në masën 30 – 50 për qind për secilën gjini, përmes transparencës dhe integritetit në proceset e emërimit dhe përzgjedhjes për pozicionet vendimmarrëse në pozicionet drejtuese vendore, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.

Komisioneri vlerësoi se referimi i masës së përfaqësimit të bëhet drejtpërdrejt tek Kodi Zgjedhor. Vendosja e kuotës nga 30% deri në 50% e lë evazive parashikimin e Kodit Zgjedhor, i cili ka përcaktuar kuotën 50% për Këshillat Bashkiakë. Megjithëse, nga ana tjetër një parashikim i tillë mund të sjellë riskun e pamundësisë së aplikimit të kuotës 50% në disa pozicione specifike. Për këtë arsye, mund të shihet mundësia e riformulimit të këtij neni, duke specifikuar që përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet kur sigurohet përfaqësim në masën 50% për secilën gjini, në ato raste kur kjo është e mundur, dhe në rastet e tjera vlen përfaqësimi me kuotën dysHEME 30% deri në masën 50%, si kuotë tavan.

Në Pjesën IV “Mbrojtja dhe trajtimi i barabartë, në bazë të përkatësisë gjinore, në marrëdhëniet e punës”, neni 24 “Detyrimet e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës” ka përfshirë një pjesë të detyrimeve që edhe Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikon në Kreun II të tij “Mbrojtja nga diskriminimi në punësim”. Komisioneri vlerësoi që në këtë nen të bëhet referimi tek Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në mënyrë që të gjithë parashikimet e Kreut II të LMD-së të bëhen pjesë e detyrimeve që parashikon neni 24 i draftit të Ligjit “Për barazinë gjinore”.

I njëjti propozim është dhënë edhe për nenin 29 “Të drejtat e punëmarrësit për respektimin e parimeve të barazisë gjinore”, për të cilin Komisioneri rekomandoi që të shihet mundësia për të shtuar si të drejta të punëmarrësit edhe të drejtat që LMD njeh, duke u përcaktuar si vijon: “h. Çdo punëmarrës ka të drejtë të ankohet te punëdhënësi, te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ISHP, ose në gjykatë, nëse beson se ka pësuar diskriminim. Kjo dispozitë nuk e kufizon të drejtën e ankimit në institucione të veçanta, të ngritura pranë sektorëve të ndryshëm të punësimit. i. Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës. j. Punëmarrësi ka të drejtë të marrë informacion në çdo kohë në lidhje me trajtimin e ankesës, si dhe të marrë shpjegime për vendimet e marra nga punëdhënësi, në përgjigje të ankesës së tij, menjëherë pas shqyrtimit. k. Në rast se punëdhënësi nuk merr masa për të hetuar dhe për të zgjidhur ankesën për diskriminim, punëmarrësi që ka bërë ankesën ka të drejtë ta ndërpresë punën, pa humbur të drejtën e pagës, për atë kohë sa është e nevojshme për t’u mbrojtur nga diskriminimi/shkelja. Punëmarrësi kthen pagën e marrë, sipas këtij neni, në rast se diskriminimi/shkelja i/e pretenduar nuk rezulton i/e vërtetuar me vendim të formës së prerë.”

Statusi aktual: Në proces.

b. Rekomandime⁵³ të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me Projektvendimin “Për një ndryshim në VKM Nr. 1140, datë 24.12.2020, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025 dhe Planin e Veprimit 2023 – 2025, të ndryshuar”.

Komisioneri ka vlerësuar iniciativën e Ministrisë për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave, 2024 – 2025, duke përfshirë edhe institucionet e pavarura, në veçanti parashikimin në këtë Plan, si aktivitet⁵⁴ për realizimin e Masës prioritare 2.1.2 “Identifikimi në kohë i viktimave të trafikimit dhe VMT dhe ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse përkatëse për nevojat e tyre”, zhvillimin e trajnimeve për çështje të mosdiskriminimit ndaj ofrimit të shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit apo viktimave të mundshme të trafikimit, duke parashikuar Komisionerin si institucion përgjegjës.

Ndërkohë sa i takon Draft-Planit të Veprimit, 2024 - 2030, në Objektivin Specifik 2.1: “Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t’iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar”, është parashikuar Masa 2.1.2.2 “Trajnimi për çështje të mosdiskriminimit ndaj ofrimit të shërbimeve ndaj VT/VMT”. Në këtë masë të parashikuar, ndryshe nga Draft-Plani Kombëtar i Veprimit, 2024 – 2025, është konstatuar se nuk ka të përcaktuar Komisionerin si institucion përgjegjës apo kontribues.

Sa më sipër, Komisioneri ka rekomanduar që masa e zhvillimit të trajnimeve për çështje të mosdiskriminimit ndaj ofrimit të shërbimeve ndaj viktimave të trafikimit apo viktimave të mundshme të trafikimit të ndjekë të njëjtën linjë në të dy Planet e Veprimit, qoftë tek Plani i Veprimit 2024 – 2025, ashtu edhe tek Plani i Veprimit 2024 – 2030, duke u përcaktuar në të dyja rastet si

⁵³ Përcjellë me shkresën Nr. 302/1 Prot., datë 06.03.2024, drejtuar Ministrisë së Brendshme.

⁵⁴ Aktiviteti “Zhvillimi i trajnimeve për çështje të mosdiskriminimit ndaj ofrimit të shërbimeve ndaj VT/VMT”; Masa prioritare 2.1.2 “Identifikimi në kohë i viktimave të trafikimit dhe VMT dhe ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes gjithëpërfshirëse përkatëse për nevojat e tyre”; Objektivi Specifik 2.1 “Identifikimi dhe mbështetja e individëve në rrezik për t’iu nënshtruar shtrëngimit, dhunës dhe frikësimit nga krimi i organizuar”; Qëllimi i Politikës II “Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë”.

masë e planifikuar për t'u zhvilluar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion përgjegjës.

Nga ana tjetër, Komisioneri rekomandoi se duhet të shtohet si masë, në të dy draftet e Planeve të Veprimit, zhvillimi i trajnimeve nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për çështje të diskriminimit edhe të stafeve të atyre strukturave që kanë kontakt të drejtpërdrejtë me viktimat e trafikimit apo viktimat e mundshme të trafikimit.

Statusi aktual: Zbatuar.

c. Rekomandime⁵⁵ të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me Projektligjin “Për Policinë e Shtetit”.

Në nenin 7, pika 1, germa “d”, të Projekt-ligjit, ku është parashikuar se: *“1. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Policia e Shtetit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: ... d) mosdiskriminimi, trajtimi i barabartë dhe i drejtë i të gjithë personave ...”*; Komisioneri rekomandoi që të riformulohet në mënyrë më konçize, sikurse janë formuluar edhe parimet e tjera në këtë nen, duke u saktësuar në: *“1. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, Policia e Shtetit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: ... d) barazia dhe mosdiskriminimi ...”*.

Në nenin 7, pika 2, të Projekt-ligjit, ku është parashikuar se: *“2. Në trajtimin e punonjësve të saj policia udhëhiqet nga parimi i integritetit, objektivitetit, meritës, transparencës, garantimit të zhvillimit të karrierës profesionale, barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit”*; KMD rekomandoi që parashikimi i termit *“barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit”* të riformulohet duke u konkretizuar vetëm në termin “barazisë dhe mosdiskriminimit”, në mënyrë të tillë që të mos veçohet vetëm “gjinia” si shkak i mbrojtur, por parimi të jetë gjithëpërfshirës, në të njëjtën frymë edhe me pikën 1 të nenit 7. Kjo për faktin dhe sepse neni 7, në tërësinë e tij, lexohet si një nen përgjithësues dhe gjithëpërfshirës.

Ndërsa sa i takon parashikimeve në lidhje me *“barazinë gjinore”*, në mënyrë që përfaqësimi në rradhët e policisë të respektojë të dy gjinitë, KMD rekomandoi që të shihet mundësia për t'a konkretizuar këtë në një dispozitë më vete, ose në nenin 47, pika 5 (Organizimi i Policisë së Shtetit) e Projekt-ligjit, ku parashikohet se: *“5. Numri i përgjithshëm i personelit të Policisë së Shtetit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.”*, të shtohet si vijon: *“5. Numri i përgjithshëm i personelit të Policisë së Shtetit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit, duke respektuar parimin e përfaqësimit të barabartë gjinor.”*

Në nenin 13, pika 2, të Projekt-ligjit, ku parashikohet se: *“2. Njoftimi duhet të jetë i qartë dhe i drejtpërdrejtë. Ai mund të jepet në mënyrë verbale, të shkruar ose nëpërmjet medias”*. Komisioneri vlerësoi se njoftimi drejtuar një subjekti, qoftë person juridik apo privat, në çdo rast duhet të jetë i tillë, që të jetë efektiv dhe të mundësojë aksesueshmëri për të gjithë kategoritë e subjekteve. Kështu, në rastin e personave me aftësi të kufizuara në shikim apo dëgjim, njoftimet të bëhen duke respektuar gjuhën e shenjave. Sa më sipër, KMD vlerësoi që parashikimi i mësipërm të riformulohet duke u

⁵⁵ Përcjellë me shkresën Nr. 568/1 Prot., datë 24.04.2024, drejtuar Ministrisë së Brendshme.

saktësuar në: “2. Njoftimi duhet të jetë i qartë, i aksesueshëm dhe i drejtpërdrejtë. Ai mund të jepet në mënyrë verbale, të shkruar ose nëpërmjet medias, sipas rastit”.

Në nenin 20, pika 4 dhe 5, të Projekt-ligjit, ku parashikohet se: “4. Dispozitat për ndalimin e përkohshëm policor nuk zbatohen ndaj personit lëvizshmëria e të cilit është e pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore/shtatzënisë ... 5. Personi ndaj të cilit aplikohet ndalimi i përkohshëm policor ka të drejtë të informohet menjëherë në gjuhën që ai kupton, për shkaqet e këtij ndalimi ...”, **Komisioneri rekomandoi**, që me qëllim së pari, garantimin e një aksesu cilësor dhe në baza të barabarta me të tjerët në shërbimet policore nga ana e personave me aftësi të kufizuara; së dyti, pranimin dhe promovimin e diversitetit të personave me aftësi të kufizuara; së treti, sigurimin e përshtatjes dhe fleksibilitetit të procedurave në raport me diversitetin e personave me aftësi të kufizuara; së katërti, sigurimin e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, duke eliminuar të gjitha pengesat/barrierat; së pesti, ofrimin e një trajtimi preferencial për personat me aftësi të kufizuara, marrë në konsideratë aftësinë e kufizuar; si dhe forcimin dhe lehtësimin e komunikimit me personat me aftësi të kufizuar, **të riformulohen pika 4 dhe 5, e nenit 20**, si vijon: “4. Dispozitat për ndalimin e përkohshëm policor nuk zbatohen ndaj personit lëvizshmëria e të cilit është e pamundur për shkak të gjendjes shëndetësore, shtatzënisë, ose aftësisë së kufizuar. ... 5. Personi ndaj të cilit aplikohet ndalimi i përkohshëm policor ka të drejtë të informohet menjëherë në gjuhën që ai kupton dhe ka aksesueshmëri, për shkaqet e këtij ndalimi. ...”. Riformulimi i mësipërm, është i nevojshëm edhe për faktin pasi, Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i trajton si shkaqe të ndara dhe të mëvetësishme “gjendjen shëndetësore”, “shtatzëninë” dhe “aftësinë e kufizuar”. Mund të ketë ndërveprim mes këtyre tre shkaqeve, por jo domosdoshmërisht gjithmonë “gjendja shëndetësore”, nënkupton “shtatzëninë”. Për këtë arsye, KMD vlerësoi se këto shkaqe duhet të qëndrojnë të ndara në parashikimin e pikës 4 të nenit 20 të Projekt-ligjit.

Në nenin 26, pika 1 dhe 3 të Projektligjit, ku parashikohet se: “1. Masat mbrojtëse merren ndaj personit me ç'rregullime të shëndetit mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës, ose sipas rastit njofton strukturat përkatëse të specializuara për marrjen e masave mbrojtëse ndaj gjendjes së personit. ... 3. Mbajtja e personit në ambientet e policisë vazhdon për aq kohë sa është e nevojshme, por jo më shumë se 6 orë”; Komisioneri vlerësoi se pika 1 e këtij neni duhet të riformulohet duke marrë në konsideratë edhe parashikimet e Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ratifikuar nga shteti shqiptar me Ligjin Nr. 108/2012.

Në nenin 1 të kësaj Konvente, parashikohet se: “Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.”

Megjithëse, në Ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, nenin 3, pika 2 jepet përkufizimi “2. “Çrregullim i shëndetit mendor” është çrregullimi thelbësor i mendimit, perceptimit, orientimit ose kujtesës, që dëmtojnë sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, çka e bën atë mendërisht të sëmurë, ose është prapambetja mendore, kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme”;

Komisioneri vlerësoi se në Projektligjin “Për Policinë e Shtetit”, neni 26, pika 1, duhet të hiqet termi “person me ç’rregullime të shëndetit mendor”, dhe duhet të zëvendësohet me termin “person me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor”, duke iu përshtatur kështu termave universalë të Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Sa i takon, pikës 3 të nenit 26, Komisioneri rekomandoi se duke qenë se bëhet fjalë për kategori vunerabël, sikurse janë parashtruar në pikën 1 të këtij neni, duhet të vlerësohet që mbajtja e këtyre personave në ambjentet e policisë të jetë sa më e shkurtër, duke marrë në konsideratë faktin që jo gjithmonë, ambjentet e policisë përmbushin kushtet apo janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për t’i shërbyer kësaj kategorie. Fakt ky, i konstatuar edhe nga praktika e punës hetimore të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Në çdo rast, KMD vlerësoi faktin që në Projektligjin e ri, afatet e mbajtjes së personave në ambjentet e policisë janë shkurtuar, krahasuar me parashikimet ligjore në fuqi.

Në nenin 39, pika 4, ku parashikohet se: “4. Ndalohet mbledhja e të dhënave të individëve dhe subjekteve vetëm për shkak se i përkasin një origjine ose etnie të caktuar, bindjeje të veçantë fetare, orientimi seksual ose bindjeje politike apo i përkasin një lëvizjeje ose organizate, kur nuk parashikohet me ligj”, Komisioneri rekomandoi që formulimi i këtij neni të bëhet duke mbajtur në konsideratë nenin 1 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ku lista e shkaqeve të mbrojtura është më e gjërë, dhe garanton një mbrojtje më të lartë. Kështu, vlerësojmë se kjo pikë e nenit 39, duhet të riformulohet si vijon: “4. Ndalohet mbledhja e të dhënave të individëve dhe subjekteve vetëm për shkak se i përkasin një race, etnie, ngjyre, bindje politike, fetare ose filozofike, identiteti gjinor, orientimi seksual të caktuar, apo për shkak të karakteristikave të seksit, jetesës me HIV/AIDS, si dhe për shkak se i përkasin një lëvizjeje ose organizate, kur nuk parashikohet me ligj”.

Në nenin 68, pika 6 të Projekt-ligjit, parashikohet se: “6. Punonjësit e policisë të rolit bazë që pranohen në programin “Bachelor” nuk llogariten si pjesë e numrit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ata janë të detyruar të përfundojnë studimet brenda periudhës së parashikuar 3- vjeçare. Shpenzimet e studimeve të tyre mbulohen nga buxheti i Policisë së Shtetit. Pas përfundimit me sukses të studimeve në programin “Bachelor” të institucionit arsimor të sigurisë publike, punonjësit e policisë kanë detyrimin e qëndrimit në detyrë të paktën edhe 5 vite të tjera. Punonjësit që nuk e përfundojnë me sukses programin “Bachelor” kanë detyrimin e shlyerjes së kostove për kohën e ndjekjes së këtij programi studimi”.

Komisioneri vlerësoi se në dispozitën e mësipërme, vendoset një kufizim për këtë kategori punonjësish të policisë, pasi kushtëzon përfundimin e programit “Bachelor” me detyrimin për qëndrim në detyrë, të paktën dhe 5 vite të tjera. Në këndvështrimin tonë, detyrimi i parashikuar, do të duhet që të justifikohet me praninë e një interesi publik që e imponon këtë nevojë.

Për të vlerësuar sa më të drejtë nevojën e interesit publik për të detyruar këtë kategori punonjësish që të qëndrojnë në detyrë të paktën dhe 5 vite të tjera, pas përfundimit të programit “Bachelor”, është e nevojshme që kjo të jetë evidentuar paraprakisht në dokumenta analitikë, kërkimorë apo studimorë. Këto analiza shërbejnë edhe për të kuptuar proporcionalitetin e kufizimit të propozuar. Komisioneri del në këtë përfundim, pasi jo në pak procedura administrative hetimore të zhvilluara pranë KMD-së, vendim-marrja për të vlerësuar nëse jemi apo jo para një shtate diskriminuese, është bazuar në dokumenta analitikë, kërkimorë e studimorë, e sidomos në të dhëna konkrete statistikore.

Në nenin 79 të Projektligjit është parashikuar se: “1. Kandidatët të cilët nuk janë punonjës të Policisë së Shtetit, pranohen në programet e formimit të Akademisë së Sigurisë pas verifikimit të besueshmërisë. 2. Verifikimi i besueshmërisë kryhet nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit në raport me të dhënat e regjistrave fizikë e elektronikë në administrim të Policisë së Shtetit dhe në regjistrat fizikë e elektronikë tek të cilat Policia e Shtetit ka akses. 3. Procesi i verifikimit nga ana e Policisë nuk duhet të pengojë procese të tjera kombëtare në fushën e pranimeve universitare, por bëhet para tyre në kohë.”

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë trajtuar disa ankesa në lidhje me skualifikimin e aplikantëve nga procedurat e konkurrimit në programet e Akademisë së Sigurisë, si pasojë e mosplotësimit të fazës së vlerësimit të besueshmërisë. Në disa raste, KMD ka konstatuar se procedurat për kryerjen e këtyre verifikimeve nuk janë bërë asnjëherë të ditura, duke lënë vend për mostransparencë. Në këtë kontekst, KMD në vendim-marrjet e tij ka vlerësuar se strukturave të policisë i'u është lënë një diskrecion i gjerë në përcaktimin dhe hartimin e vërtetimit të besueshmërisë së individit që konkuron në Akademinë e Sigurisë. Ky diskrecion i gjerë dhe mostransparenca mundet të afektojë individët vetëm sepse një i afërm i tyre mund të jetë i përfshirë në aktivitet kriminal.

Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi se do të duhet një riformulim i këtij neni, me qëllim që në të ardhmen mos të gjendemi përpara të njëjtave raste për të cilat KMD ka konstatuar diskriminim. Kështu, KMD rekomandon që neni 76 të riformulohet si vijon: “1. Kandidatët të cilët nuk janë punonjës të Policisë së Shtetit, pranohen në programet e formimit të Akademisë së Sigurisë pas verifikimit të besueshmërisë. 2. Verifikimi i besueshmërisë kryhet nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit në raport me të dhënat e regjistrave fizikë e elektronikë në administrim të Policisë së Shtetit, në regjistrat fizikë e elektronikë tek të cilat Policia e Shtetit ka akses, si dhe në të dhëna të institucioneve të tjera ligjzbatuese kur është e nevojshme, duke respektuar parimin e transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit. 3. Procesi i verifikimit nga ana e Policisë nuk duhet të pengojë procese të tjera kombëtare në fushën e pranimeve universitare, por bëhet para tyre në kohë.”

Komisioneri rekomandoi që neni 90, pika 1, e Projekt-ligjit, i cili parashikon se: “1. Punonjësi i policisë gjatë ushtrimit të kompetencave policore: a) është i detyruar të veprojë me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim dhe të respektojë dinjitetin, integritetin, të drejtat dhe liritë e çdo individi;”, të riformulohet për qëllime të unifikimit të termave të përdorura në ligj, si vijon: “1. Punonjësi i policisë gjatë ushtrimit të kompetencave policore: a) është i detyruar të veprojë me profesionalizëm, paanshmëri, duke respektuar dinjitetin, integritetin, të drejtat dhe liritë e çdo individi, në përputhje me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit;”.

Komisioneri vlerësoi faktin që në parashikimin e nenit 92, pika 2 të Projektligjit është parashikuar se: “2. Veprimet ose vendimet me natyrë hakmarrëse ndaj punonjësit të policisë që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar të paligjshme ose kundërshton një urdhër të dyshuar si i paligjshëm, trajtohen sipas procedurave të përcaktuara të legjislacionit në fuqi për sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, këtij ligji dhe Rregullores së Policisë së Shtetit. Në çdo rast, kur vërtetohen, pasojat e ardhura nga këto vendime apo veprime konsiderohen të pavlefshme”. Përndjekja dhe hakmarrja ndaj një punonjësi për shkak të denoncimit apo sinjalizimit të veprimeve të paligjshme të një eprori apo kolegu të tij, janë konsideruar jo në pak raste, sjellje diskriminuese gjatë praktikës hetimore të Komisionerit. Në këto kushte, KMD do të vlerësonte nëse gjatë ndjekjes së këtyre

veprimeve/vendimeve hakmarrëse, të mbaheshin në konsideratë edhe parashikimet e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Sa i takon nenit 120, pika 4, germa “h” dhe “i”, të Projektligjit, ku parashikohet se: “4. Shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i punonjësit të Policisë, punonjësit që bashkëpunon me të, ose atij që nxit kryerjen e shkeljeve, që ka sjellë pasoja të rënda dhe është kryer në kushtet e rrethanave rënduese. Shkelje të rënda janë: ... h) ngacmimet seksuale; ... i) veprimet diskriminuese në bazë të moshës, gjinisë, orientimit seksual, përkatësisë etnike apo fetare ...”, Komisioneri së pari vlerësoi faktin që kjo dispozitë ka parashikuar si shkelje të rëndë rastet e ngacmimit seksual, në përputhje të plotë me parashikimet e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili ka parashikuar “shqetësimin seksual” si formë diskriminimi, por edhe në përputhje të plotë me parashikimet e Konventës 190 “Për dhunën dhe ngacmimin”, ratifikuar së fundmi nga shteti shqiptar me Ligjin Nr. 13/2022. Së dyti, Komisioneri vlerësoi se germa “i” e këtij neni duhet të riformulohet duke përfshirë si shkelje të rënda, të gjitha veprimet diskriminuese që vijnë për shkak të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, shtetësisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të seksit, jetesës me HIV/AIDS, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, pamjes së jashtme, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër. Pra, të zgjerohet lista e shkaqeve në përputhje me parashikimin e nenit 1 të Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili parashikon një listë më të gjerë dhe joshteruese të shkaqeve të mbrojtura.

Komisioneri sqaroi se Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, ka klasifikuar si formë të rëndë diskriminimi, çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën. Për sa më sipër, mund të shihet mundësia që në pikën 4, nenit 120, të mbahen parasysht si rrethana rënduese, për konstatimin e shkeljes së rëndë sipas germës “i”, rastet kur veprimi diskriminues është kryer nga më shumë se një shkak, është kryer më shumë se një herë, ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose ka sjellë pasoja të rënda për viktimën.

Në linjën e arsytimit si më sipër, KMD rekomandoi që germa “i”, pika 4 e nenit 120 të formulohet si vijon: “4. Shkelje e rëndë disiplinore konsiderohet veprimi ose mosveprimi i punonjësit të Policisë, punonjësit që bashkëpunon me të, ose atij që nxit kryerjen e shkeljeve, që ka sjellë pasoja të rënda dhe është kryer në kushtet e rrethanave rënduese. Shkelje të rënda janë: ... i) veprimet diskriminuese që vijnë për shkak të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, shtetësisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të seksit, jetesës me HIV/AIDS, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, pamjes së jashtme, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë, ose çdo shkak tjetër, kur këto veprime kryhen për më shumë se një shkak, më shumë se një herë, veprimi ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose ka sjellë pasoja të rënda për viktimën.”

Statusi aktual: Zbatuar.

d. Rekomandime⁵⁶ të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për Projekt-ligjin “Për vullnetarizmin”.

Komisioneri ka rekomanduar riformulimin e disa dispozitave të Projektligjit duke mbajtur në konsideratë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas përkufizimeve të Ligjit të posaçëm “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Konkretisht, referuar listës së shkaqeve të mbrojtura që parashikon neni 1 i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri rekomandoi që pika 1 dhe 3, e nenit 9, të këtij Projekt-ligjit të riformulohet si vijon: “1. Ofruesi vullnetarizmit trajton çdo vullnetar në bazë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër. ... 3. Ofruesi vullnetarizmit dhe vullnetari trajtojnë çdo individ, që është përfitues i vullnetarizmit, në bazë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Sa i takon pikës 2 të nenit 9 të Projekt-ligjit, Komisioneri vlerësoi se edhe ky parashikim vjen në përputhje të plotë me parashikimin e nenit 6 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar. Megjithatë, sa i takon gërmes “b”, të pikës 2, të nenit 9, ku parashikohet se: “... 2. Nuk përbën diskriminim trajtimi i ndryshëm i vullnetarëve, kur: b. bazohet në kapacitetin e vullnetarëve për të kryer punën ose shërbimin vullnetar ...”, Komisioneri rekomandoi të bëhet një riformulim i këtij parashikimi pasi në pamje të parë nuk del qartë qëllimi i kësaj dispozite, e mbi të gjitha duket sikur termi “kapacitet” i përdorur, paragjykon atë kategori individësh, për të cilët përligjet trajtimi i ndryshëm.

Ndërsa sa i takon parashikimit në germen “c” në pikën 2, të nenit 9, Komisioneri rekomandoi që të bëhet referimi edhe tek Ligji i posaçëm “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, apo tek ligje të tjera, për një mbrojtje më gjithëpërfshirëse, duke u riformuluar dispozita si vijon: “... 2. Nuk përbën diskriminim trajtimi i ndryshëm i vullnetarëve, kur: ... c. parashikohet shprehimisht në këtë ligj apo në ligje të tjera specifike”.

Në lidhje me parashikimin e nenit 10 të Projektligjit, se: “Ndalohej kryerja e çdo veprimi që përbën shqetësim seksual për vullnetarin ose përfituesin e vullnetarizmit. Shqetësim seksual është çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime fizike e simbolike, me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues ose fytes, që kryhet nga ofruesi i vullnetarizmit kundrejt një vullnetari ose përfitues vullnetarizmi, midis vullnetarëve, ose midis vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit.”, Komisioneri rekomandoi riformulimin e tij me qëllim që kjo dispozitë

⁵⁶ Përcjellë me shkresën Nr. 1617/3 Prot., datë 27.12.2024 të KMD-së, drejtuar Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

të jetë e përjasur plotësisht me parashikimin e nenit 3, pika 13 dhe 14 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, i cili i konsideron “Shqetësimin” dhe “Shqetësimin seksual”, si forma diskriminimi, duke mos u ndalur kështu vetëm tek sjelljet shqetësuese me natyrë seksiste: “1. Ndalohet kryerja e çdo veprimi që përbën shqetësim për vullnetarin osë përfituesin e vullnetarizmit. Shqetësim është çdo sjellje e padëshiruar, që kryhet nga ofruesi i vullnetarizmit kundrejt një vullnetari ose përfitues vullnetarizmi, midis vullnetarëve, ose midis vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 9 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë. 2. Ndalohet kryerja e çdo veprimi që përbën shqetësim seksual për vullnetarin ose përfituesin e vullnetarizmit. Shqetësim seksual është çdo sjellje e padëshiruar, verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, që kryhet nga ofruesi i vullnetarizmit kundrejt një vullnetari ose përfitues vullnetarizmi, midis vullnetarëve, ose midis vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të.”

Referuar parashikimit në nenin 19 të Projektligjit se: “1. Ofruesi i vullnetarizmit duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë krijimit të kushteve për angazhimin si vullnetarë, të personave që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si personat me aftësi të kufizuara, personat që i përkasin grupeve sociale dhe ekonomike të disavantazhuara dhe personave që u është kufizuar zotësia për të vepruar, me qëllim zhvillimin e personalitetit, fuqizimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. 2. Ofruesi i vullnetarizmit siguron mbështetje dhe mbikëqyrje të përshtatshme gjatë vullnetarizmit, për vullnetarët që i përkasin kategorinë e personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni. 3. Vullnetari, të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar, mund të kryejë vullnetarizëm dhe lidhë kontratë vullnetarizmi vetëm me pëlqimin me shkrim të kujdestarit të tij ligjor. 4. Vullnetari të cilit i është kufizuar zotësia për të vepruar mund ta ndërpresë vullnetarizëm në çdo kohë, pa nevojën e pëlqimit me shkrim, por duke vënë në dijeni kujdestarin ligjor.”. Komisioneri rekomandoi me qëllim trajtimin e barabartë të gjithë kategorive vunerabël të cituara, si dhe ofrimin e mundësive dhe garantimin e një aksesit cilësor dhe në baza të barabarta me të tjerët, të riformulohet pika 2 e nenit 19 si vijon: “... 2. Ofruesi i vullnetarizmit siguron mbështetje, aksesueshmëri, trajtim të barabartë dhe mbikëqyrje të përshtatshme gjatë vullnetarizmit, për vullnetarët që i përkasin kategorisë së personave të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni. ...”.

Në nenin 20 të Projektligjit ku është parashikuar se:

1. Ofruesi vullnetarizmit, duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë përzgjedhjes, trajnimit dhe mbikëqyrjes së vullnetarëve që angazhohen në një program vullnetarizmi me përfitues individët, që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.
2. Ndalohet angazhimi si vullnetarë, në një program vullnetarizmi me përfitues individët, që i përkasin kategorive të posaçme shoqërore, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat me çrregullime të shëndetit mendor, të moshuarit, të miturit, viktimat e dhunës në familje, viktimat e krimeve seksuale dhe të trafikimit, personave që u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, i personave si vijon: a) personat të cilët po i nënshtrohen detyrimit për trajtim të pavullnetshëm për sëmundjet e rënda mendore, detyrimit për pjesëmarrje në programe

rehabilitimi psikosociale, të alkoologjisë, ose të toksikologjisë, detyrimit për pjesëmarrje në program të aftësisimit prindëror, ose ndaj të cilit është vendosur një nga masat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje, sipas legjislacionit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. b) personat ndaj të cilëve zbatohet një masë e ndalimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale, kur këto lidhen me vullnetarizmin, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi. c) personat që janë në procedim penal ose janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale kundër jetës, shëndetit, krimeve seksuale, lirisë së personit, kundër moralit dhe dinjitetit ose kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi.

3. Në rastin e kryerjes së vullnetarizmit sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 25, ofruesi i vullnetarizmit do të sigurojë mbikëqyrjen e vazhdueshme profesionale të vullnetarit, dhe që vullnetari nuk do të vendoset në kontakt të pa mbikëqyrur me përfituesin e vullnetarizmit, përgjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit.
4. Në rastin e kryerjes së vullnetarizmit sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit 25, ofruesi i vullnetarizmit do të sigurojë mbikëqyrjen e vazhdueshme profesionale të vullnetarit, dhe që vullnetari nuk do të vendoset në kontakt të pa mbikëqyrur me përfituesin e vullnetarizmit, derisa të sigurojë dokumentacionin që vërteton se nuk ndodhemi në rastet e ndalimit, të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni.” Në lidhje me dispozitën e mësipërme, vërehet se është përdorur në disa raste, terminologjia “personat me çrregullime të shëndetit mendor”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerësoi se parashikimet e mësipërme duhen riformuluar në raport me këtë terminologji të përdorur duke marrë në konsideratë parashikimet e Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ratifikuar nga shteti shqiptar me Ligjin Nr. 108/2012.

Në nenin 1 të kësaj Konvente, parashikohet se: “Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërvëprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.”

Megjithëse, në Ligjin Nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”, nenin 3, pika 2 jepet përkufizimi “2. “Çrregullim i shëndetit mendor” është çrregullimi thelbësor i mendimit, perceptimit, orientimit ose kujtesës, që dëmton sjelljen, gjykimin, kapacitetin për të njohur realitetin ose aftësinë e personit për të përmbushur kërkesat e jetës, çka e bën atë mendërisht të sëmure, ose është prapambetja mendore, kur shoqërohet me sjellje agresive patologjike ose seriozisht të papërgjegjshme”;

Komisioneri vlerëson se në Projektligjin “Për vullnetarizmin”, në nenin 20, pika 1 dhe 2, duhet të hiqet terminologjia “persona me ç’rregullime të shëndetit mendor”, duke u zëvendësuar me termin “persona me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor”, duke i’u përshtatur kështu termave universalë të Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Komisioneri vlerësoi se parashikimi në germën “b” të nenit 27 të Projektligjit, ku thuhet se “Kontrata e vullnetarizmit përfundon: ... b) kur vullnetari bëhet i paaftë për të kryer vullnetarizmin.”, duhet riformuluar pasi termi i “paaftë” i përdorur, është një term i papërshtatshëm në kuptim të Konventës “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ratifikuar me Ligj Nr. 108/2012, e cila e konsideron dhe trajton çdo person si të aftë, por me kufizime të caktuara, specifike dhe në asnjë rast nuk përdor këtë terminologji në përcaktim. Në këto kushte, KMD rekomandoi riformulimin e këtij parashikimi ligjor në: “Kontrata e vullnetarizmit përfundon: ... b) kur vërtetohet fakti i pamundësisë së vullnetarit për të kryer vullnetarizmin.”

Statusi aktual: Në proces.

Ndihma juridike

Në referim të nenit 6 të Kodit të Proçedurave Administrative, që parashikon se: “1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit”, nenit 3 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, që parashikon se: “1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet. 2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar”, si dhe nenit 32, pika 1, gërma “j”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që parashikon se: “Komisioneri ka kompetencë të informojë për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2024, ka ofruar ndihmën e tij juridike si më poshtë vijon:

- Kthyer përgjigje në email, ankuesit I.D., në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor që po zhvillohet pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, mbi ligjshmërinë e vendimit Nr. 154 datë 03.08.2023 të KMD-së.
- Kthyer përgjigje në email, ankueses R.M., në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor që përfundoi gjykimin pranë Gjykatës Administrative të Apelit, mbi ligjshmërinë e vendimit Nr. 162 datë 11.11.2019 të KMD-së.
- Kthyer përgjigje në email ankueses R.M., lidhur me kërkesën e saj në email, për t’u përfshirë si ndërhyrëse dytësore në rekurs.
- Kthyer përgjigje në email ankuesit A.D., në lidhje me kërkesën e tij për informacion mbi ecurinë e procesit gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Kthyer përgjigje në email ankuesit I.Th., mbi kërkesën e tij, për pjesëmarrjen fizikisht, të Komisionerit si palë e tretë të procesin gjyqësor që po zhvillohet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
- Kthim – përgjigje drejtuar ankuesit N.C., në lidhje me aktet e përcjella nga ana e tij pranë KMD-së, në vijim të procesit gjyqësor që pritet të gjykohet në Gjykatën Administrative të Apelit.
- Kthim përgjigje kërkesës, të z. M.P., dhe z. P.N., përmes së cilës kërkohej asistimi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në procesin gjyqësor që po zhvillohet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, me palë paditëse z. M.P., dhe z. P.N., me objekt “Shpërblim dëmi”.
- Kthim përgjigje kërkesës së znj. A.H., të parashtruar në email-in përmes të cilës kërkohet informacion në lidhje me ecurinë gjyqësore të ankesës Nr. 36 datë 15.04.2019 të depozituar pranë Komisionerit.
- Administruar kërkesa e z. Sh.Zh., (administruar me tonën me Nr. 12.12.2024), përmes të cilës kërkohet anullimi i Ligjit Nr. 82/2024 “Për policinë e shtetit” Referuar shënimit në kartelë, filloi hartimi i një memo, mbi mundësinë për dërgimin e një opinionit ligjor mbi situatën e referuar.
- Kthyer përgjigje në email ankuesit P.S., në lidhje me cështjen e ekzekutimit të vendimit të KMD-së, Nr. 128/2023, përmes të cilit iu bë me dije fakti i korrigjimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

9. Ndërgjegjësimi

Rritja e ndërgjegjëimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD-së, parashikuar nëpërmjet një serë kompetencash për këtë qëllim, si: nxitja e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për këto çështje, përfshirë edhe ofrimin e informacioneve të shkruara për këtë ligj, në gjuhën shqipe, në gjuhët e pakicave, si dhe në formate të përdorshme nga persona me aftësi të kufizuara; adresimi drejtpërdrejt opinionit publik për çfarëdolloj çështjeje që lidhet me diskriminimin; informimi për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe për mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje; zhvillimi i dialogut të rregullt për çështjet e diskriminimit me grupet përkatëse sociale, duke përfshirë organizatat joqeveritare dhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukuese që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji.

Gjatë vitit 2024 KMD ka bashkëpunuar me median si burim i mundshëm informacioni, për promovimin e luftës kundër diskriminimit, për të luftuar dhe parandaluar gjuhën e urrejtjes, gjuhën diskriminuese, homofobinë, ksenofobinë, racizmin etj, në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me daljet në media vizuale dhe e shkruar si më poshtme:

Janar – RTSH Tv

Shkurt – Euronews Albania, RTSH Tv, Star Plus Tv

Mars – Zëri i Amerikës, Top Channel, RTV Ora, MCN Tv, A2CNN

Prill - Top Channel, Revista Monitor, Euronews Albania, MCN Tv, InfoWeb

Maj – RTSH Tv, Euronews Tv

Qershor - RTSH Tv

Gusht - Zëri i Amerikës

Shtator – RTSH Tv, MCN Tv

Dhjetor - RTSH24 Tv

Në total 21 raportime në media për promovimin e luftës kundër diskriminimit dhe të drejtave të njeriut.

Organizimi, pjesëmarrja në Aktivitete dhe Media

Gjatë vitit 2024, Komisioneri dhe Zyra kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme si takime, seminare, trajnime, tryeza diskutimi, grupe pune, workshop, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me institucione shtetërore apo organizata, kombëtare apo ndërkombëtare, që mbrojnë të drejtat e njeriut.

Shkurt

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në tryezën "Posta Shqiptare e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara", me pjesëmarrës nga organizata të shoqërisë civile dhe institucione publike.
- Komisioneri Gajda mori pjesë në tryezën e organizuar nga Shoqata Together for Life. Në fjalën e tij, Komisioneri Gajda i'u bashkua shqetësimit të përbashkët se fenomeni i ngacmimit seksual në vendin e punës është jo vetëm gjerësisht i përhapur në vendin tonë,

por se nevojitet ndërhyrje urgjente për adresimin e tij, nëpërmjet amendimit të legjislacionit me fokus ashpërsimin e dënimeve për ngacmuesit dhe ofrimin e mbrojtjes për viktimat.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda nënshkroi me znj. Françeska Muço, Drejtore Ekzekutive e Rrjetit të Profesionistëve të Rinj, një Marrëveshje Bashkëpunimi në dobi të veprimtarisë së përbashkët për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë, veçanërisht në mbështetje të profesionistëve në fushat e tyre.
- Java Kundër Diskriminimit - Komisioneri Gajda ishte në Pogradec, pranë shoqatës "Unë gruaja". Ky aktivitet zhvillohet në bashkëpunim me projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillin e Evropës "Fuqizimi i mbrojtjes nga Diskriminimi në Shqipëri" me mbështetjen e programit të Instrumentit Horizontal III i cili mbështet organizimin në Shqipëri të "Javës kundër Diskriminimit 2024", synimi i të cilës është të rrisë ndërgjegjësimin të forcojë bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Java Kundër Diskriminimit - Komisioneri Gajda ishte në shkollën "Naim Frasheri", për të biseduar për Segregimin së bashku me institucione, mësues, prind, nxënës mbi zbatimin e planit të veprimit dhe masave për desegregimin e saj.
- Java Kundër Diskriminimit - Komisioneri Gajda ishte në shkollën "Oso Kuka" në Shkodër për të biseduar për gjuhën e urrejtjes online dhe rrjete sociale, synimi i të cilës është parandalimi i viktimizimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe diskriminimi i fëmijëve në kontakt/konflikt me ligjin.
- Java Kundër Diskriminimit - Komisioneri ishte vizitë në Qendrën e Zhvillimit Ditor, në Lezhë. Një realitet i pamohueshëm në shërbim të komuniteteve. Ky aktivitet zhvillohet në bashkëpunim me projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillin e Evropës "Fuqizimi i mbrojtjes nga Diskriminimi në Shqipëri", synimi i të cilës është të rrisë ndërgjegjësimin të forcojë bashkëpunimin e aktorëve të ndryshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Java Kundër Diskriminimit - Komisioneri Gajda ishte në shkollën "Janaq Kilica" në Fier për të biseduar mbi "Bullizmin, Gjuhën e urrejtjes dhe Diskriminimin në shkollë" së bashku me institucione, mësues, prind, nxënës mbi zbatimin e planit të veprimit dhe masave për desegregimin e saj.

Mars

- Në kuadër të "Javës Kundër Diskriminimit" dhe Ditës botërore të Diskriminimit Zero - Komisioneri Gajda mbajti një Ligjëratë publike në Universitetin "Eqerem Çabej" në Gjirokastrë. Ky aktivitet zhvillohet në bashkëpunim me projektin e përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillin e Evropës "Fuqizimi i mbrojtjes nga Diskriminimi në Shqipëri" me mbështetjen e programit të Instrumentit Horizontal III i cili mbështet organizimin në Shqipëri të "Javës kundër Diskriminimit 2024".
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në ceremoninë e mbylljes së Ekspozitës me piktura të fëmijëve të spektrit Autik, në ambientet e KMD, e cila qëndroi e hapur për publikun gjatë Javës kundër Diskriminimit. Ekspozita ishte e organizuar nga Klubi Kombëtar i Prindërve të Fëmijëve me Çrregullime të Spektrit Autik & P.A.K - të drejtuar nga Znj. Eglantina Bajrami. Slogani i Ekspozitës për këtë vit ishte: "Talenti nuk njih barrierë".
- Komisioneri Robert Gajda priti përfaqësuesit e Rrjetit Shqiptar të Zhvillimit Rural (ANRD), me të cilët diskutoi mbi stereotipet dhe pabarazitë gjinore me të cilat përballen gratë dhe

vajzat në komunitetet rurale. Komisioneri dhe ANRD riafirmuan angazhimin për të punuar së bashku në ndërgjegjësimin dhe zbutjen e stereotipeve dhe pabarazive gjinore, duke e cilësuar këtë si një prioritet të përbashkët. Eliminimi i këtyre barrierave është thelbësor për fuqizimin social dhe ekonomik të grave dhe vajzave në zhvillimin bujqësor dhe rural. Po ashtu, ai është i domosdoshëm për të nxitur përfshirjen e tyre aktive në ekonomi dhe në jetën komunitare.

- Zyra e Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në dëgjuesën e organizuar nga IDM Albania mbi problematikat sociale që prekin zonat më pak të zhvilluara dhe periferike në Shqipëri. Përfaqësues të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe grupeve të ndryshme të interesit kryesisht nga zonat e Malësisë së Madhe, Kukësit dhe Dibrës ndanë shqetësimet e tyre mbi zhvillimin social dhe ekonomik të këtyre zonave si migrimi i të rinjve dhe shpopullimi, mungesa e planeve dhe politikave të zhvillimit të zonave rurale dhe malore; sfidat e grave rurale në aksesin në skemën e kontributeve shoqërore dhe çështje të trashëgimisë së pronësisë; mungesa e shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve të tjera mbështetëse për banorët në zonat rurale dhe problematika të zbatimit të arsimit gjithëpërfshirës, duke përfshirë klasat kolektive, cilësinë e dobët të mësimdhënies, etj.

· Prill

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me drejtuesen e Qendrës AMAD, bashkëbisedoi me nxënësit e gjimnazit të Rrëshenit mbi luftën ndaj Diskriminimit dhe promovimin e barazisë.
- Komisioneri Gajda priti në institucion Ambasadorin e Delegacionit të Bashkimit European në Shqipëri, z.Silvio Gonzato. Komisioneri e informoi ambasadorin për veprimtarinë e institucionit të KMD në luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë. Nga ana e tij, Ambasadori shprehu përkushtimin e BE-së për të mbështetur proceset reformuese dhe për të ndihmuar në përmirësimin e qeverisjes së mirë dhe të respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri.
- Në kuadër të javës Rome, u zhvillua një takim mbi ecurinë e “Deklaratës së Poznanit” në Shqipëri, lidhur me mundësitë dhe përfshirjen e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në sektorin publik, si edhe të drejtat e tjera sociale dhe ekonomike që parashikon kjo deklaratë.

Maj

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në institucion nxënësit e "Shkollës së kuqe" - Tiranë, së bashku me stafin pedagogjik dhe prindërit. Komisioneri informoi për veprimtarinë e KMD dhe angazhimin e përditshëm për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë, si dhe i'u përgjigj pyetjeve të nxënësve.
- Komisioneri Gajda priti në institucion studentë të Fakultetit Juridik, pranë Universitetit “Mesdhetar” me të cilët mbajti një leksion të hapur mbi Çështje të të Drejtave të Njeriut dhe luftën ndaj diskriminimit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në seminarin "Standardet për organet e barazisë dhe forcimin e organeve të barazisë përtej BE-së", po hedh një dritë mbi sfidat në nivel kombëtar, përmirësimet e nevojshme legislative dhe praktikatat e mira nga anëtarët tanë përtej BE-së, të organizuar nga Equinet dhe anëtarët e tij jo-kandidatë në BE, në Tiranë me mbështetjen e TAIEK.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në “Europe House”, së bashku me Lëvizjen Europiane në Shqipëri dhe Pro-LGBTI. Panelistët, përfshirë Komisionerin Gajda, kërkuan ndryshimin e ligjit, zbatimin efektiv të politikave dhe mjeteve ekzistuese kundër diskriminimit dhe promovimin e përfshirjes aktive të komunitetit për të nxitur një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe të drejtë ndërsa vendi përparon drejt integritetit evropian.
- Komisioneri Gajda mori pjesë në tryezën e Rrumbullakët me temë "Koncepti i Komunikimit të Aksesueshëm" - organizuar nga Caritas Shqiptar. Në esencë, komunikimi i aksesueshëm synon të sigurojë që të gjithë audiencat të kenë mundësi të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të kuptojnë mesazhin, duke respektuar dhe adresuar nevojat e tyre të veçanta.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim në institucion me Ambasadorin e Kanadasë në Shqipëri, znj. Elissa Golberg, me të cilën bisedoi për veprimtarinë e KMD në luftën kundër Diskriminimit dhe promovimin e barazisë në vend.
- Komisioneri Gajda mori pjesë në Festivalin Kombëtar të rrethit Drejtave Dixhitale, e cila mbledhi së bashku 15 ambasadorë të rinj të drejtave dixhitale dhe sigurisë kibernetike në Tiranë për të diskutuar me përfaqësues të lartë të institucioneve të pavarura të ngarkuara me mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Aktiviteti i organizuar nga CPDC, IDM dhe CRPM. Aktiviteti është organizuar nga Qendra Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim – SCiDEV.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi Robert Gajda mori pjesë në aktivitetin “Të drejtat e personave LGBTI dhe aksesimi në shërbime”, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Qershor

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim informues me punonjës të Bankës së nivelit të dytë 'Credins', mbi shkaqet dhe mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe promovimin e të drejtave të Njeriut. Komisioneri informoi punonjësit e sektorit privat mbi veprimtarinë e institucionit, të gjitha hapat e ndjekjes së ankesave dhe trajtimit të tyre në disa faza, si dhe njohuri mbi Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky takim u zhvillua në bashkëpunim me UNFPA.
- Komisioneri Gajda mori pjesë në takimin me AWEN-Albanian Women Empowerment Network dhe FSHDPAK ADRF, si pjesë e programit "Fuqizimi i Shoqërisë Civile: Rritja e adaptueshmërisë së OSHC-ve dhe angazhimi publik për një demokraci të qëndrueshme", me mbështetjen financiare të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun të U.S. Embassy-Tirana.
- Zyra e Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në takim një grup aktivistësh të programit “shkëndija” të Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, i mbështetur nga Ambasada Amerikane në Tiranë. Gjatë vizitës, pjesëmarrësit patën mundësinë të njihen nga afër me rolin dhe funksionet e KMD. Kjo vizitë ishte një mundësi e shkëlqyer për aktivistët e programit që të kuptojnë më mirë funksionimin praktik të institucioneve dhe të marrin njohuri të dobishme për përparimin e nismave të tyre komunitare.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim përfaqësues të “Programi Shkëmbimit të OJFve”. Garantimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut ishin në fokus të takimeve me AWEN-Albanian Women Empowerment Network, FSHDPAK ADRF dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm në luftën kundër diskriminimit.

Korrik

- Përfaqësuesi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim në ambientet e institucionit drejtuesin e shoqatës Amarodrom z. Franko Velu dhe përfaqësuesen e Caritas Shqiptar znj. Martine Prenga. Qëllimi i takimit ishte vendosja e urave të bashkëpunimit mes Caritas shqiptar dhe Amarodrom në kuadër të projektit "Your job", projekt i Caritas shqiptar që synon fuqizimin e të rinjve që vijnë nga grupe vulnerabël përmes punësimit, inershipeve dhe arsimimit profesional.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim ekspertin e pavarur të OKB-së për mbrojtjen ndaj dhunës dhe diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, z. Graeme Reid. Komisioneri e informoi z. Reid për veprimtarinë e institucionit të KMD në luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë. Nga ana tjetër, Z. Reid po zhvillon një mision fakt-mbledhës për të identifikuar sfidat dhe progresin e Shqipërisë në mbrojtjen ndaj diskriminimit në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor.
- Komisioneri Gajda nënshkroi me Drejtorin Ekzekutiv të shoqatës "Komuniteti Malazez në Shqipëri" një Marrëveshje Bashkëpunimi në dobi të veprimtarisë së përbashkët për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë, veçanërisht në mbështetje të komuniteteve në vend.

Gusht

- Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me organizatën "Terre des hommes", zhvilloi një trajnim 2-ditor, me temë "Parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit (VT/VMT) dhe identifikimi i tyre përgjatë sistemit të referimit". Trajnimi ka në fokus profesionistët që janë në kontakt me VT/VMT dhe luajnë rol parësor për mbrojtjen, identifikimin dhe referimin e tyre sipas standareteve dhe procedurave në fuqi.

Shtator

- Përfaqësuesi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë si ekspert në seancat e trajnimit të organizuar nga ADRF në Tiranë, në Shkodër dhe Elbasan. Trajnimi kishte për qëllim rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të institucioneve publike në nivel vendor që operojnë në fushën e shërbimeve shoqërore, arsimit dhe punësimit, për të luftuar diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara në këto fusha kyçe.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në një takim në institucion një delegacion nga Republika e Serbisë, përfaqësuar nga znj. Tatjana Macura, Ministre pa portofol përgjegjëse për barazinë gjinore, parandalimin e dhunës ndaj grave dhe fuqizimin ekonomik dhe politik të grave.
- Komisioni Gajda mori pjesë në takimin e komitetit drejtues për "Veprim për të përparuar luftën ndaj Diskriminimit në vend". Së bashku me Delegacionin e BE në Tiranë dhe organizatat e shoqërisë civile të përfshira.

Tetor

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në institucion një përfaqësi të organizatave të rrjetit P.A.K. Gjatë takimit u koordinuan edhe aktivitetet e ardhshme me tematikë dhunën ndaj PAK, si dhe u diskutua për marshimin në ditën ndërkombëtare të Shkopit të Bardhë.

- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në aktivitetin e organizua nga Shërbimi Psiko-Social i shkollës në bashkëpunim me organizatën AMAD dhe me pjesëmarrjen e prindërve, nxënësve dhe mësuesve, ku u fol për shëndetin mendor si element thelbësor në shëndetin tonë të përgjithshëm.
- Komisioneri Gajda mori pjesë në takimin e ISP - Instituti i Studimeve Politike, mbi ndryshimet e reja ligjore miratuan aplikimin e votës së diasporës për shtetasit shqiptarë në botë dhe personat me aftësi të kufizuara, ata në regjime spitalore etj, ndonëse gëzojnë të drejtën kushtetuese, nuk kanë mundësi praktike të votojnë. Për të diskutuar këto problematika dhe ofruar zgjidhjet u mblodhëm në një tryezë faktorët kryesorë institucionalë dhe politikë, institucionet e pavarura dhe partitë, shoqatat dhe grupet e interesit, ekspertët dhe diplomatët perëndimorë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi priti në institucion përfaqësuesit e disa organizatave të shoqërisë civile për të biseduar mbi thellimin e bashkëpunimit për ndërveprim të përbashkët në luftimin e Diskriminimit dhe promovimin e barazisë.
- Komisioneri Gajda priti në institucion Ambasadoren Znj. Michèle Taylor, Përfaqësuese e Përhershme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Këshillin e OKB-së për të Drejtat e Njeriut.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zhvilloi një takim me Drejtorin e Qendrës së Pritjes për Azilkërkues QPA Z. Ermir Aliçka dhe Znj. Mariana Hereni drejtore ekzekutive e organizatës “Shërbimet Shqiptare për Refugjatë dhe Migrantë” RMSA, si organizata e vetme që ofron shërbime të plota për kategoritë e refugjatëve, azilkërkues, migrant etj. Qëllimi i këtij takimi ishte realizimi i një sesi informimi me azilkërkuesit, refugjatet dhe migrant të tjerë që ndodhen në Qendër dhe jashtë saj, në lidhje me të drejtat e tyre dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Nëntor

- Një takim informues mes stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe UNDP Albania mbi terminologjinë LGBTIQ+ dhe përdorimin e gjuhës përfshirëse – hapa të rëndësishëm për të garantuar një shoqëri ku çdo zë respektohet dhe të drejtat e njeriut mbrohen. Ky takim është pjesë e një sërë takimesh me institucionet e të drejtave të njeriut, sistemin gjyqësor dhe sektorin privat, në kuadër të fushatës United Nations Free & Equal, të financuar nga Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut dhe të zbatuar nga UNDP.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me Përfaqësuesen e Këshillit të Evropës znj.Iva Çoku dhe znj. Antuen Skënderi zhvilluan një takim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Elbasan të drejtuar nga z. Altin Ago. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për një sërë kategorish të mbrojtja me ligj, si P.A.K, të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor, gratë e burgosura, shtetas të huaj, minoritete, etj.
- Komisioneri Gajda mori pjesë në Forumin e Hapur, “Forcimi i të Drejtave të Minoriteteve Kombëtare në Shqipëri: Lidhja e Kornizave Ligjore të Brendshme me Angazhimet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut” - organizuar nga Universiteti EPOKA, AADF dhe Institutit të Arsimit Ndërkombëtar.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me Prezencën e OSBE në Shqipëri vizituan qytetin e Peshkopisë në takimin mes institucioneve kombëtare të të drejtave të

njeriut dhe përfaqësuesve vendorë e organizatave të shoqërisë civile në bashkinë e Dibrës. Komisioneri Gajda foli për rolin e institucionit dhe i nxiti pjesëmarrësit për më shumë bashkëpunim, për të zhvilluar strategji të përbashkëta dhe për të krijuar një rrjet funksional.

- Komisioneri Gajda mori pjesë në tryezën për rritjen e dialogut mes institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe përfaqësuesve të bashkisë e të shoqërisë civile, organizuar nga OSCE Presence in Albania në Tropojë.

Dhjetor

- Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi së bashku me AMAD, organizata të tjera të shoqërisë civile, mësues, studentë, prindër dhe juristë, prezantuan gjetjet e Raportit Kombëtar mbi Diskursin Diskriminues dhe Urrejtës në Platformat Online.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi organizoi një takim me organizatat e shoqërisë civile në vend. Në takim u realizua dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së bashkëpunimit me “Caritas Albania”, me drejtuese znj. Juliana Reso.
- Komisioneri Gajda priti në institucion nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Qamil Guranjaku” (Klasa V), Elbasan, me të cilën bisedoi rreth të drejtave të fëmijëve dhe rolin e Komisionerit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Forcimi i dialogut mes institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, përfaqësuesve të pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile ishte qëllimi i një sërë tryezash që Prezenca e OSBE-së në Shqipëri organizoi së bashku me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Tryezat u zhvilluan në Peshkopi, Tropojë, Kuçovë dhe Roskovec. Takimet u përqendruan në promovimin e strategjive të përbashkëta kundër diskriminimit dhe në mbrojtje të të drejtave të njeriut. Po ashtu, ato shërbyen si platforma për krijimin e një rrjeti funksional mes pjesëmarrësve dhe diskutimin e veprimtarive të përbashkëta gjatë vitit 2025.
- Përfaqësuesi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në konferencën për teknologjinë dhe aftësinë e kufizuar "A step", në Antwerp, Belgjikë.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në një pritje në kuadër të miratimit të ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili parashikohet të hyjë në fuqi në vitin 2025. Në këtë takim morën pjesë Ministri i Drejtësisë, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Kryetari i Komisionit për Sigurinë Kombëtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Avokatja e Popullit, përfaqësues nga Kuvendi, Ministria e Drejtësisë, ekspertë dhe bashkëpunëtorë.

10. Veprimtaria monitoruese e KMD

Raportime të KMD

- Përcjellë kontributi⁵⁷ i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me shkresën me objekt “Kërkesë për informacion në kuadër të hartimit të Raportit të Shqipërisë mbi zhdukjet e detyruara”, të komunikuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me shkresën “Kërkesë për informacion në funksion të hartimit të përgjigjeve për Listën e Çështjeve

⁵⁷ Shkresë Nr. 4/1 Prot., datë 20.02.2024 e KMD-së.

në Komitetin Ekonomik dhe Social (CESCR)”, të komunikuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

- Përcjellë kontributi⁵⁸ i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me shkresën “Kërkohet kontribut lidhur me raportin mbi mbrojtjen ndaj dhunës dhe diskriminimit, të ekspertit të pavarur të OKB-së” (SOGI) të komunikuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë kontributi⁵⁹ i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me Planin e Veprimit për vitin 2023, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur.
- Përcjellë kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me shkresën “Mbi shqyrtimin e Raportit për Shqipërinë në CERD dhe kërkesë për kontribut”, të komunikuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë në email kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me Indikatorët që shërbejnë për sistemin ROMALB, një platformë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Përcjellë kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me shkresën me objekt “Kërkesë për kontribut lidhur me fjalët që do të mbahen gjatë KDNJ55”, e MPJ.
- Përcjellë kontributi⁶⁰ i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, lidhur me shkresën me objekt “Kërkesë për informacion në funksion të hartimit të Raportit të Shqipërisë mbi zhdukjet e detyruara”, përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore.
- Përcjellë kontributi në lidhje me Shkresën “Kërkohet informacion për përgatitjen e Raportit kombëtar mbi zbatimin e Deklaratës dhe Platformës për Veprim Pekin +30”, të komunikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Përcjellë kontributi, në lidhje me shkresën “Kërkesë për informacion mbi zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBT 2021 – 2027”, komunikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Përcjellë kontributi, në lidhje me shkresën me objekt “Përcillet kërkesa e Raportueses së Posaçme mbi format bashkëkohore të racizmit, diskriminimit racor, ksenofobisë dhe intolerancës për kontribut në hartimin e një raporti tematik”, të përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë kontributi, në lidhje me shkresën “Vijim i tonës Nr. 1208 datë 25.01.2024, përcillet listë çështjesh nga Komiteti CERD”, përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë kontributi në lidhje me shkresën “Kërkesë për informacion në funksion të hartimit të raportit periodik të Shqipërisë mbi të drejtat e punëtorëve migrantë”, të komunikuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Administruar email-et përmes të cilit kërkohet shpjegim mbi zbatueshmërinë e rekomandimeve të përcjella Kuvendit. Gjithashtu u përmbledh info shtesë e kërkuar në lidhje me vendimet gjyqësore që kanë lënë në fuqi vendimet e diskriminimit të KMD-së, ato që kanë rrëzuar vendimet e mosdiskriminimit të KMD-së, dhe vendimet që kanë pranuar dëmshpërblimin për vitin 2023 dhe 2024.

⁵⁸ Shkresë Nr. 68/1 Prot., datë 30.01.2024 e KMD-së.

⁵⁹ Shkresë Nr. 174 Prot., datë 30.01.2024 e KMD-së.

⁶⁰ Shkresë Nr. 4/1 Prot., datë 20.02.2024 e KMD-së.

- Administruar email-i i përcjellë, në lidhje me kërkesën: Programme Manager – Governance, Delegation of the European Union to Albania për kontribut sipas pyetjeve përkatëse, në lidhje me të dhëna mbi “gjuhën e urrejtjes” dhe “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”.
- Përcjellë kontributi i VI-të kombëtar për Universal Periodic Report në kuadër të OKB-së për periudhën 2019-2024.
- Përcjellë informacion i KMD-së lidhur me pyetjet e kërkuara nga KE mbi Raportin e Shtetit të së Drejtës (Rule of Law Report).
- Përcjellë kontributi i KMD-së, në lidhje me shkresën *“Përcillet kërkesa e OHCHR-së për kontribute në hartimin e një raporti mbi mbrojtjen ndaj dhunës dhe diskriminimit mbi bazën e orientimit seksual”*, përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë në email masat e rekomanduara për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit CEDAW për Shqipërinë si dhe komente për masat që janë zbatuar nga ana jonë në kuadër të zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas email-it të MSHMS.
- Përcjellë në email kontributi i KMD-së në lidhje me draftin e planit të punës për Ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Përmbledhur baza ligjore e Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe rekomandimet e KMD-së në lidhje me Ligjin “Për barazinë gjinore”, sipas email-it nga MSHMS.
- Përcjellë në email, informacion lidhur me rekomandimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën Janar - Dhjetor 2024, drejtuar ekzekutivit dhe agjencive në varësi si dhe statusin e zbatimit të tyre.
- Përcjellë me Shkresën, informacion në lidhje me vendimet e KMD-së dhe vendimet gjyqësore, me shkak “bindjet politike”, për periudhën 2019 – 2024, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë.
- Kthyer përgjigje në lidhje me shkresën Nr. 2992/1 Prot., datë 10.05.2024 *“Dërgohet për mendim një projekturdhër ndërinstitucional “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional për hartimin e tre akteve nënligjore në bazë dhe për zbatim të Ligjit Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*, përcjellë nga Ministria e Brendshme.
- Në vijim të hartimit të Udhërrëfyesit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, hartuar një përmbledhje informacioni mbi rastet e diskriminimit në formën e “shqetësimit seksual”, që disponon Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Plotësuar pyetësi i përcjellë nga MSHMS, në lidhje me detyrimet institucionale strategjike dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, në kuadër të hartimit të draft projektligjit për “Barazinë Gjinore”.
- Përcjellë kontributi në lidhje me shkresën, dërguar nga Ministria Për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku kërkohet informacion për Konventën Nr. 190 “Dhuna dhe Ngacmimi në Punë”.
- Përcjellë kontributi në lidhje me shkresën me objekt *“Përcillet për komente Projekt-plani i Veprimtë për fazën e pestë (2025 – 2029) të Programit botëror për edukimin mbi të drejtat e njeriut”*, përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me Vizitën në Shqipëri nga Eksperti i Pavarur i OKB-së për SOGI.
- Përcjellë në email komentet e KMD-së, në lidhje me Draft Rezolutën *“Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2023”*.
- Dërguar mendim lidhur me studimin: *“Vlerësimi i Profilit Gjinor: Bujqësia dhe Jeta në Zonat Rurale”*.

- Përcjellë me shkresë, kontributi i KMD-së, në lidhje me shkresën Nr. *“Përcillet për kontribut pyetësori i Grupit të Punës për çështjen e të drejtave të njeriut, korporatat transnacionale dhe sipërmarrje të tjera të biznesit”*, përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Përcjellë me shkresë kontributi i KMD-së, në lidhje me shkresën *“Dërgohet për bashkërendim një projektvendim”*, përcjellë nga Ministria e Brendshme, përmes së cilës kërkohej bashkërendimi me Projekt-vendimin *“Për një ndryshim në vendimin Nr. 1140 datë 24.12.2020 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021 – 2025 dhe Planin e Veprimit 2023 – 2025”, i ndryshuar”*.
- Përcjellë me shkresë, kthim përgjigje e Komisionerit lidhur me Shkresën *“Kërkohet mendim për një projektligj”*, përcjellë nga Ministria e Brendshme, përmes të cilës kërkohet bashkërendim i projektligjit *“Për policinë e shtetit”* me rekomandimet e bëra më herët nga KMD.
- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me shkresën *“Mbi shqyrtimin e raportit për Shqipërinë në CEECR dhe kërkesë për kontribut”*, përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
- Plotësuar dhe dërguar me e-mail, Pyetësor nga eksperti i Këshillit të Evropës për institucionet e barazisë, lidhur me kuadrin ligjor e politik në Shqipëri për krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes. (*Feedback needed on Pre-assessment questionnaire/1-2 July/SXB*)
- Përcjellë kontributi i KMD-së në përgjigje të shkresës së Ministrisë së Ekonomisë me lëndë *“Për zbatimin e Konventes ILO Nr. 190 “Dhuna dhe ngacmimi në punë”*.
- Kthim përgjigje në lidhje me Shkresën *“Dërgohet për bashkërendim një projektvendim i Këshillit të Ministrave”*, përcjellë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përmes së cilës kërkohej bashkërendimi me projektvendimin e Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale 2024 – 2028”* sipas rekomandimeve të përcjella.
- Përcjellë në email kontributi i KMD-së, i plotësuar sipas orientimit të eprorit, në lidhje me email-in e administruar nga CDADI, ku kërkohej plotësimi i pyetësorit në lidhje me diskriminimin ndërsektorial dhe të shumëfishtë.
- Dërguar komente lidhur me Draft-in final të Shqipërisë lidhur me Raportimin Universal Periodik Review, të përgatitur pas kontributeve të institucioneve shqiptare për periudhën 4-vjecare.
- Përcjellë kontributi i KMD-së për periudhën janar – qershor 2024, në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030, të planit të saj të veprimit dhe të pasaportës së treguesve”*.
- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022-2024, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave *“Për Miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të saj të Veprimit 2022 - 2026”*.
- Administruar emaili i përcjellë nga Ministria e Shëndetësisë, në lidhje me hartimin e planit të masave për zbatimin e Rekomandimeve të Komitetit të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (CRC).
- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me draftin e projektligjit *“Për barazinë gjinore”*, sipas kërkesës në email të MSHMS.

- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me kërkesën e përcjellë nga Departamenti Amerikan i Shtetit, përmes të cilit kërkohet kontribut në lidhje me Raportin Vjetor të të drejtave të njeriut për vitin 2024.
- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me Raportin e IV-të periodik të Shqipërisë në CESCR, në zbatim të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, sipas së kërkesës në email të UN Albania.
- Administruar email i DASH, në lidhje me raportimin për lirinë e besimit. Përcjellë kontributi i KMD-së.
- Administruar email përmes të cilit kërkohet plotësimi i formularit në kuadër të projektit *“Qasje gjithëpërfshirëse për të garantuar akses të barabartë në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara në Shqipëri”*, financuar nga Bashkimi Evropian dhe po zbatohet nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), së bashku me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD) dhe Fondacionin Down Syndrome Albania (DSA).
- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me kërkesën e OHCHR-se lidhur me dhënien e kontributit për një raport mbi punën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në zonat rurale dhe të largëta.
- Përcjellë kontributi i KMD-së mbi pyetësorin e Raportit të ILO-s mbi *“Rekomandimin për Punësim dhe Punën e Denjë për Paqe dhe Qëndrueshmëri Nr. 205”*.
- Përcjellë opinione në lidhje me draftin e Projekt-Ligjit “Për buxhetin e shtetit, për vitin 2025”.
- Përcjellë kontributi i KMD-së në lidhje me Shkresën të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, me objekt *“Përcillet kërkesa e OHCHR-së për kontribut lidhur me një raport mbi luftën kundër diskriminimit, dhunës dhe praktikave të dëmshme ndaj personave interseksualë”*.
- Përcjellë kontributi i KMD-së sipas Shkresës *“Përcillet për kontribut kërkesa e OHCHR-së lidhur me dhënien e kontributit për raportin e KDNJ 60 mbi luftën kundër dhunës dhe diskriminimit të personave inetrsex”*, ardhur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Pjesëmarrja në grupe pune ndërinstytucionale.

GNPIE Kapitulli 2, 19 dhe 23

KMD ka dy anëtare në Grupin Ndërinstitucional të Punës, në kuadër të kapitullit “Kriteri Politik” dhe Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, për të cilin institucion lider është Ministria e Drejtësisë, si dhe në kuadër të Kapitullit 2 & 19 *“Punësimi dhe Politikat Sociale”*, për të cilin institucion lider është Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Kontributi i KMD:

- Përcjellë në email dhe shkresërisht pyetësori i vlerësimit lidhur me kapacitetet dhe strukturat për integrimin evropian në lidhje me Raportin e Progresit për Kapitullin 2, 19 dhe 23.
- Punuar tabelat e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës.
- Në vijim të email-it të administruar, sipas të cilit Zyra e Kryenegociatorit, kërkon një informacion periodik, teknik dhe konciz mbi monitorimin e prioritetëve të dokumentit bazë të punës për Integrimin Evropian, PKIE 2024-2026 për Kapitullin 2 “Lëvizja e Lirë e Punetorëve”, sipas materialit të strukturuar “Paketa Metodologjike e Kapaciteteve, PSIE

- 2024, u përgatit kontributi i KMD-së duke iu referuar masës administrative të planifikuara në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian, për vitin 2024, për Kapitullin II, që lidhet me *“Ofrimin e informacionit të dedikuar on-line për punëtorët e BE dhe anëtarët e familjes së tyre për punësimin dhe qëndrimin për motive pune në territorin e Republikës së Shqipërisë”*.
- Përcjellë në email kontributi KMD-së në lidhje me Raportin e Progresit për Kapitullin 2, i pari për vitin 2024.
 - Përcjellë në email tabela e përditësuar me listën e antarëve të GNPIE, Kapitulli II, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”, me emrat e përfaqësuesve të KMD-së, sipas email-it.
 - Përcjellë me email informacioni/kontributi i KMD si institucion përgjegjës për raportim në kuadër të Nënkomitetit *“Drejtësia, Liria dhe Siguria”*.
 - Kthim përgjigje email-it të MSHMS mbi Folloë up të angazhimeve në kuadër të proceseve të IE – Kapitulli 19 “Politikat sociale dhe punësimi”.
 - Lidhur me kërkesën për informacion nga MSHMS, janë dërguar me email të dhënat e KMD-së lidhur me Kapitullin 19 “Politikat sociale dhe punësimi” sa i takon paketës semestrale raportimi i dytë i tremujorit.
 - Kthim përgjigje email-it të MSHMS mbi Raportimin 3 mujor *“Paketa Semestrale lidhur me Kapitullin 19”*.
 - Dërguar kontributi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mbi hartimin e Kontributit të I-rë të Progres Raportit, për periudhën Shtator - Dhjetor 2023 dhe Janar - Mars 2024, sa i përket kapitullit 19 *“Politikat sociale dhe punësimi”*.
 - Dërguar me e-mail informacioni i KMD për periudhën Janar-dhjetor 2024 për Kapitullin 23, në kuadër të PSIE (Paketës së Semestrit të Integritimit Evropian)
 - Pas kërkesës së MD, kthim përgjigje me e-mail, se pasi u konsultua përmbajtja e Raportit *Screening*, nuk rezultoi të ketë aspekte të fushëveprimit të KMD që të përkthehen në masa përpara kërkohet në kuadër të Udhërrëfyesit për Funksionimin e Institucioneve Demokratike. (Kap. 23)
 - Dërguar, në mënyrë elektronike, me e-mail, informacioni i KMD, në kuadër të Kontributit të parë për Raportin e Komisionit Evropian për vitin 2024, sa i përket Funksionimit të Institucioneve Demokratike.
 - Lidhur me kërkesën për informacion nga MSHMS për pozicionin negociues u përgatit një kontribut lidhur me rubrikën *“Situatë Aktuale”* në Template-n e përgatitur nga Ministria, sipas prezantimit në Takimin Bilateral.
 - Pas administrimit të email-it, përmes të cilit kërkohet hartimi dhe dërgimi i kontributit të dytë, për periudhën 24 prill – 01 shtator 2024, në kuadër të hartimit të Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2024, u hartua kontributi i KMD-së. (Kap. II)
 - Kthyer përgjigje email-it, në lidhje me pozicionin negociator, kapitulli II, për reflektimin e komenteve.
 - Dërguar përgjigje MSHMS mbi pjesëmarrjen aktive të institucioneve shqiptare në strukturat e BE-së, ku kërkohet dërgimi i një informacioni të detajuar mbi strukturat e Bashkimit Evropian ku aktualisht institucioni është pjesë, si dhe ato struktura të reja ku shprehim interes të jemi pjesë në kuadër të integritimit të përsheptuar, për Kapitullin 19 *“Politikat Sociale dhe Punësimi”*.
 - Dërgur me e-mail Kontributin e Dytë të KMD-se lidhur me Progres Raportin për Shqipërinë për periudhën prill-shtator 2024 sa i takon Kapitullit 19, *“Politikat Sociale dhe Punësimi”*.

- Derguar me e-mail komentet lidhur me draftin e pozicionit Negociues, Kapitulli 19 Politikat Sociale dhe Punesimi".
- Derguar me email, lidhur me *raportin screening* ku paraqitet sitata aktuale e progresit nga Shqiperia, nje koment te KMD-se lidhur me konstatimet e Komisionit Evropian lidhur me Kapitullin 19 "Politikat Sociale dhe Punesimi".
- Derguar MSHMS të dhenat per 3 mujorin e trete të paketës semestrale lidhur me K.19 "Politikat Sociale dhe punesimi".
- Derguar MSHMS ne kuader te K.19 Politikat Sociale dhe punesimi" komente lidhur me pyetjet e ekspertit lidhur me paketen semestrale.
- Pjesëmarrje në trajnimin për përdorimin e Platformës së Integritetit Evropian dhe Anëtarësimit (PIEA), për të gjithë anëtarët e GNPIE-së së Kapitullit 2, 19 dhe perfaqesuesit qe kontribuojnë per fushen e Kultures dhe AFP në Kapitullin 26.
- Administruar email nga GNPIE të Kapitullit 2. Në vijim të periudhës së Raportimit dhe Vlerësimit për semestrin IV (tetor-dhjetor 2024), kërkohet sipas emailit plotësimi i paketës me informacion mbi zhvillimet lidhur me secilën masë, statusi aktual i tyre për periudhën raportuese, progresi për secilën masë të planifikuar në Planifikim (PSIE) për vitin 2024. Kthyer përgjigje në email.
- Administruar email në vijim të punës në kuadër të procesit të integritetit nga zyra e Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatore përmes të cilit është kërkuar raportimi i 3 mujorit të katërt të Raportit të Kuvendit. Në këtë raport duhet të përfshihen arritjet për periudhën Tetor-Dhjetor 2024 si dhe referimit të adresimeve të Komisionit për kapitullin 2.
- Administruar email përmes të cilës kërkohet brenda datës 31.12.2024, përcjellja e masave administrative dhe/ose institucionale që do raportojmë për PSIE 2025, si dhe prioritetet institucionale për vitin 2025 në lidhje me PSIE 2025. Kthyer përgjigje në email.
- Administruar email, përmes të cilit kërkohet konfirmimi i të dhënave të përkthyer me qëllim dërgimin pranë zyrës së Kryenegociatorit. Kthyer përgjigje në email datë 30.12.2024.
- Takimi GNPIE-së, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për Kap. 23. Përditësimi i listës së anëtarëve, referuar kërkesës nga MD me shkresë, protokolluar me tonën me Nr. 1435 Prot, dt. 21.10.2024. Kthim përgjigje me shkresën Nr. 1435/1 Prot., dt. 24.10.2024.
- Pjesëmarrje ne mbledhjen on line ku u zhvillua takimi i GNP + Platformës së Partneritetit, per kapitullin 19 "Politikat Sociale dhe Punësimi".
- Administruar email i Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 2, sipas të cilit kërkohet mendimi/kontributi, nëpërmjet dërgimit të komenteve dhe plotësimeve të nevojshme për të përmirësuar dhe pasuruar më tej ToC (tabelat e përputhshmërisë). Përcjellë materiali me komentet.
- U shqyrtua kërkesa e MSHMS lidhur me ku është përcjellë njoftimi mbi iniciimin e hartimit të Planit Kombëtar për Integritetin Evropian për periudhën 2025 – 2027, (PKIE 2025 – 2027), kapitulli 19 . KMD nuk jep masa legjislative ne PKIE.
- U shqyrtua kërkesa e MSHMS lidhur me Pozicionin Negociues dhe u kthye pergjigje MShMS lidhur me komentin e ekspertit te Komisionit Evropian për nje aspekt te legjislacionit qe bie ne fusheveprimin e KMD, kapitulli 19.
- Përgatitur materialin per Kapitullin 19, lidhur me 3 mujorin e fundit paketa semestrale.
- Përditësim lidhur me masat e parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe PSIE, ku institucioni është përgjegjës.

KMD anëtar i EQUINET - Rrjetit European të Organeve të Barazisë

Equinet është Rrjeti European i Organeve të Barazisë, i cili promovon barazinë në Europë duke mbështetur organet e barazisë për të luftuar diskriminimin dhe për të promovuar barazi për të gjithë. Nëpërmjet Equinet, anëtarët e saj, institucione kombëtare barazie, sikundër është dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ndajnë dhe shkëmbejnë ekspertizën e tyre në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, në nivel evropian si dhe mësojnë nga sukseset e arritura dhe sfidat me të cilat përballen, gjatë zbatimit të mandatit të tyre në nivel kombëtar.

Objektiv kryesor i Rrjetit është mbledhja e informacionit dhe krijimi i njohurive të reja mbi barazinë dhe mosdiskriminimin që para së gjithash mund të ndihmojnë anëtarët të përmirësojnë më tej praktikën e tyre në nivel kombëtar. Kjo njohuri vjen nga vetë anëtarët dhe përvoja e zbatimit të mandatit të tyre në nivel kombëtar.

Çdo vit, organizohet Mbledhja e Përgjithshme Vjetore (AGM) e Equinet për të diskutuar dhe marrë vendime për çështje të rëndësishme si dokumentet strategjik, raportet e aktiviteteve, aderimi i anëtarëve të rinj etj.

Strukturat e Equinet, të cilave u është deleguar menaxhimi i përgjithshëm i aktiviteteve, janë Bordi Ekzekutiv dhe Sekretariati i Equinet. Bordi Ekzekutiv është organi menaxherial i rrjetit dhe konkretisht është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe udhëheqjen strategjike të Equinet. Bordi Ekzekutiv përbëhet nga nëntë përfaqësues të anëtarëve të Equinet të zgjedhur për një mandat dy vjeçar nga Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve dhe kryesohet nga një Kryetar. Ai punon për të mbështetur punën e anëtarëve të Equinet dhe pozicionimin e tyre në nivel evropian dhe është përgjegjës për mbikëqyrjen e zhvillimit dhe zbatimit të planeve të punës. Ai gjithashtu synon zhvillimin e vizioneve strategjike për të garantuar fuqinë, rritjen dhe qëndrueshmërinë e Rrjetit. Ai gjithashtu mbikëqyr punën e Sekretariatit të Equinet, i cili është përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara ndërmjet anëtarëve, duke kontribuar në rëndësinë unike të përvojës së organeve kombëtare të barazisë.

Gjatë vitit 2024, stafi i KMD është përfshirë në grupet e punës së Equinet, duke vlerësuar pjesëmarrjen si në aspektin e rritjes së kapaciteteve profesionale ashtu edhe në shkëmbimime të praktikave ndërmjet organeve të barazisë në vende të ndryshme të Evropës, konkretisht në:

- Plotësuar pyetësin TPI lidhur me kërkesën e EQUINET për çështjet e segregimit.
- Komunikime në kuadër të TAIEK, me KE dhe Equinet.
- Komunikime me personin përgjegjës të Equinet lidhur me përditësimin e të dhënave për Equality Bodies Directory Data Update.
- Dërgimi i parashikimeve ligjore Ombusmanit të Letonisë lidhur me kërkesën e Equinet për “Sexual Harasment” në legjislacionin shqiptar.
- Me kërkesë nga Equinet, plotësuar Formulari “On needs assessment in this strategic policy area on the intersection between climate and equality”.
- Plotësimi i Pyetësit online, ardhur me kërkesë të Equinet, për informacion, në kuadër të paketës së zgjerimit 2024 të BE, nga vetë Insitucionet e Barazisë së vendeve kandidate me qëllim hartimin e Raporteve, në të cilat një aspekt i përket dhe sferës së barazisë.
- Kthim përgjigje, me e-mail, lidhur me konfirmimin e informacionit të KMD në Broshurë informuese mbi shkaqet e diskriminimit në fushën e punësimit dhe përtej.

- Dërguar, me e-mail, Formulari i plotësuar i Equinet me informacion nga KMD, në kuadër të hartimit të Raportit mbi të drejtat e Personave LGBTQI+.
- Pjesëmarrje online në takimin e grupit të punës EQUINET Working Group on Research and Data Collection.

Trajnime dhe Webinare

Gjatë vitit 2024, Stafi i KMD-së ka qenë pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme të organizuara nga vetë Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, apo në bashkëpunim me institucione apo OJF të ndryshme:

- Pjesëmarrje në ekspozitën *“Talenti nuk njih Vlera”* organizuar nga organizata Autizmi flet *“Club Kombetar i Prinderve të femijeve me Çrregullime të Spektrit Autik & P.A.K”*, me prezencën e znj. Englantina Bajrami, e zhvilluar në ambjentet e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Pjesëmarrje në hapjen e ekspozitës *“Përtej sfidave”* të piktores Gentiana Beqiri, në ambjentet e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Pjesëmarrje online në Trajnime për Platformën e Integritetit Evropian dhe Antarësimit.
- Pjesëmarrje në aktivitetin mbi *“Vlerësimi i profilit gjinor: Bujqësia dhe jeta në zonat rurale në Shqipëri”*.
- Pjesëmarrje online në takimin koordinues për Nënkomitetin *“Drejtësia, Liria dhe Siguria”* dhe kontributin në *“Rule of Law Report”* të Komisionit Evropian.
- Pjesëmarrje online në takimin e 15-të të Nënkomitetit *“Drejtësi, Liri dhe Siguri”*.
- Pjesëmarrje online në takimin e Grupit të Punës për Standartet e Organeve të Barazisë.
- Pjesëmarrje në trajnimin e zhvilluar në Shkollën e Magjistratures lidhur me çështjet e diskriminimit.
- Pjesëmarrje në *“Workshop on fundamental rights data collection to support Albanian authorities”*, ambientet e FRA, Vienna, Austria (On 19 April, a workshop on fundamental rights data collection will take place at FRA. The objective is to provide expertise to Albanian authorities in developing fundamental rights data collection methodologies.)
- Pjesëmarrje në aktivitetin *“TAIEX Multi-country workshop on Standards for Equality Bodies”*, në Hotel Tirana International.
- Pjesëmarrje në trajnimin të organizuar nga Këshilli i Europës Help Programme në Kursin *“Combating Hate Speech”*, ku jemi pajisur me certifikatë *“Deklaratë përfundimi me sukses”*.
- Pjesëmarrje online në takimin për diskutimin mbi buxhetin në lidhje me aplikimin në thirrjen: *“Call for proposals to prevent and combat gender-based violence and violence against children – Citizens, Equality, Rights and Values Programme (CERV -2024-DAPHNE)”*, program i Bashkimit Evropian.
- Pjesëmarrje në takimin e zhvilluar në ambjentet e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku u diskutua në lidhje me proceset gjyqësore ku KMD merr pjesë dhe praktika e gjykatave në lidhje me çështjet e diskriminimit.
- Pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga KMD në bashkëpunim me Terre des Hommes, me temë *“Parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe identifikimi i tyre përgjatë sistemit të referimit”*.

- Pjesëmarrje në aktivitetin në Hotel Rogner, lidhur me *Konferencën Kombëtare në Progresin e Shqipërisë për ti Dhënë Fund Pashtetësisë*, një takim ku morren pjesë zyrtarët kryesorë, ekspertë dhe avokatë nga e gjithë Shqipëria. Konferenca organizohet bashkarisht nga Përfaqësia e UNHCR në Shqipëri dhe Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë së Brendshme.
- Pjesëmarrje në Tryezën tematike publike me temë *“Garantimi i së drejtës së pronës dhe lufta kundër korrupsionit në sektorin e pronave”*, pranë Kuvendit të Shqipërisë.
- Referuar komunikimit në email nga eprori në të njëjtën datë ora 09.30, pjesëmarrje në konferencën kombëtare *“Fuqizim, Rikuperim, Riintegrim: Fuqizimi i Shërbimeve për Viktimat e Dhunës me bazë gjinore”*, në Rogner Hotel.
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë *“Përfshirja e të huajve në Ballkanin Perëndimor “Qasja në të drejtat sociale dhe ekonomike (FOSTER)”*, mbështetur nga BE, me organizimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, zhvilluar në Golem, Durrës.
- Pjesëmarrje në Tryezën *“Qeverisja e Mire”*, në Kuvendin e Shqipërisë.
- Pjesëmarrje në Tryezën *“Sigurimi i Qendrueshmërisë së Shërbimeve Shëndetësore në Banesë për të Moshuarit, nëpërmjet Buxhetimit të Dedikuar”*, tek Hotel Tirana.
- Pjesëmarrje në Tryezë Teknike *“Zgjedhjet 2025: Përmirësimi i fshehtësisë së votimit dhe parandalimi i presionit ndaj zgjedhësve – Sfida dhe Mundësi”*, tek Mak Albania.

11. Programi i transparencës

Në përputhje me programin e transparencës, KMD ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e saj të internetit

www.kmd.al, vendimet për diskriminim dhe mosdiskriminim, nga ankesat individuale dhe nga hetimet kryesisht.

Në dispozicion të publikut në faqen zyrtare janë të gjitha rekomandimet e KMD-së dhe vendimet e Gjykatave.

KMD publikon në faqen zyrtare kategoritë e mëposhtme të informacionit:

- Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të KMD-së dhe Zyrave Rajonale, orarin zyrtar.
- Funksionin dhe kompetencat e KMD
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë ankesë për diskriminim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e ankesave.
- Kuadrin ligjor, të konventave që janë ratifikuar, të ligjeve, të akteve nënligjore.
- Raportet e KMD
- Aktivitetet ndërgjegjësuere dhe informuese të organizuara nga Zyra e KMD-së,
- Takimet e Komisionerit
- Marrëveshjet e bashkëpunimit
- Strukturën organizative të KMD-së;
- Informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, orarin e punës, emrin dhe kontaktete koordinatorit për të drejtën e informimit; regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve të programit të transparencës.

V. ZYRAT RAJONALE

1. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Korçë

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD. Ky objektivi është një nga prioritetet kryesore të ZR Korçë. Gjatë vitit 2024 kjo zyrë ka qenë organizatore e zhvillimit të ditëve të hapura me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe kategorive të ndryshme shoqërore si dhe promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim.

Janar

- Takim me Prefektin e Qarkut Korçë me të cilin u diskutuan problematikat e shumta sociale dhe ato të diskriminimit që hasin qytetarët e Qarkut Korçë. Tema kryesore e diskutimit ishte moszbatimi i VKM 666 nga ana e Këshillit Bashkiak Korçë.
- Takim me drejtoreshën e shkollës “Naim Frashëri” me fokus aktivitetin që do të zhvillohet pranë kësaj shkolle në muajin shkurt.

Shkurt

- Takim me koordinatoren Rajonale të Komitetit Shqiptar të të Drejtave të Helsinkit Korçë, zhvilluar në ambientet e Zyrës, lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut, rastet e rëndomta të diskriminimit në shoqëri dhe bashkëpunimi me institucionet për t'i dhënë zgjidhje rasteve të ndryshme dhe problematikave të qytetarëve.
- Në kuadër të “Javës kundër Diskriminimit” u organizua një takim me nxënësit e klasave të 12-ta të gjimnazit “Ymer Dishnica”, me synim njohjen e legjislacionit dhe edukimin në mbrojtje të të drejtave themelore.
- Organizim aktiviteti pranë shkollës “Naim Frashëri” me prindër, mësues, nxënës, OJF, si dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme të Bashkisë Korçë, nën drejtimin e KMD, përfaqësues të KiE dhe ROMACTED. Tema e aktivitetit ishte moszbatimi i planit të masave për desegregimin e kësaj shkolle, bazuar në vendimin e Gjykatës së Strasburgut.
- Vizitë pranë shoqatës “Unë Gruaja” në Pogradec. Njohje dhe aktivitetin e kësaj shoqate. Diskutim me të pranishmit e ftuar nga Drejtoria e Shërbimit Social, Bashkia Pogradec, KMD, KiE etj.

Mars

- Takim me përfaqësuesen e Zyrës së Deputetëve të Qarku Korçë znj. A. T. Prezantimi i ZR Korçë, puna e institucionit të KMD dhe mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen.
- Takim me Prefektin e Qarkut Korçë z. Nertil Jole. Informim mbi problematikat e diskriminimit dhe rastet e ankesave drejtuar KMD.

Prill

- Organizimi i “Ditës së hapur” me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Fokusi ishte diskutimi i problematikës së përfitimit të bursave në bazë të VKM 511; Përrjashtimi nga marrja e saj e gjithë familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike; Mbështetja që institucioni i KMD po i jep kësaj kategorie.

Maj

- Në kuadër të ditës së Diversitetit Kulturor ZR organizoi një takim me temë: “Jetojmë sëbashku”, ku të pranishëm ishin stafi i Drejtorisë së Shërbimit Social Bashkia Devoll dhe një grup grash. Në takim pjesëmarrësit midis të tjerash u njohën me mbështetjen që LMD u jep secilit pavarësisht kulturës, etnisë që i përkasin.

Qershor

- Takim me ekspertin e KiE, me fokus zbatimin e planit të veprimit për desegregimin e shkollës “Naim Frashëri”. Më pas u organizua vizitë në ambjentet e shkollës, ku u takuan dhe drejtuesit e saj.
- Takim me përfaqësues të institucioneve të Bashkisë dhe DRAP. Takimi u zhvillua me praninë e ekspertit të KiE. Fokusi i tij ishte nxitja e zbatimit të planit të veprimit për desegregimin e shkollës “Naim Frashëri”.

Shtator

- Takim me përfaqësuesen e Zyrës së Ndhmës Ligjore Falas në Korçë, ku u diskutua situata ekonomiko-sociale e grupeve në nevojë, vështirësitë që ata hasin në marrjen e shërbimeve, diskriminimi që kanë, si dhe bashkëpunimi i ndërsjellë ndërinstitucional për rastet e paraqitura dhe zgjidhjen e tyre.

Tetor

- Specialistja e ZR Korçë, në bashkëpunim me Zyrën e AP-së, Ndhmën Ligjore Falas, kanë organizuar aktivitet informues në Bashkinë Kolonjë, ku patën një takim të veçantë me Kryetarin e kësaj Bashkie, i cili u shpreh i gatshëm për të bashkëpunuar dhe zhvilluar aktivitete të përbashkëta.
- Në vazhdimësi të aktiviteteve bashkëpunuese me AP-në, në ambjentet e shkollës së mesme “Fuat Babani”, Bashkia Devoll, u zhvillua takimi informues me nxënësit e klasave të 10-ta, të cilët u njohën me punën e institucionit, LMD-në, format dhe rastet e diskriminimit, procedurën që ndjek ankesa nga momenti i regjistrimit deri në marrjen e vendimit nga KMD. Këto takime informuese janë zhvilluar dhe në Bashkinë Maliq, ku pjesëmarrësit janë njohur me veprimtarinë e Avokatit të Popullit dhe KMD-së.

Nëntor

- “Ditë të hapura” në Bashkinë Kolonjë, të cilat kanë qënë në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit dhe Ndhmën Ligjore Falas. Takimet janë zhvilluar me grupe të ndryshme interesi, të cilët gjatë diskutimeve kanë shfaqur problematika të ndryshme, që kanë në fokus shkeljen e të drejtave të njeriut, diskriminimin që kjo kategori has çdo ditë.

Dhjetor

- Në kuadër të aktiviteteve ndërgjegjësuere dhe informuese në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit në ambjentet e Qendrës Ditore Korçë u organizua një takim me nënat e familjeve në nevojë, të cilat u njohën me LMD-në, punën e këtij institucioni në

mbështetje të grupeve në nevojë. Aktiviteti u organizua dhe me mbështetjen e Fondacionit “Misioni Emanuel”, Korçë.

- Takim me specialistët përkatëse të caktuar pranë Bashkisë Devoll, Pogradec, të cilat punojnë për zbatimin e VKM nr. 666, për marrjen e bursave. Gjatë takimit ato shprehën shqetësimin lidhur me këtë proces, pasi numri i kërkesës drejtuar ministrisë është më i lartë se ajo që u ofrohet.

Pjesëmarrje në aktivitete institucionale

Janar

- Pjesëmarrje në takimin Konsultativ Rajonal me të rinjtë. Diskutimi i planeve vendore rinore në Bashkitë Korçë, Pogradec, Maliq, Devoll, organizuar CRCA/ECPAT Shqipëri, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Shkurt

- Pjesëmarrje në takimin sensibilizues të organizuar nga Qendra e Ndihmës Juridike Parësore Korçë, organizuar në kuadër të javës së zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Mbrojtjes së Viktimave të Krimit. Në takim u realizua një video mesazh ndërgjegjësues, me të gjithë përfaqësuesit e institucioneve që punojnë me grupe të veçanta.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Eorl Vision në bashkëpunim me shoqatën “Eja në teatër”. Në fokus të aktivitetit ishin të drejtat e punëtorëve në vendin e punës, të drejtat e grave dhe dhuna me bazë gjinore.

Mars

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Devoll me rastin e 8 Marsit.

Prill

- Pjesëmarrje në tryezën e Grupit Teknik Ndërsektorial të Bashkisë Korçë për të diskutuar situatën e 2(dy) fëmijëve, që janë në rrezik braktisjeje nga nëna e tyre.
- Pjesëmarrje në tryezën e Grupit Teknik për Gratë e Dhunuara pranë Bashkisë, për të diskutuar trajtimin për zgjidhjen e rasteve, gjatë periudhës janar-mars 2024.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga UNDP në Bashkinë Berat, me rastin e 8 Prillit, Ditës Ndërkombëtare të Romëve.
- Pjesëmarrje në tryezën e Grupit Teknik për Gratë e Dhunuara. Diskutim dhe analizë e punës së këtij grupi.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga OMSA, me fokus ofrimin e shërbimeve për komunitetin LGBTIQ+. Ky takim zhvillohej në kuadër të Planit Kombëtar të Veprimit të Personave LGBTIQ+, 2021-2027, si edhe njohja me aktivitetet e ndërmarra nga OMSA në kuadër të IDAHOT.

Maj

- Pjesëmarrje në trajnimin për ngritjen e kapaciteteve në mbështetje të komunitetit LGBT, organizuar nga Aleanca Kundër Diskriminimit LGBT.
- Pjesëmarrje në tryezën e konsultimit mes aktorëve institucionalë dhe atyre joqeveritarë, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Në takim u diskutuan gjetjet e zbatimit të kuadrit ligjor mbi ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, bazuar në monitorimin e situatës në terren.
- Pjesëmarrje në ëebinarin me temë: “E drejta dhe interesat legjitime të strategjive në politikat e punësimit”, organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët sensibilizuese “Standardet e SHQK - Rëndësia e Fushës 2: "Sigurimi i mirëqënies sociale, emocionale dhe shëndetësore të nxënësve”. Ky takim adresoi tek aktorët ligjzbatues dhe vendimmarrës, rëndësinë që duhet të marrë zhvillimi social-emocional tek fëmijët dhe të rriturit, si dhe mundësinë e zhvillimit të mëtejshëm të praktikave të qëndrueshme të të nxënësve social-emocional.

Qershor

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas Korçë, e cila ofon shërbim ligjor falas për personat vulnerabël dhe ata në pamundësi ekonomike. Bazuar në rezultatet dhe rastet e suksesit, fokusi i takimit ishte vijimësia e këtij bashkëpunimi, me qëllim aksesin sa më të lartë të qytetarëve në drejtësi.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) me temë: “Tryeza për partneritet rajonal në fushën e punësimit dhe aftësive”. Qëllimi i këtij takimi ishte fuqizimi i ndërveprimit të aktorëve lokalë dhe përfshirjen në mënyrë sistematike të sektorit privat në qeverisjen dhe zhvillimin e ekosistemit të punësimit dhe aftësive, në funksion të operimit sa më të mirë të tregut të punës dhe përmirësimit të cilësisë së Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri.
- Pjesëmarrje dhe bashkëpunëtorë në organizimin e “Ditëve të hapura” realizuar nga ZR e Avokatit të Popullit në Korçë.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Avokati i Popullit në Korçë.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia me rastin e 24 Qershorit, ditës së Egjiptjanëve të Ballkanit.
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: “Të rrisim aksesin në drejtësi të personave në rrezik pashtetësie, të refugjatëve dhe azilkërkuesve, në funksion të minimizimit të pabarazisë sociale të këtyre grupeve”. Ky trajnim u organizua nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS) në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike dhe mbështetjen e UNHCR, në kuadër të projektit të ofrimit të Ndihmës Juridike për grupet dhe individët vulnerabël në të gjithë territorin.

Shtator

- Pjesëmarrje në tryezën e Grupit Teknik Ndërsektorial. Në këtë tryezë u referuan raste të 2(dy) fëmijëve dhe mundësia e zgjidhjes së tyre.

Tetor

- Pjesëmarrje në takimin ndërgjegjësues mbi fuqizimin dhe mirëfunksionimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, për Bashkinë Korçë, organizuar nga Qendra Assist Albania, si

partner zbatues i këtij programi, përmes mbështetjes së Qendrës Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (Koordinatori Kombëtar kundër Ekstremizmit).

- Pjesëmarrje në takimin e komitetit drejtues të iniciativës "Korça Bashki mike e fëmijëve", ku u diskutua ecuria e planit të aktiviteteve të iniciativës "Korça Bashki mike e fëmijëve", sfidat, vështirësitë por edhe aktivitete të tjera që nuk janë parashikuar në plan, por kanë dalë si kërkesë nga vetë fëmijët.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Devoll në kuader të "Tetorit Rozë", si muaji i sensibilizimit të grave e nënave, për kancerin e gjirit.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga Bashkia Korçë, në kuader të "Tetorit Rozë", si muaji i sensibilizimit të grave e nënave për kancerin e gjirit.
- Pjesëmarrje në trajnimin 2 (dy) ditor, lidhur me modelet e zhvillimit të komunitetit, organizuar nga Dorcas Albania, në kuadër të programit "Sep&Integrated Development of Vulnerable groups in Korca Region".
- Pjesëmarrje në ëëbinarin me temë: "Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë," organizuar nga ASPA.

Nëntor

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Ndihma Juridike Falas me kryetarin e Bashkisë Pustec dhe përfaqësues të këtij institucioni. Në takim pjesëmarrësit u njohën me punën e instituconeve, bashkëpunimi ndërmjet tyre në dobi të qytetarëve dhe grupeve të interesit.

Dhjetor

- Pjesëmarrje në takimin e 18 të dialogut të KE-së, organizuar në Strasbourg me temë: "Integrimi i njohurive: formësimi i draft strategjisë së Këshillit të Evropës për përfshirjen Romëve dhe udhëtarëve (2026-2030)", përmes gjetjeve nga organet monitoruese.
- Pjesëmarrje në mbledhjen e Komitetit Drejtues (KD) "Kundër Dhunës në Familje", organizuar nga Bashkia Devoll. Ky aktivitet ka për qëllim identifikimin e problemeve lidhur me dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006. Në këtë takim u nënshkrua edhe Marrëveshja e bashkëpunimit ndërinstitucional ku ZR e KMD do të jetë pjesë.
- Pjesëmarrje në organizmin e "Ditës së Rinisë" dhe të "Panairit të Rinisë" Korçë, organizuar nga CRCA/ECPAT Shqipëri, me mbështetjen e Agjensisë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijë, në kuadër të nismës "Shërbime Rinore me një Ndalesë". Gjatë Panairit u prezantuan Planet Lokale të Veprimit për Rininë për katër bashkitë partnere.
- Pjesëmarrje në tryezën e diskutimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me organizatat e shoqërisë civile në lidhje me veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi përgjatë vitit 2024.
- Pjesëmarrje në ankandin me produkte artizanale të dizenuara dhe prodhuara nga vetë të moshuarit. Ky aktivitet organizohet nga Këshilli i Qarkut Korçë.

Informacion mbi detyrat e përmbushura gjatë periudhës janar-dhjetor 2024

Gjatë periudhës janar-dhjetor 2024 nga specialisti i ZR të KMD Korçë ka përmbushur këto detyra:

- Çdo ditë pritje me qytetarët.
- Këmbime emailsh dhe telefonata pune me institucionet përgjegjëse për rastet e paraqitura nga qytetarë të ndryshëm.
- Pritje dhe sqarime të qytetarëve për mënyrën e plotësimit të formularit të ankesës dhe aktet provuese që duhet t'i bashkëlidhen për regjistrim.
- Referim rastesh në zyrat përkatëse (kryepërmendur).
- Takime me përfaqësues të pushtetit vendor për rastet e paraqitura. Ndërmjetësim në zgjidhjen e tyre.
- Komunikim i vazhdueshëm me përfaqësues të institucionit të Bashkisë dhe Drejtorisë Mbështetëse për zgjidhjen e çështjes së mosdhënies së bursave në zbatim të VKM 666.
- Organizim dhe mbarëvajtje e aktiviteteve të zhvilluara në Korçë dhe Pogradec.
- Komunikim me ankuesit mbi ecurinë e procesit të shqyrtimit të ankesave nga KMD.

2. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Fier

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD. Ky objektivi është një nga prioritetet kryesore të ZR Fier. Gjatë vitit 2024 kjo zyrë ka qenë organizatore e zhvillimit të ditëve të hapura me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe kategorive të ndryshme shoqërore si dhe promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim.

Janar

- Takim pune me specialisten për dhunën në familje DVP Fier për të shkëmbyer informacion të përbashkët për mbrojtjen që ofron LMD si dhe funksionimin e mekanizimit të mbrojtjes nga dhuna, subjektet që duhet të vënë në dijeni organet përgjegjëse në rastet e dhunës në familje etj.
- Takim pune me drejtorin e gjimnazit të përgjithshëm "Janaq Kilica", me qëllim realizim aktiviteti në kuadër të javës kundër diskriminimit.

Shkurt

- Pranë Zyrës Rajonale dhe Ndhmës Juridike Parësore Fier pati një vizitë nga përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit me qëllim monitorimin nga afër të veprimtarisë së Ndhmës Juridike Parësore dhe një prezantim të funksionit të Zyrës Rajonale, në formën e bashkëbisedimit.
- "Ditë e hapur" në kuadër të Javës Kundër Diskriminimit organizuar në ambjentet e Policisë Fier, me specialisten për Dhunën në Familje, specialistë të shërbimit të qytetarëve si dhe Ndhma Juridike Falas si elementë të rëndësishëm në kontaktin e parë me grupet vulnerabël dhe jo vetëm.
- Takim me drejtoreshën e Zyrës Rajonale të Punësimit në kuadër të zhvillimit të aktivitetit për "Javën Kundër Diskriminimit".
- "Java Kundër Diskriminimit", aktivitet në gjimnazin "Janaq Kilica", Fier me temë: "Bullizimi, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi në shkollë", me pjesëmarrjen e KMD-së dhe mbështetje nga Këshilli i Evropës.

- Java Kundër Diskriminimit", aktivitet në Drejtorinë Rajonale të Punësimit Fier, me temë: "Diskriminimi në vendin e Punës", me pjesëmarrjen e KMD-së dhe mbështetje nga Këshilli i Evropës.

Mars

- Shpërndarje e materialeve të KMD-së në komunitet.
- Pritur në zyrë qytetarë, dhënë informacion në lidhje me procedurën e ankesës, fazat e hetimit administrativ, barra e provës si dhe pasqisur me kopje të LMD-së.

Maj

- Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere u realizua “Ditë e hapur” në Divjakë, me qëllim informimin për parandalimin e diskriminimit. Po ashtu u shpërndanë materiale të KMD-së, si dhe u njohën me vendodhjen e Zyrës Rajonale.
- Takim institucional në Bashkinë Divjakë, me specialistë të Dhunës në Familje, NJMF-së, Shërbimin Social si dhe specialisten e Njesisë së Integritetit European. Ky takim u realizua me qëllim prezantimin e institucionit të KMD-së, rolit të Zyrës Rajonale dhe rritjes së bashkëpunimit institucional, në luftën kundër diskriminimit.
- Pritur në zyrë në një takim pune Drejtori i Ndihmës Juridike Parësore Falas, me të cilin u diskutua mbi bashkëpunimin e dy zyrave dhe problematikat gjatë punës.
- Në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuere në bashkëpunim me përfaqësuesen e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit në Berat u realizua “Ditë e hapur në Lushnjë”, me qëllim informimin dhe parandalimin e diskriminimit. Po ashtu u shpërndanë materiale të KMD-së si dhe u njohën me vendodhjen e Zyrës Rajonale.
- Takim institucional në Bashkinë Lushnje, me specialistë të Dhunës në Familje, NJMF-së, Shërbimit Social si dhe specialisten e Njesisë së Integritetit European.
- Në kuadër të bashkëpunimit me Ndihmën Juridike Parësore, u realizua takim në Lushnje, me synim referimin e rasteve dhe pjesëmarrje në aktivitete në luftën kundër diskriminimit.
- Takim pune me përfaqësuesen e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit në Vlorë, pritje qytetarësh dhe diskutim për rastet e referuara.
- Takim me kryetarin e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, dega Vlorë, me pjesëmarrjen e personave PAK, kategoria e të verbërve, me të cilët u diskutua roli i KMD në mbrojtjen e PAK dhe jo vetëm. Nga pjesëmarrësit u ngritën disa ankesa drejtuar KMD përmes shoqatës.
- Realizuar takim me aktivistë në mbrojtje të të drejtave të personave PAK. Konsultim në lidhje me disa raste të largimit nga puna të kësaj kategorie.

Qershor

- “Ditë e hapur” dhe takim pune me punonjës të Njesisë Administrative Levan, ku u prezantua institucioni i KMD, kompetencat e tij, roli i Zyrës Rajonale, si dhe rëndësia e bashkëpunimit për pjesëmarrje në aktivitete.
- Takim pune me Zyrën e Ndihmës Juridike Falas, konsultim mbi rastet e ardhura pranë qendrës si dhe planifikim mbi aktivitetet që do të realizojmë në bashkëpunim.
- Takim në zyrë me mësues të ciklit të ulët, ndër to mësues me Aftësi të Kufizuar. Dhënë informacion mbi kompetencat e KMD-së, ankesat dhe afatet ligjore të trajtimit të tyre.

Diskutuar mbi problematikën e uljes së ndjeshme të numrit të nxënësve në shkollat rurale, që ka sjellë si pasojë mbylljen e shkollave si dhe udhëzimi i fundit nr. 8 datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", i cili i vendos në situatë diskriminuese mësuesit me AK.

- Takim pranë Bashkisë Patos me përgjegjësen e Shërbimit Social, koordinatoren për viktimat e dhunës dhe të miturit të cilat menaxhonin raste të dhunës në familje, përmes ofrimit të shërbimeve multi-disiplinare për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Takim në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe informues mbi ligjin Nr.10 221 ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020, ku përveç informimit mbi shërbimet që ofron Zyra Rajonale, shkëmbimit të kontakteve me qëllim evidentimin dhe referimin e rasteve potenciale, u procedua dhe me shpërndarjen e broshurave të KMD.
- Realizuar takim pune me aktivisten për mbrojtjen e të drejtave të personave PAK (mësues) me qëllim trajtimin e një kauze të rëndësishme në lidhje me Udhëzimin Nr. 8 datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë", duke lënë të pambrojtur mësuesit me aftësi të kufizuar.

Korrik

- Realizuar takim në zyrë me grupin e mësuesve me status PAK për të diskutuar mbi veprimet e ndërmarra në lidhje me udhëzimin nr. 8 datë 03.05.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit "Mësues për Shqipërinë".
- Takim me Drejtoreshën e Shtëpisë së të Moshuarve në Fier në kuadër të zgjidhjes me ndërmjetësim për çështjen e paraqitur nga një zonjë rezidente pranë shtëpisë e cila përfundoi me zgjidhje të problemit të parashtruar.

Gusht

- Mbledhje online me Drejtoreshën e DPA-së dhe koleget e ZR-ve për problematika të punës dhe për realizimin e raporteve të kërkuara.
- Realizuar takim pune me Drejtorin e Postës Fier, me qëllim ndërmjetësimi në fushën e shërbimeve në llogari të qytetarit paraqitur pranë ZR për zvarritje dhe mungesë informacioni për të transferuar KEMP-in e djalit të tij PAK pranë fondacionit "Vatra e Ngrohtë", për arsye të moshës për të kryer këto veprime.

Shtator

- Takim pune me përfaqësuesen e Avokatit të Popullit në Vlorë, gjatë të cilit u diskutua mbi raste të caktuara dhe u planifikuan aktivitete të përbashkëta.
- Zyra Rajonale Fier në bashkëpunim me punonjësen sociale, koordinatore e projektit "Fuqizimi i komunitetit përmes shtimit të shërbimeve sociale në Qendrën Social-Komunitare, Bashkia Roskovec.", organizuan një takim në Njësinë Administrative Kuman me pjesëmarrjen e Kryetarëve të fshatrave, përfaqësues të Qendrës Shëndetsore Kuman, familje në nevojë, persona me aftësi ndryshe, gjithashtu dhe pjesëmarrja e

Inspektorit të zonës; ku u njohën me veprimtarinë e KMD-së, kuadrin ligjor dhe rolin e Zyrës Rajonale.

Tetor

- Takim institucional me koordinatorin dhe asistenten e "Qendrës me një ndalesë" Fier, pranë së cilës trajtohen format e rënda të dhunës seksuale dhe fizike të miturit. Ky takim u realizua në bashkëpunim me Ndhmën Juridike Falas, ku u shkëmbye informacion mbi shërbimet që ofron qendra dhe ato që ofrojnë KMD dhe Ndhma Ligjore Falas. Gjatë takimit u ndanë dhe diskutuan raste si edhe u vendosën urat për bashkëpunim të mëtejshëm për pjesëmarrje në aktivitete dhe referim rastesh.
- Në kuadër të 1 Tetorit, "Dita Ndërkombëtare e të Moshuarve", ZR Fier realizoi një takim pranë shtëpisë së të Moshuarve Fier, me qëllim ndërgjegjësimi dhe informimi ligjor për të luftuar diskriminimin për shkak të moshës.

Nëntor

- Shpërndarë materiale të KMD-së kryesisht "Ligji" në formatin për fëmijë, një grupi mësuesish të interesuar në kuadër të 20 nëntorit "Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve".
- Takim pune me Zyrën e Ndhmës Ligjore Falas me qëllim realizimi "Ditë të hapura", në disa njësi administrative.
- Pranë Zyrës Rajonale Fier dhe Ndhmës Ligjore Falas pati një vizitë pune nga Drejtori i Ndhmës Juridike, Ministria e Drejtësisë, Përfaqësues të PNUD-it si edhe gazetarë për t'u njohur me rastet e trajtuara nga ndërmjet dy zyra në kuadër të bashkëpunimit.

Dhjetor

- Në kuadër të 3 dhjetorit, "Dita ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara", ZR Fier realizoi një takim pune pranë Qendrës Multifunksionale "Horizont", Bashkia Fier.

Pjesëmarrje në aktivitete institucionale

Janar

- Pjesëmarrje në ëëbinarin me temë: "Barazia gjinore në vendimmarrje", organizuar nga ASPA.

Shkurt

- Pjesëmarrje në aktivitetin e realizuar nga Ndhma Juridike Parësore Falas Fier, në kuadër të javës "Në mbrojtje të viktimave të krimit", zhvilluar në ambjentet e Drejtorisë së Policisë Fier.

Prill

- Pjesëmarrje në aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, realizuar nga Bashkia Berat, në bashkëpunim me UNDP Albania dhe Bashkimin Europian.

- Pjesëmarrje në aktivitet në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Romëve, zhvilluar në Njësinë Administrative Novoselë nga Shoqata Atdhetare - Kulturore Shqipëria.
- Pjesëmarrje në ëëbinarin me temë: "Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike", organizuar nga ASPA.
- Pjesëmarrje në ëëbinarin me temë: "Raporti i të Drejtës Evropiane me të Drejtën Kombëtare", organizuar nga ASPA.

Maj

- Pjesëmarrje në Tryezën e Konsultimit me temë: "Rëndësia e KVSP-së në fushën e policimit në komunitet dhe koordinimi ndërinstitutional", organizuar në Prefekturë, me mbështetjen e IPO (International Police Organization), QPKMR (Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve) i dhe ASHDMF-ja (Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve).
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: "Rritja e kapaciteteve të profesionistëve të institucioneve lokale dhe organizatat e shoqërisë civile për menaxhimin e rasteve të të mbijetuarëve të dhunës me bazë gjinore dhe në mbështetjen e ri-integritit të tyre", organizuar nga shoqata "Të ndryshëm&Të Barabartë", në partneritet me qendrën Psiko-Sociale "Vatra"; shoqatën "Tjetër Vizion" dhe shoqatën "Gender, Paqe, Siguri".
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: "Barazia para ligjit dhe aksesit në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar", realizuar nga Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk Dëgjojnë.

Qershor

- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: "Sfidat e komunitetit Egjiptian dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", në kuadër të projektit me temë: "Rinia larg çdo lloj dhune, diskriminimi racial dhe sensibilizimi i komuniteteve të pakicave kombëtare në Bashkinë e Vlorës" dhe "Ditës Ndërkombëtare të Egjiptianëve të Ballkanit", organizuar nga "Shoqata 'Shqipëria' dhe Bashkia Vlorë.
- Pjesëmarrje në trajnimin informues "Mbi qasjet gjithëpërfshirëse që duhen ofruar për të siguruar shërbime edhe ndaj grave e vajzave me aftësi të kufizuara, viktimat të dhunës e trafikimit"; në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "T'i japim fund dhunës ndaj Grave".

Shtator

- Pjesëmarrje në aktivitetin trajnues në kuadër të projektit "Për më shumë mundësi arsimimit dhe punësimi për anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Vlorë"; me temë: "Si të mbrohen të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike dhe jo vetëm", ku ZR Fier diskutoi mbi trajtimin e rasteve të diskriminimit në vendin e punës, disa nga vendimet e dhëna nga KMD si dhe u ndal mbi rolin dhe kompetencat e KMD-së, realizuar nga Njësia e Integritit Evropian, Bashkia Vlorë.
- Pjesëmarrje në tryezën e KRAT-it (Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Personave), ku u diskutua në lidhje me kalendarin e aktiviteteve për muajin Tetor 2024, përcaktimi i strategjive dhe plani i veprimit në kuadrin e strategjisë kombëtare, menaxhimi i

rasteve dhe rehabilitimi i viktimave të trafikut si dhe krijimi i një rrjeti të mbrojtjes sociale për shyresat në nevojë.

- Pjesëmarrje në tryezën e grupit ETN Bashkia Roskovec (Ekipi Teknik Ndërdisciplinor), trajtimi i rasteve të dhunës në familje.
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë "Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë", organizuar nga ASPA.

Tetor

- Pjesëmarrje në aktivitetin ndërgjegjësues "Nga ndërgjegjësimi në veprim, Bashkohuni në luftën kundër trafikimit", organizuar nga Qendra me Një Ndalesë Fier dhe Qendra Psiko-Sociale "Vatra, në kuadër të programit "Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria", zbatuar nga Qendra Psiko-Sociale "Vatra" dhe Terre des Hommes Albania, udhëhequr nga UNICEF dhe mbështetur nga Ambasada Britanike.
- Pjesëmarrje në aktivitetin ndërgjegjësues në kuadër të promovimit të Ndihmës Juridike Falas në Bashkinë Mallakastër, organizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.
- Pjesëmarrje në 30 vjetorin e Qendrës Sociale Murialdo.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e zhvilluar nga Bashkia Roskovec në kuadër të "Ndërgjegjësimi në luftën kundër trafikimit", me nxënësit e shkollave, përfaqësues nga stafi akademik, Shërbimi Social Roskovec. Synimi aktivitetit ishte promovimi i shërbimeve për menaxhimin dhe trajtimin e grupeve të rrezikuara për përfshirje në trafikim, me fokus të veçantë tek fëmijët që janë viktimë ose dëshmitarë të formave të rënda të dhunës, përfshirë edhe abuzimin seksual.
- Pjesëmarrje në takimin e zhvilluar nga Avokati Popullit, në kuadër të informimit mbi të drejtat që ata gëzojnë në përputhje me legjislacionin vendas. Diskutimi i çështjeve dhe sfidave aktuale të të drejtave të njeriut me përfaqëses lokal, OJF si dhe qytetarë të cilët shprehen shqetësimet e tyre.

Nëntor

- Pjesëmarrje në aktivitetin: "Ditë e hapur" në qytetin e Vlorës, organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit me qytetarë, punonjës së Zyrës së Punës dhe Formimit Profesional. Gjatë takimit të pranishmit u njohën dhe me rolin e KMD-së në trajtimin e ankesave si edhe u diskutuan problematika dhe raste personale.
- Pjesëmarrje në çeljen e fushatës "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës në familje dhe asaj me bazë gjinore", me pjesëmarrjen e gjithë aktorëve lokalë për të përcjellë mesazhin "Asnjë justifikim-Të gjithë bashkë kundër dhunës", organizuar nga Bashkia Fier.

Dhjetor

- Marrë pjesë në tryezën e rumbullakët për të mbështetur Insitucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ) dhe Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), organizuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në bashkëpunim me OSBE.

Informacion mbi detyrat e përmbushura gjatë periudhës janar-dhjetor 2024

Gjatë viti 2024 në kuadër të përmbushjes së detyrave janë realizuar:

- Pritje qytetarësh çdo ditë, dhënie informacioni, asistim në plotësimin e formularit të ankesës në të gjitha rubrikat përkatëse, orientim për dokumentacionin e nevojshëm, interpretime të vendimeve të KMD-së, interpretime shkresash të ndryshme apo asistim në hartim shkresash drejtuar institucioneve përkatëse në lidhje me problematikën e qytetarit etj.
- Mbajtur kontakt i vazhdueshëm me ankuesit në çdo fazë të hetimit administrativ dhe jo vetëm.
- Mbajtur kontakt i vazhdueshëm me OJF dhe institucione të pushtetit vendor për pjesëmarrje në aktivitete, po ashtu kontakt i vazhdueshëm me Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në Vlorë, Berat dhe Sarandë si edhe me Ndihmën Juridike Parësore Falas në Fier, Lushnjë, Berat, Gjirokastrë, këto në kuadër të bashkëpunimit për pjesëmarrje në aktivitete apo referim rastesh.
- Pritur telefonata nga publiku për informim në lidhje me procedurën e ankesës, si dhe çështje që lidhen me diskriminimin.
- Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik, promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim realizuar këto në formën e ditëve të hapura.
 - Janë realizuar 34 (tridhjetë e katër) aktivitete në terren dhe zyrë.
 - Pjesëmarrje në 18 (tetëmbëdhjetë) aktivitete, 3 (tre) ëëbinare dhe 1 (një) trajnim.

Gjatë periudhës janar - dhjetor specialisti i Zyrës Rajonale Fier ka informuar/këshilluar dhe referuar në zyrat përkatëse 81 (tetëdhjetë e një) qytetarë për problematikën si më poshtë:

1. Përpilim shkrese drejtuar ASHK-Fier në lidhje me arsyet e mos kthim përgjigjes dy qytetarëve të Komunitetit Rom si dhe referim rasti për fillim procedure për përfitimin e Ndihmës Juridike Falas.
2. Asistuar në përpilim shkrese një shtetase drejtuar Gjëndjes Civile për ndryshimin e emrit.
3. Orientuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror një shtetase për përfitimin e ndihmës sociale/kempin.
4. Konsulencë ligjore një qytetari në lidhje me moskompensimin për qiradhënie të tokës një kompanie private, Alpetrol sh.a.
5. Konsulencë ligjore një qytetari për zaptimin e pronës së tij, orientim për të ngritur padi pranë gjykatës dhe drejtuar prokurorisë.
6. Orientuar dy qytetarë pranë Shërbimit Social Shtetëror për marrjen e shpërblimit të lindjes.
7. Konsulencë ligjore mbi dokumentacionin e nevojshëm në lidhje me çeljen e trashëgimisë ligjore/testamentare.
8. Interpretime të vendimeve të KMD-së.
9. Konsulencë ligjore një qytetari në lidhje me pasuritë mbi të cilat vendoset sekuestro nga ana e Zyrës Përmbarimore.
10. Konsulencë ligjore një qytetari në lidhje me mënyrën dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndarjen nga trugu familjar.
11. Përpilim shkrese një qytetari, drejtuar Shërbimit Social Bashkia Fier në lidhje me përfitimin e bonusit të lindjes për fëmijën e lindur jashtë Shqipërisë.
12. Konsulencë juridike mbi ndarjen e pasurisë bashkëshortore.

13. Konsulencë ligjore një qytetari në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm për të ngritur padi në gjykatë për njohjen e pronësisë së tokës.
14. Orientuar një qytetare për të ndjekur Procedurat e divorcit pranë Ndhmës Juridike Falas Fier.
15. Këshillim mbi skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike.
16. Asistuar në përpilim shkrese drejtuar Njësisë Administrative nr.1 Fier përsa i përket vënies në dispozicion të një vërtëtimi banimi.
17. Asistuar në përpilim shkrese drejtuar ASHK-së për çështje pronësie.
18. Konsulencë në lidhje me të drejtën e tërheqjes së librezës së punës pas përfundimit të marrëdhënies së punës.
19. Asistuar në përpilim shkrese, drejtuar Drejtorisë së Shërbimit Social, Bashkia Fier.
20. Konsulencë dhe orientim pranë Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëror për përfitim ndihme ekonomike si kujdestar i fëmijës së mitur.
21. Konsulencë dhe informacion mbi kërkesën për rishqyrtim të pensionit të pleqërisë.
22. Konsulencë në lidhje me aplikimin për të nxjerrë kopje të AMTP-së.
23. Referim rast divorci pranë Ndhmës Juridike Parësore Fier.
24. Përpilim shkrese drejtuar Ujësjiellës Kanalizime SHA Fier për mundësinë e një akt-marrëveshjeje për pagesë me këste të debisë, në pamundësi ekonomike për pagesë totale.
25. Konsulencë 8 qytetareve në lidhje me pronën, orientuar të drejtojnë ankesë pranë AP.
26. Konsulencë në bashkëpunim me Ndhmen Juridike Falas për dërgim shkrese Prokurorisë në lidhje me çështjen e 8 qytetarëve për pronën.
27. Konsulencë dhe orientim pranë Avokatit të Popullit Vlorë një qytetar me status PAK, për mos zbatim të së drejtës në lidhje me mospagesën e transportit të brendshëm publik, sipas ligjit në fuqi i cili zbatohet nga disa Bashki.
28. Konsulencë një qytetareje në lidhje me dokumentacionin për përfitim të avokatit falas për zgjidhje martese. Referuar më tej pranë Ndhmës Juridike Falas Fier.
29. Konsulencë një qytetareje në lidhje me dokumentat e pronës (shtëpi), e cila u orientua t'i drejtohej ASHK-së në lidhje me problematikën e saj.
30. Konsulencë një qytetari lidhur më ankimimin për mosnjohje të viteve të vjetërsisë në llogaritjen e pensionit të pleqërisë.
31. Konsulencë ligjore lidhur me procedurën e ndjekur për rregjistrim toke (7501) në AMTP.
32. Referuar Ndhmës Juridike Parësore Fier një qytetar, problematika e të cilit kërkonte ndjekjen e çështjes në rrugë gjyqësore (përfitimin e avokatit falas).
33. Konsulencë lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e avokatit falas lidhur me procedurën e divorcit.
34. Asistuar në marrjen e certifikatave familjare dhe orientim pranë Ndhmës Juridike Parësore Lushnjë një person i komunitetit LGBTIQ+.
35. Konsulencë ligjore në lidhje me regjistrimin e fëmijës së porsalindur.
36. Konsulencë lidhur me skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike si dhe kategoria përfituese, skema që ndiqet për personat me status “invalid pune”.
37. Konsulencë lidhur me kategorinë që përjashtohet nga taksat vendore të përfshira në faturën e ujit.
38. Konsulencë në lidhje me përfitimin e ndihmës ekonomike si dhe për banesë sociale.
39. Konsulencë ligjore lidhur me ndarjen e pasurisë bashkëshortore pas procesit të divorcit.
40. Orientuar për t'u drejtuar me shkresë OSHEE dhe UKF Fier për pamundësinë e pagës së detyrimeve për shkak të gjëndjes ekonomike dhe familjare.

41. Orientuar për t'u drejtuar Bashkisë Vlorë qytetaren për aplikim në sistem për përfitim të ndihmës ekonomike si kryefamiljare e vetme dhe pa të ardhura ekonomike.
42. Konsulencë ligjore lidhur me përfitimin e pagesës së urdhrit të mbrojtjes .
43. Konsulencë ligjore për Procedurat që duhen ndjekur për dëmshpërblim në rast dëmtimi nga fatkeqësi natyrore.
44. Konsulencë ligjore dy qytetarëve në lidhje me pagesën e taksave vendore si emigrant.
45. Konsulencë ligjore lidhur me kompensimin e ujit për pensionistët e vetmuar.
46. Konsulencë ligjore në lidhje me Procedurat dhe dokumentat për divorc. Referuar Ndihmës Juridike Falas në Fier.
47. Konsulencë ligjore lidhur me përfitimin e statusit të naftëtarit.
48. Konsulencë në lidhje me përfitimin e bonusit të bebes të lindur jashtë Shqipërisë.
49. Konsulencë në lidhje me dokumentat e nevojshëm për përfitimin e avokatit falas lidhur me ndreqjen e gabimit të emrit në librezën e punës. Referuar Ndihmës Juridike Falas në Fier.
50. Orientuar qytetari të paraqitet pranë Gjykatës Administrative për tërheqje të vendimit gjyqësor.
51. Asistuar në përpilim shkrese drejtuar Bashkisë Fier.
52. Konsulencë lidhur me pezullimin nga detyra dhe përfshirjen ose jo në sistemin e pikëzimit të mësuesve.
53. Konsulencë ligjore lidhur me përfitimin e bonusit të bebes i cili ka kaluar një vit nga momenti i regjistrimit.
54. Referuar t'i drejtohet policisë dhe prokurorisë për vjedhje e më pas përdorimin e kartës së identitetit për të kryer veprime bankare.
55. Konsulencë lidhur me dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e avokatit falas për zgjidhje martese.
56. Këshillim dhe orientim lidhur me konfliktin për çështje prone.
57. Konsulencë ligjore lidhur me transferimin e pagesës së KEMP-it, referuar institucionit përkatës në zgjidhjen e problematikës si dhe asistuar në përgatitjen e dokumentacionit.
58. Konsulencë ligjore lidhur me Procedurat e njoftimit të rikthimit në punë pas përfundimit të lejes së lindjes.
59. Konsulencë ligjore lidhur me të drejtën e lejes prindërore për kujdesin shëndetsor të fëmijës stë mitur.
60. Konsulencë ligjore lidhur me procedurën e pezullimit nga shërbimi civil me kërkesën e nënpunësit civil.
61. Orientuar për kallëzim penal qytetarja lidhur me pretendimin e fallcifikimit të firmës me qëllim marrje pensioni pleqërie nga punonjësi postës.
62. Konsulencë ligjore lidhur me marrjen e lejes së legalizimit. Referuar për kompetencë përfaqësueses së AP në Vlorë.
63. Konsulencë ligjore lidhur me koompensimin e pronës lënë me qera nga ana e OSHE Fier.
64. Konsulencë ligjore lidhur me pjesëtimin e tokës-truall ndërmjet familjarëve.
65. Konsulencë ligjore për përfitimin e avokatit falas për zgjidhje martese, referuar Zyrës së Ndihmës Juridike Falas.
66. Asistuar në përpilim shkrese drejtuar Prokurorisë Fier.
67. Konsulencë ligjore lidhur me konfliktin pronësor midis familjarëve.
68. Orientuar t'i drejtohet me kërkesë Bashkisë Fier qytetari për përfitim ndihmë financiare për djegie banese.
69. Konsulencë ligjore lidhur me regjistrimin e vdekjes në gjendjen civile të djalit të tij.

70. Konsulencë ligjore për marrjen e certifikatë së pronësië, referuar AP në Vlorë.
71. Konsulencë ligjore për marrjen e hartës kadastrale.
72. Konsulencë ligjore lidhur me çështje pronësie si dhe mbi konceptin e Parashkrimit Fitues të pronës së paluajtshme.
73. Konsulencë ligjore lidhur me procedurën për t'u pajisur me dëshminë e pronësisë.
74. Konsulencë lidhur me njohjen e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore të të punësuarve pas përfitimit të masës së pensionit të pleqërisë.
75. Konsulencë ligjore lidhur me dokumentacionin për përfitim të avokatit falas (procedurë për ndarjen e pasurisë bashkëshortore, ofruar si shërbim nga Ministria e Drejtësisë, referuar Ndihmës Juridike Falas në Fier).
76. Orientuar një qytetar t'i drejtohej Prokurorisë Fier lidhur me çështjen e tij.
77. Asistuar në përpilim shkrese një qytetari, drejtuar Aluiznit lidhur me problematikën e tij.
78. Konsulencë lidhur me përfitimin e pensionit familjar sipas ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 si dhe rregulloren nr.1 e ISSH-së datë 19.10.2009 "Mbi administrimin dhe llogaritjen e pensioneve".
79. Konsulencë ligjore në lidhje me çështje pronësie.
80. Konsulencë ligjore lidhur me kompensimin nga ATP për zënien e tokës nga autostrada.
81. Asistuar në plotësimin e formularëve për t'iu drejtuar Gjykatës së Strasburgut.

Ndërmjetësime:

- Ndërmjetësim në fushën e shërbimeve, zgjidhur problematika e të moshuarës rezidente në Shtëpinë e të Moshuarve Fier
- Ndërmjetësim në fushën e shërbimeve me UK sh.a Fier, zgjidhur problematika e mbifaturimit të një qytetareje me pamjaftueshmëri ekonomike
- Ndërmjetësim në fushën e arsimit për regjistrimin e një fëmijë në kopësht, me Bashkinë Fier, për shkak të largësisë së banesës nga kopështi dhe problemeve shëndetësore të fëmijës, ku u bë e mundur që fëmija të regjistrohet në një kopësht më pranë qendrës së banimit.

3. Aktivitete të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në Shkodër

Rritja e ndërgjegjësimit të opinionit publik është një nga veprimtaritë themelore të KMD. Ky objektivi është një nga prioritetet kryesore të ZR Shkodër. Gjatë vitit 2024 kjo zyrë ka qenë organizatore e zhvillimit të ditëve të hapura me fokus rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe kategorive të ndryshme shoqërore si dhe promovimin e masave parandaluese dhe ndërgjegjësimin e komunitetit të gjerë për barazi dhe mosdiskriminim.

Janar

- Takim me përfaqësuesen e shoqatës “Rreze Shprese” për plotësimin e formularit të ankesës dhe diskutimin e rastit të saj.
- Asistuar studentët që ndjekin praktikën pranë Zyrës Rajonale në realizimin e detyrave të ndryshme.
- Aktivitet i organizuar nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” për korrupsionin.

- Takim me përfaqësues të shoqatës “Intelektualët e Rinjë, Shpresë” për të diskutuar rreth aktiviteteve të përbashkëta.
- Takim me drejtuesen e shoqatës “Hapa të lehtë” për të diskutuar rreth një rasti të pretenduar për diskriminim.

Shkurt

- Takim me përfaqësuesin e Zyrës për Ndihmës Juridike Falas për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta.
- Pritur dhe informuar studentët e Universitetit “Luigj Kurakuqi” për kryerjen e praktikës universitare pranë Zyrës Rajonale.
- Takim me përfaqësuesen e shoqatës “Hapa të lehtë” për diskutimin dhe referimin e një rasti diskriminimi për ZR të KMD.
- Takim me përfaqësuesen e shoqatës “Egjiptianët e bashkuar të Shqipërisë” dega Shkodër për realizimin e një “Ditë të hapur” në lagjen “Liria” në qytetin e Shkodrës në bashkëpunim edhe me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit në Shkodër.
- “Ditë e Hapur” në kuadër të “Javës kundër diskriminimit” në lagjen “Liria” në qytetin e Shkodrës, lagje e cila banohet më së shumti me qytetarë të komunitetit Egjiptjan. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit dhe shoqatën “Egjiptianët e bashkuar të Shqipërisë”.
- Takim me përfaqësuesin e Zyrës për Ndihmën Ligjore Falas për realizimin e një aktiviteti të përbashkët informues.
- Takim me Avokatin H. I për referimin e një rasti dhe informim lidhur me procedurën e shqyrtimit të ankesës nga KMD.
- Organizim aktiviteti në kuadër të javës kundër diskriminimit në shkollën “Oso Kuka” në qytetin e Shkodrës me temë: “Gjuha e urrejtjes në media dhe rrjete sociale”, me pjesëmarrjen e KMD dhe përfaqësues të KiE.

Mars

- “Ditë të Hapur” me komunitetin Rom, në bashkëpunim me përfaqësuesin e Zyrës për Ndihmë Ligjore Falas.
- Informuar studentët e Universitetit “Luigj Kurakuqi” që kryejnë praktikën pranë ZR Shkodër, për institucionin e KMD dhe procedurën e ankimit.
- Takim me përfaqësuesen e shoqatës “Egjiptianët e bashkuar të Shqipërisë” dega Shkodër për të bashkëpunuar dhe siguruar mbështetjen për zhvillimin e një “Ditë e hapur” në lagjen “Liria” në Shkodër, në bashkëpunim me përfaqësuesin e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit në Shkodër.
- “Ditë e hapur” në kuadër të “Javës kundër diskriminimit” zhvilluar në lagjen “Liria” në qytetin e Shkodrës, lagje e cila banohet më së shumti me qytetarë të komunitetit Egjiptjan. Aktiviteti u realizua në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit dhe shoqatës “Egjiptianët e bashkuar të Shqipërisë”.
- Takim me një qytetar për diskutimin e rastit të tij dhe plotësimin e formularit të ankesës.
- Pritur në takim një qytetar për diskutimin e rastit të tij dhe dokumentat që duhet të sjellë në mbështetje të pretendimeve të tij. Rast i është referuar Zyrës për Ndihmë Ligjore Falas.

- Informuar studentët e Universitetit “Luigj Kurakuqi” që kryejnë praktikën pranë ZR Shkodër, për mënyrën e raportimit të KMD në Kuvend.

Prill

- Takim me punojësen sociale të Shoqatës Shqiptare të Urdhërit të Maltës (MALTESER) në qytetin e Shkodrës për të diskutuar mbi disa raste diskriminimi të qytetarëve të komunitetit Rom.
- Informuar studentët e Universitetit “Luigj Kurakuqi” që kryejnë praktikën pranë ZR Shkodër mbi formulimin e një ankese dhe kushtet që duhet të plotësohen për regjistrimin e saj. .
- Angazhuar studentët e praktikës në aktivitete të ndryshme ku ZR ka qënë e ftuar.
- Takim me përfaqësuesin e Zyrës së Ndihmës Juridike Falas në qytetin e Shkodrës, për të diskutuar referimin e ndërsjellë të rasteve.

Maj

- Takim me përfaqësuesin e shoqatës “Për të drejtat e komunitetit Egjiptian” për të diskutuar problematikën e mungesës së kanalizimeve në lagjen “Liria”.
- Takim me drejtorin e Shkollës 9vjeçare “Liria” në qytetin e Shkodrës për diskutuar vijimësinë e aktiviteteve informuese për nxënësit e kësaj shkolle dhe ato ndërgjegjësuere me prindërit.

Qershor

- Takim me përfaqësuesin e Zyrës për Ndihmë Juridike Falas për referimin e rasteve.
- Takim me të rinjtë që banojnë në qendrat e shoqatës “Projekti Shpresa”, në kuadër të Ditës ndërkombëtare kundër gjuhës së urrejtjes. Të rinjtë vizituan Zyrën Rajonale të KMD dhe sollën në vëmendje diskriminimin e të rinjve me aftësi të kufizuara në përditshmëri, duke u ndaluar tek problematika më madhore, punësimi i tyre.
- Takim me përfaqësuesin e Avokatit të Popullit dhe të Zyrës për Ndihme Ligjore Falas në qytetin e Shkodrës për zhvillimin e aktivitetit të përbashkët “Ditë e hapur”, me komunitetin Rom.
- Në bashkëpunim me Zyrën për Ndihmë Juridike Falas dhe Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit u zhvillua një “Ditë e hapur” në lagjen “Liria” në qytetin e Shkodrës, lagje e cila është e banuar nga komuniteti Egjiptian.
- Në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të Avokatit të Popullit është zhvilluar një takim me fëmijët pjesëmarrës në kampin veror të mbështetur nga Shoqata Shqiptare e Urdhërit të Maltës (MALTESER) në qytetin e Shkodrës.
- Gjatë këtij takimi bashkëbisedues me fëmijët u fol për problematikat e bullizmit dhe mungesën e kushteve në shkolla.

Korrik

- Takim me fëmijët e kampit veror të shoqatës “The Door” në qytetin e Shkodrës, me qëllim informimin e tyre në lidhje me rolin dhe funksionet e zyrës rajonale si edhe për të diskutuar

për të drejtat e fëmijëve dhe për mënyrën sesi mund të adresojnë një ankesë në rast se këto të drejta shkelen.

- Takim me përfaqësuesen e shoqatës “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë” në qytetin e Shkodrës, për diskutimin e problematikave të komunitetit Egjiptjan.

Gusht

- Takim pune me përfaqësuesin e Zyrës për Ndihmë Juridike Falas, konsulencë për trajtimin e një rasti.

Shtator

- Takim me përfaqësuesin e Zyrës për Ndihmë Juridike Falas, në kuadër të realizimit të një aktiviteti të përbashkët.
- Takim me përfaqësues të Shoqatës “Hapa të Lehtë”, konsultim mbi problematikën e një rasti.

Pjesëmarrje në aktivitete institucionale

Janar

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga shoqata “Hapa të lehtë” në kuadër të 20 vjetorit të themelimit të saj.
- Pjesëmarrje në aktivitetin me temë: “Fuqizimi i grave dhe vajzave përmes rritjes së aksesit në të drejtat ekonomike, ligjore dhe sociale”. Ky aktivitet u organizua nga Agjencia Franceze për Zhvillim në bashkëpunim me Ministrinë e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Aktiviteti u zhvillua në një fasoneri të qytetit të Shkodrës, ku pjesëmarrës ishin punëtore të fasonorisë dhe përfaqësues të institucioneve qendrore e lokale.

Shkurt

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga AMSHC (Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile) me OJF dhe aktorë të tjerë në qytetin e Shkodrës lidhur me prioritetet për vitin 2024.
- Më 13 shkurt, specialisti i Zyrës Rajonale ka marrë pjesë në takimin me temë: “Lufta kundër korrupsionit”, organizuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkut në qytetin e Shkodrës.
- Pjesëmarrje në trajnimin me temë: “Meritokracia në karrierat gjyqësore”, i organizuar nga Instituti për Studime Publike dhe Ligjore, me mbështetjen e BE.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Partners Albania dhe Qendra Kombëtare Burimore me temë: “Ndryshimet në hapësirën qytetare dhe qëndresa e OJF-ve”. Qëllimi i takimit ishte prezantimi i projektit “Qëndrueshmeria Organizative”.

Mars

- Pjesëmarrje në trajnimin “Kriteret e rritjes në detyrë të magjistratëve”, organizuar nga Instituti për Studime politike dhe Ligjore (IPLS) në qytetin e Shkodrës.

Prill

- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga të rinjtë me aftësi të kufizuar të “Projektit Shpresa”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Librit.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga OMSA me mbështetjen e BE për prezantimin e projektit “Proud to Have Rights”.
- Pjesëmarrje në ëorkshopin me temë: “Procesi i integritetit europian në Shqipëri -mundësitë për përfshirjen e Shoqërisë Civile në procesin e negociatave në grupimin e kapitujve themelore”. Ky ëorkshop zhvillohet në kuadër të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, mbështetur nga Bashkimi Europian dhe që zbatohet nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri dhe Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin.

Maj

- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar në lagjen “Liria” në qytetin e Shkodrës, i cili u zhvillua në kuadër të projektit “Inclusion4Schools” me qëllim prezantimin e projektit për banorët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, që banojnë në këtë lagje dhe stafit të shkollës 9 vjeçare “Liria”.
- Pjesëmarrje në aktivitetin e organizuar nga “Europa House”, në kuadër të Javës së Evropës. Aktiviteti kishte si qëllim ndër të tjera prezantimin e punës dhe kontributit të OJF-ve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe promovimin e diversitetit dhe gjithëpërfshirjes.

Korrik

- Pjesëmarrje në takimin me temë: “Ndihma juridike falas për grupet në nevojë – Sfidat dhe mundësitë, si dhe mekanizmat e përfitimit të shërbimeve online”, organizuar nga shoqata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”, në qytetin e Shkodrës. Të pranishëm në takim ishin profesionistë të fushës, përfaqësues të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Shkodër dhe Pukë, anëtarë të “Rrjetit të Avokatëve “probono”, përfaqësues nga Dhoma Avokatisë Shkodër, OJF vendore, Fakulteti i Drejtësisë në Shkodër, si dhe përfaqësues të Institucioneve të Pavarura.
- Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga qendra “Hapa të Lehtë” dhe COSPE Shqipëri, për prezantimin e projektit me temë: “Proud to Have Rights”. Ky projekt ka si qëllim promovimin e barazisë, përfshirjes sociale dhe mosdiskriminimit të grave dhe personave LGBTIQ+ në Shqipëri.

Informacion mbi detyrat e përmbushura gjatë periudhës janar-dhjetor 2024

Gjatë periudhës viti 2024 specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar detyrat si më poshtë:

- Pritur qytetarë të interesuar për të ngritur një ankesë pranë KMD. Informuar, sqaruar dhe ndihmuar në plotësimin e formularit dhe akteve bashkëshoqëruese.
- Komunikuar në mënyrë të vazhdueshme me ankuesit për çdo informacion apo/dhe ndihmë që ato kanë pasur nevojë.
- Kthim përgjigje me email me përfaqësues të institucioneve lokale dhe të organizatave të shoqërisë civile.

- Telefonata pune me KMD, bashkëpunëtorë, institucione qendrore e vendore dhe aktorë të ndryshëm lokal.
- Referim rastesh pranë Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit dhe Zyrës së Ndihmës Ligjore Falas.
- Takime të vazhdueshme me përfaqësuesit e institucioneve vendore, OJF-ve dhe ata të Shoqërisë Civile.
- Drejtuar dhe organizuar përmbushja e praktikës mësimore 2 (dy) studentë të Fakultetit të Shkencave Sociale, dega Punë Sociale në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”.
- Referuar 21 raste në zyrat përkatëse për zgjidhjen e problematikave, si më poshtë:
 - 1) Procedura për çrregjistrim të shtetasit shqiptar të vdekur jashtë territorit të Shqipërisë.
 - 2) Problematika e legalizimit të shtëpisë, Procedura dhe institucioni ku duhet të drejtohet.
 - 3) Afati për terheqjen e kartës së identitetit pranë zyrave përkatëse pas aplikimit.
 - 4) Procedura e vendosjes së vulës apostile në çertifikatat për perdorim jashtë vendi.
 - 5) Problematika e mosmarrjes së dëshmipërblimeve të vitit 2009-2010 nga disa qytetarë.
 - 6) Asistim të qytetarit në përgatitjen e shkresës për kërkim informacioni drejtuar Bashkisë Shkodër.
 - 7) Informacion lidhur me procedurën e denoncimit të humbjes së kartës së identitetit nëpërmjet platformës e -Albania.
 - 8) Procedura e ndryshimit të adreses së vendbanimit nëpërmjet platformës e-Albania.
 - 9) Kërkesa për ndihma ushqimore pranë shërbimeve sociale.
 - 10) Procedurën e mbylljes së pensionit të personit të vdekur.
 - 11) Për mënyrën se si bashkëshortët mund të ankimojnë urdhrin e mbrojtjes së dhënë nga gjykata.
 - 12) Për vonesat e shqyrtimit të denoncimit nga Prokuroria.
 - 13) Informacion mbi procedurën e aplikimit për strehim social.
 - 14) Këshillim mbi procedurën që duhet ndjekur për të aplikuar për ndihmë ekonomike .
 - 15) Ankesa lidhur me disa taksa të vendosura nga Bashkia Shkodër.
 - 16) Informimi për nxjerrjen e një vërtetimi lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore.
 - 17) Sqarim për mënyrën e nxjerrjes të viteve të punës të cilat nuk ishin njohur nga ISSH.
 - 18) Informacion mbi rimbursimin e kilovateve tek fatura e energjisë elektrike.
 - 19) Informacion mbi mënyrën e regjistrimit si punkërkuese e papunë në e-Albania.
 - 20) Procedura për nxjerrjen e viteve të punës në ish-koperativën bujqësore nëpërmjet platformës e-Albania.
 - 21) Plotësimi i formularit online për aplikimin për strehim social.

Pasqyrim në media

- Më 19 janar, specialisti i Zyrës Rajonale ka realizuar një intervistë për median “Star Plus Tv” për të folur rreth rasteve të diskriminimit drejtuar KMD nga ZR Shkodër gjatë vitit 2023 dhe rezultati i tyre.

VI. ASPEKTE TË SHËRBIMEVE

1. Veprimtaria e Burimeve Njerëzore për vitin 2024

- I. Janë kryer vlerësimet e performancës së punonjësve për vitin 2024, si dhe janë dorzuar pranë ILDKPKI- së deklarat e pasurive të subjekteve që mbartin detyrimin e deklarimit sipas parashikimeve ligjore për vitin 2023.
- II. Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Stafi i KMD-së ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme si, trajnime të organizuara me anë të webinarëve nga, Shkolla Shqipëtare e Administratës Publike (ASPA) dhe institucione të tjera.
- III. Në trajnimin e organizuar me webinar nga ASPA dhe institucione të tjera janë trajtuar tema si:
 - Kodi i Procedurave Administrative.
 - Mbrojtja e të dhënave personale dhe e drejta e informimit.
 - Menaxhimi i Burimeve Njerëzore.
 - Planifikimi Buxhetor dhe Pasqyrat Financiare.
 - Masat disiplinore në ligjin 152/2013 Për nëpunësin civil.
 - Prokurimi Publik.
 - Siguria kibernetike.
 - Parandalimi dhe mbrojtja nga diskriminimi i viktimave të mundshme të trafikimit.
 - Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjëve në shërbime në Shqipëri.
 - Përdorimi i platëformës Integritet Evropian dhe Antarësimit .
 - Kodi i punës dhe zbatimi i tij në një marrëdhënie punësimi.
 - Etika dhe Integriteti në Administratën Publike.
 - Karta sociale dhe parimi i barazisë.
 - Higjiena Kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë.
 - Legjislacioni në fushën e sigurisë kibernetike.
- IV. Punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikat më të mira si dhe në aktivitete të ndryshme të organizuarë në fushën e të drejtave të njeriu/diskriminimit me tema:
 - Padia kolektive dhe format e reja të diskriminimit.
 - Të drejtat e personave LGBTIQ+
 - Përfshirja e të huajve në Ballkanin Perëndimor qasja në të drejtat sociale dhe ekonomike.
 - Fuqizimi, rikuperimi, riintegrimi: fuqizimi i shërbimeve për viktimat e dhunës me bazë gjinore.
 - Sfidat e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në vendimarrje dhe barrierat reale si mungesa e aksesit në financat politike dhe dhuna me bazë gjinore në politike.
 - Përgatitja e PBA 2023-2025 sipas prespektivës së buxhetimit të përgjithshëm gjinor.
 - Planet Sociale Vendore
 - Ndihma juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe grupet në nevojë.

V. Punonjësit e Zyrës Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme me tema:

- Java kundër Diskriminimit
- Segregimi në shkollën "Naim Frashëri", zbatimi i planit të veprimit dhe masave për desegregimin e saj.
- Gjuha e urrejtjes në mediat sociale dhe mediat e tjera .
- Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi në Gjimnazin "Janaq Kilica", Fier
- Diskriminimi në vendin e punës – Drejtoria Rajonale e Punësimit
- Ecuria në luftën kundër korrupsionit dhe reforma në administratën publike
- Konferenca Kombëtare me temë : " E drejta për informim, ndërtimi i besimit, promovimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në politikat kundër korrupsionit.
- Takim për kapitullin II- "Lëvizja e lirë e punëtorëve".
- Takim Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian " Ecuria e reformave në kuadër të Procesit të Berlinit ".
- Bullizimi kibernetik dhe mbrijtja e grave në internet.
- Diplomimi i intepretëve të gjuhës së shenjave
- Analiza e kuadrit politik dhe ligjor lidhur me të drejtat social-ekonomike të të huajve në Republikën e Shqipërisë.
- Forcimi i Integritetit – Strategjia për një Administratë Publike etike dhe të qëndrueshme.
- Shërbimet shqipëtare për refugjatët dhe migrantët.
- Parandalimin e krimit dhe rezilencës të rinjtë.
- Aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara.
- Konferencë e nivelit të lartë: " Përparimet në fushën e sigurisë dhe barazisë, politikat mbështetëse, nismat dhe arritjet e Shqipërisë në eliminimin e dhunës ndaj grave.
- Takime me qëllim forcimin e dialogut mes institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesve vendore e organizatave të shoqërisë civile
- Fuqizimi i grave në zonat rurale në dobi të zhvillimit rural dhe bujqësisë në Shqipëri.
- Transparenca dhe Aksesueshmëria në Sistemin Shëndetësor dhe Arsimor.

2. Menaxhimi i burimeve financiare 2024

Në zbatim të ligjit “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, po Ju raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për periudhën Janar - Dhjetor 2024, sipas modeleve standarte të monitorimit.

Gjithashtu ky buxhet ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve të caktuara në funksion të realizimit të produkteve dhe arritjes së objektivave të përcaktuara për këtë program buxhetor.

Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është akorduar një fond prej **72.500,00 (në mijë lekë)** për vitin 2024.

Totali i vlerës së akorduar përbëhet nga:

Fondi i Pagave:	50.400	mijë lekë	(zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	8. 730	mijë lekë	(zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative:	12. 370	mijë lekë	(zëri 602-606)
Fondi për Investime:	1. 000	mijë lekë	(zëri 231)

Nga fondi i planifikuar për 12-mujorin që është **72.500,00 (në mijë lekë)**, për periudhën e raportuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka realizuar vlerën buxhetore dhe jashtë buxhetore **70.196,15 në mijë lekë** ose **96,82%** të buxhetit të akorduar.

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore, (zëri 600-601), në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Vendimin e Kuvendit Nr. 34 datë 20. 05.2010 “Për Miratimin e Strukturës, Organikës dhe Kategorizimit të Pozicioneve të Punës të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndryshuar, numri mesatar i punonjësve është realizuar 34 nëpunës, nga 34 të miratuar.

Nga fondi i pagave, sigurimeve shoqërore dhe shpërblimeve të planifikuar prej **59.130,00 (në mijë lekë)** për këtë periudhë, është realizuar **58.183,99 (në mijë lekë)** për paga dhe për kontribute në sigurimet shoqërore e shëndetësore ose **98,40%** e fondit mujor të planifikuar në të dy zërat bashkë.

Fondi për shpenzime në zërin Mallra dhe Shërbime (zëri 602-606); për 12-mujorin e vitit 2024, është planifikuar në vlerën **12.370 në mijë lekë**. Për periudhën respektive është realizuar vlera prej **11.295,08 (në mijë lekë)** ose **91,31%**, e fondit të vitit të planifikuar.

Fondi për shpenzim investime (zëri 231): nga vlera e përgjithshme prej **1.000 (në mijë lekë)** për periudhën e raportuar, është realizuar vlera prej **717,08 (në mijë lekë)** ose **71,71%**, e fondit të vitit të planifikuar.